REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA MALËSI E MADHE**

Nr. 6293 Prot. Koplik, më 01.10.2018

**AMENDAMENT Nr. 1**
**PËR ZGJATJEN E AFATIT TË KONTRATËS ME OBJEKT**
**"RIKUALIFIKIMI I QENDRES BAJZE KASTRATI, LOTI I-RE"**

E lidhur sot me datë 01/10/2018 midis Autoritetit Kontraktor Bashkia Malësi e Madhe NIPT: K48420701I e përfaqësuar nga Kryetari Z. Tonin Marinaj, dhe CURRI SHPK , NIPT: J67902718S, për realizimin e amendamentit të kontratës.

**Neni 1**

**Baza ligjore**

1.1 Kodi Civil, ligji nr. 7850, datë 29.07.1994, me ndryshimet përkatëse;
1.2 Ligji Nr.9643 datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik" I ndryshuar;
1.3 VKM nr. 914 datë 29.02.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar;
1.4 Kontrata Themelore Nr. 4077 Prot., date 02/10/2017, me objekt "RIKUALIFIKIMI I QENDRES BAJZE KASTRATI, LOTI I-RE".

**Neni 2**

**Objekti i amandamentit të kontratës**

Objekti i këtij amendamenti është:

- Shtyrja e afatit për realizimin e objektit " RIKUALIFIKIMI I QENDRES BAJZE KASTRATI, LOTI I-re ", kjo per shkak te vonesave qe jane krijuar si pasoje e mosrealizimit te shpronesimit te objektve qe ndodhen brenda gjurmes se projektit.

**Neni 3**

**Afati i amendamentit të kontratës**

Amendamenti i kontratës fillon efektet juridike ne daten 01.10.2018 .
Afat i relaizimit te kontrates do te jete 12 muaj nga data e shpronesimit te objekteve qe ndodhen brenda gjurmes se projektit" RIKUALIFIKIMI I QENDRES BAJZE KASTRATI, LOTI I-re "



NDERTIM - PROJEKTIM CURRI Tel/Fax: 04 2232098 TIRANE - ALBANIA

## Neni 4

## Gjuha e amendamentit të kontratës

Gjuha e amendamentit të kontratës është gjuha Shqipe.

## Neni 5

## Kushtet e amendamentit të kontratës

5.1. Amendamenti i kontratës do të rregullohet nga dispozitat e legjislacionit shqiptar në fuqi.
5.2. Të gjitha kushtet dhe çështjet e kontratës themelore Nr. Nr. 4077 Prot., date 02/10/2017, me objekt "RIKUALIFIKIMI I QENDRES BAJZE KASTRATI, LOTI I-RE", midis Autoritetit Kontraktor Bashkia Malësi e Madhe dhe Operatorit Ekonomik CURRI SHPK , NIPT: J67902718S, që nuk janë përmendur në këtë amendament kontrate, mbeten në fuqi.

## Neni 6

## Vlefshmëria e amendamentit të kontratës

6.1.Ky amendament kontrate do të quhet i vlefshëm duke filluar nga data e nënshkrimit të saj nga palët.
6.2.Ky amendament kontrate u hartua në 5 kopje.

**AUTORITETI KONTRAKTOR**
**BASHKIA MALËSI E MADHE**
**KRYETAR**

TONIN MARINAJ

**OPERATORI EKONOMIK**
**CURRI SHPK**
**ADMINISTRATOR**

FAIK CURRI

Punoi: E.Ademaj (Jurist)

REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA MALESI E MADHE

Nr. 760.prot

Koplik më: 11 / 4 /2016

# K O N T R A T E - M B I K Q Y R J E

E lidhur sot me date *11/04/2016* ne Bashkine Malesi e Madhe , ndermjet paleve kontraktuese :

***INVESTITORI*** : ***Bashkia Malesi e Madhe e perfaqesuar nga kryetari i saj z. Tonin MARINAJ***

MBIKQYRESI : ***"HE & SK 11" shpk me nr.Nipt L19008502B me adresë Gjirokaster Tepelenë.***

***OBJEKTI I KONTRATES*** : ***Mbikqyrja e punimeve dhe te zbatimit te kontrates te sipermarrjes te punimeve te objektit :***

**« Mbikqyrje në objektin ndërtim i Pedonales në Fshatin Turistik Razëm »**

***BAZA LIGJORE :***
-Ligji Nr.8402 date 10.09.1998 kreu III nenet 7,15 *Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit*
-V.K.M Nr. 704, datë 29.10.2014 " Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim"
-Ligji Nr.9643/2006 "Për prokurimin publik" i ndryshuar.
-VKM nr.916/2014 "Për rregullat e prokurimit publik".
Data e fillimit te mbikqyrjes se punimeve eshte data e hartimit te kesaj kontrate.
Gjuha me te cilen lidhet kontrata eshte gjuha shqipe.

Vlera e kontrates se mbikqyrjes eshte **96.173 (nëntëdhjetë e gjashtëmijë e njëqind e shtatëdhjetë e tre) lekë pa tvsh dhe 115.408 (njëqind e pesëmbëdhjetë mijë e katërqind e tetë) lekë me tvsh,**

ne mbeshtetje te V.K.M Nr. 704, datë 29.10.2014 " Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim"

Kjo kontrate eshte e vlefteshme per nje periudhe kohe prej 8 muaj nga data e fillimit te punimeve ne objekt.

Komunikimi ndermjet paleve behet vetem me shkrim.Njoftimi behet efektiv vetem pasi dorezohet.

Nga lidhja e kesaj kontrate percaktohen te drejtat e detyrimet ndermjet paleve "detyrime te ndersjellta,kushtet e punes,etj." si me poshte :

## *I- PER MBIKQYRESIN E PUNIMEVE*

1.-Mbikqyresi i punimeve do te punesoje personelin e nevojshem per kryerjen e detyrave te percaktuara ne programin e mbikqyrjes se punimeve.
2.-Mbikqyresi i punimeve pergjigjet per zbatimin e kontrates te sipermarrjes te punimeve te lidhur ndermjet investitorit dhe sipermarresit si dhe per zbatimin e punimeve ne objektin NDERTIM I PEDONALES NE FSHATIN TURISTIK RAZEM.
3.-Mbikqyresi i punimeve vihet ne dijeni nga investitori per nenkontraktuesit qe zgjedh sipermarresi,ne perputhje me kontraten e nenshkruar.
4.-Mbikqyresi i punimeve perveç sherbimeve te kontrollit per zbatimin e punimeve,ndjek edhe zbatimin e grafikut te punimeve.
5.-Mbikqyresi i punimeve mban edhe dokumentacionin e meposhtem :
a.-Vendimin per sheshin ose lejen e ndertimit dhe lejen origjinale te ndertimit.
b.-Projektzbatimin e firmosur nga projektuesi,nga Bashkia ose nga Keshilli i Qarkut sipas juridiksionit.
c.-Dokumentacionin topografik dhe gjeologo-inxhinierik te themeleve,te bazamenteve dhe te punimeve te maskuara.
d.-Dokumentacionin perkates per te gjitha ndryshimet e mundshme qe mund te jene bere ne projekt-preventiv gjate zbatimit te objektit,pa prekur kushtet e vena ne vendimin te miratuara detyrimisht nga projektuesi si dhe nga investitori duke u shoqeruar edhe me relacionin tekniko-ekonomik.
e.-Planin e organizimit te punimeve.
6.-Mbikqyresi i punimeve duhet te kontrolloje periodikisht dhe ne fazat kryesore librin e kantjerit,saktesine dhe vertetesine e dokumentave qe pasqyrohen ne te.
7.-Mbikqyresi i punimeve ne çastin e fillimit te punimeve duhet te beje verifikimet paraprake si me poshte vijojne :
a.-Verifikimin e te gjithe dokumentacionit paraprak si liçenca,autorizime,leje,etj. te cilat sipas dispozitave ne fuqi duhet te merren para fillimit te punimeve.
b.-Verifikimin e sheshit te ndertimit,ne se eshte i lire dhe i gatshem per te filluar punimet.
c.-Njohjen me hollesi te kontrates te sipermarrjes dhe e te gjitha akteve administrative qe lidhen me te,si dhe me njohjen e te gjitha ndryeshimeve te mundeshme te kesaj kontrate me kalimin e kohes.
d.-Vendosjen e tabeles se identitetit me te dhenat e meposhteme :
-emertimin e objektit-data e marrjes se lejes se ndertimit-investitori-projektuesi-sipermarresi dhe drejtuesi teknik i punimeve te objektit-mbikqyresi i punimeve-afati i ndertimit-siperfaqja e ndertimit-lartesia-intensiteti sizmik i sheshit te ndertimit,ne baze te studimit sizmiologjik dhe mikrozonimit sizmik.
8.-Mbikqyresi i punimeve,pas verifikimeve te percaktuara sipas pikes se mesiperme"7" harton dokumentacionin si me poshte:
-aktin e dorezimit te sheshit te ndertimit shoqerise sipermarrese-aktin e dorezimit nga sipermarresi te dokumentacionit teknik dhe administrativ si liçensa,autorizime e leje te marra nga sipermarresi-shkresen me ane te se ciles njofton pushtetin vendor dhe degen e Inpsektoriatit te Ndertimit per fillimin e punimeve.

..bikqyresi i punimeve,sa here qe e sheh te nevojshme gjate zbatimit te punimeve i jep me ..krim instruksione e urdhera sipermarresit dhe ky i fundit eshte i detyruar t'i zbatoje ato. Sipermarresi ruan te drejten per t'i bere me shkrim investitorit verejtjet e tija ne lidhje me instruksionet dhe urdherat e marra nga mbikqyresi i punimeve.

10.-Mbikqyresi i punimeve,me shpenzimet e sipermarresit ka te drejte te kerkoje kryerjen e provave te materjaleve te vendosura ne objekt,te prodhimeve te gateshme e gjysem te gateshme me te cilat furnizohet objekti apo te struktuarave b/arme e te elementeve tjere te objektit.

11.-Mbikqyresi i punimeve ka te drejte te propozoje largimin nga puna te nje ose disa personave nga personeli i sipermarresit duke iu drejtuar me shkrim titullarit te shoqerise sipermarrese(drejtuesit ligjor apo administratorit te shoqerise) dhe duke i shpjeguar arsyet sipas kopetencave te tija.

12.-Mbikqyresi i punimeve kerkon verifikimet perkatese kur mendon se ka difekte ne zbatimin e punimeve dhe kur verifikimet i japin te drejte mbikqyresit te punimeve shpenzimet jane ne ngarkim te sipermarresit.

13.-Mbikqyresi i punimeve me miratim te investitorit ka te drejte te pezulloje perkohesisht punimet per zbatim teknik te gabuar apo per paaftesi teknike zbatimi per aq kohe sa quhet e nevojshme korigjimi i gjendjes.

14.-Mbikqyresi i punimeve kontrollon zbatimin e grafikut te hollesishem te punimeve dhe i raporton investitorit çdo muaj per realizimin e tij.

15.-E gjithe korespondenca e mbikqyresit te punimeve me investitorin dhe me sipermarresin perben dokumentacionin e objektit dhe si i tille ruhet me çdo kusht.

16.-Mbikqyresi i punimeve mban dosjen e mbikqyrjes se punimeve,ku pasqyrohen te gjitha aktet e mbajtura gjate zbatimit te punimeve te objektit qe nga akti i dorezimit te sheshit te ndertimit e deri ne pregatitjen e dokumentacionit per kolaudim objekti me qellim dhenien e kuadrit te plote te te gjitha fazave te zbatimit te punimeve.

17.-Mbikqyresi i punimeve pas marrjes se njoftimit me shkrim nga sipermarresi per perfundimin e punimeve i kerkon sipermarresit te punimeve dorezimin e dokumentacionit si me poshte :

*kontraten dhe aktet qe lidhen me te.

*proçes verbalet e fillimit,te nderprerjes ose te zgjatjes dhe te perfundimit te punimeve.

*çertifikatat e provave laboratorike te materjaleve te perdorura te leshuara nga laboratoret e autorizuar per kete qellim.

*deklaraten se objekti eshte ndertuar ne perputhje me projektin dhe me kushtet teknike.

Mbikqyresi i punimeve firmos gjithçka qe ka miratuar. Nje kopje e dokumentacionit te miratuar nga mbikqyresi i punimeve i dergohet kolaudatorit apo grupit te kolaudimit te objektit.

18.-Kur investitori lejon shmangie ne permasa ose cilesi te dobet qe nuk cenojne kushtet teknike e qe jane te pranueshme per vepren,mbikqyresi i punimeve do te zbatoje zbritje te çmimeve ne kontabilitet dhe ne vleresimin perfundimtar,por ne çdo rast me miratim te investitorit.

19.-Mbikqyresi i punimeve kontrollon e miraton situacionet e paraqitura nga sipermarresi ne fazat e ndryshme te punimeve.Pagesa mund te kryhet vetem ne baze te ketij miratimi.

20.-Mbikqyresi i punimeve kontrollon e miraton perdorimin e fondit rrezerve te preventivit dhe i raporton periodikisht investitorit per gjendjen e tij. Ky i fundit,ne se ka vrejtje e njofton sipermarresin dhe problemi zgjidhet ndermjet tyre.Per çdo ndryshim te mundshem,mbikqyresi i punimeve vihet ne dijeni per te ndjekur zbatimin e ndryshimeve ne fjale.

Mbikqyresi i punimeve merr pjese ne kolaudimin e objektit,i pergjigjet dhe e sqaron kolaudatorin per te gjithe dokumentacionin dhe per te gjithe paqartesite qe ka ai per kolaudimin e objektit si dhe firmos proçes verbalin e kolaudimit.

22.-Pas perfundimit te kolaudimit,mbikqyresi i punimeve,mbeshtetur ne kontraten e sipermarrjes se zbatimit te punimeve dhe ne aktin e kolaudimit,percakton vleren perfundimtare te objektit e cila i behet e ditur sipermarresit dhe i jepet per likujdim investitorit.

23.-Me perfundimin e punimeve,brenda 30 diteve,mbikqyresi i punimeve duhet te depozitoje prane investitorit nje relacion ne dy kopje rreth zbatimit te punimeve dhe te kontrates te sipermarrjes te zbatimit te tyre.

24.-Ne rast se gjate zbatimit te punimeve per shkaqe te ndryshme del nevoja e shmangies nga projekti,mbikqyresi i punimeve i kerkon investitorit thirrjen e projektuesit dhe ne prezence detyrimisht te sipermarresit mbahet proçes verbali duke reflektuar me hollesi shkaqet dhe volumet shtese (hartohet preventivi shtese per punimet qe shtohen dhe per punimet qe pakesohen,i cili detyrimisht duhet te miratohet nga investitori).

25.-Mbikqyresi i punimeve urdheron sipermarresin per te prishur e per te ribere,me shpenzimet e ketij te fundit,punimet qe nuk jane bere me cilesine e parashikuar dhe me materjale qe nuk permbushin standardet shqiptare apo ato europiane.

26.-Mbikqyresi i punimeve nuk duhet te lejoje qe asnje punim te mbulohet,maskohet apo te betonohet pa miratimin e tij. Sipermarresi i punimeve detyrimisht duhet te njoftoje mbikqyresin e punimeve kur punimet e mesiperme jane gati te ekzaminohen nga mbikqyresi i punimeve.

27.-Mbikqyresi i punimeve do te miratoje çdo propozim te sipermarresit per te zevendesuar personelin kryesor te punimeve vetem neqoftese pergatitja dhe aftesite e tyre te nevojshme jane krejtesisht te barabarta ose me te mira se ato te personelit te perfshire ne listen e stafit te shoqerise te paraqitur ne dokumentacionin e prokurimit te objektit.

28.-Mbikqyresi i punimeve kontrollon e miraton programin e punimeve qe i paraqet sipermarresi i punimeve,ne te cilin perfshihen metodat e pergjithshme,masat paraprake pregaditore,grafiku dhe afati per te gjitha veprimtarite e punimeve.

29.-Mbikqyresi i punimeve mund te shtyje daten e perfundimit te punimeve te objektit ne raste te kompensimit ose kur ndodh ndonje ndryshim qe e ben te pamundur perfundimin e punimeve dhe kolaudimin e pjesshem apo perfundimtar te punimeve brenda dates se caktuar ne kontrate per kete qellim,pa detyruar sipermarresin qe te marre masa per te shpejtuar punen e metejshme,gje qe do te shkaktonte shpenzime te tjera per sipermarresin.

30.-Neqoftese sipermarresi nuk korigjon defektin e shfaqur te ndonje punimi dhe te njoftuar nga mbikqyresi i punimeve brenda afatit te percaktuar ne njoftim,mbikqyresi i punimeve do te vleresoje koston e korigjimit te defektit dhe sipermarresi do te paguaj kete shume ose investitori do te fitoje kete shume nepermjet zbritjes nga shuma qe i detyrohet sipermarresit.

31.-Mbikqyresi i punimeve do te kontrolloje punen e kryer nga sipermarresi dhe do te vertetoje shumen qe duhet t'i paguhet sipermarresit brenda 8(tete) diteve nga data e marrjes se çertifikates se pageses(situacionit) nga sipermarresi.Vlera e punes se kryer do te perfshije vlerat e ndryshimeve dhe rastet e kompensuara ne se keto do te jene te miratuara me pare nga investitori.

32-Mbikqyresi i punimeve duhet qe nje here ne muaj duhet te raportoje tek investitori me nje relacion me shkrim ne lidhje me ecurine e punimeve ne kete objekt,duke pasqyruar gjendjen reale te objektit ne ate faze ne te cilen ndodhet ne momentin e perpilimit te nje raporti te tille.

## *II.- PER INVESTITORIN*

1.-Investitori i dorezon mbikqyresit te punimeve te objektit,ne momentin e lidhjes se kontrates per mbikqyrjen e punimeve,dokumentacionin si me poshte :

*Projekt zbatimin e firmosur nga projektuesi,nga komuna ose keshilli i qarkut,sipas juridiksionit.

*Preventivin e ofertes fituese(te sipermarresit) te firmosur nga anetaret e komisionit te vleresimit te ofertave dhe te miratuar nga kryetari i entit prokurues.

*Kontraten e lidhur ndermjet tij dhe sipermarresit per sipermarrjen e zbatimit te punimeve te objektit.

*Specifikimet teknike te punimeve te objektit dhe pershkrimin e shkurter te tyre te shoqeruar me raportin teknik te projektuesit.

*Kopje te vendimit te Autoritetit te Planifikimit te Territorit per sheshin/lejen e ndertimit.

*Nje pjese te dokumentacionit ligjor-administrativ te sipermarresit si liçensa,stafi teknik,paisjet e makinerite qe do te perdoren,etj.

2.-Investitori i dorezon sipermarresit te punimeve nje kopje te kontrates te lidhur ndermjet investitorit dhe mbikqyresit te punimeve per mbikqyrjen e punimeve te objektit.

3.-Investitori duhet te njohe mbikqyresin e punimeve me çdo ndryshim qe mund t'i beje ai kontrates te lidhur me sipermarresin e zbatimit te punimeve.

4.-Investitori duhet te marre masa per lirimin e sheshit te ndertimit,ne se ai eshte i zene ne momentin e fillimit te punimeve.

5.-Investitori ben likujdimin e pageses per çdo situacion te paraqitur nga mbikqyresi i punimeve brenda 8(tete) diteve kalendarike nga dita e paraqitjes se situacionit pjesor ose progresiv apo perfundimtar per mbikqyrjen e punimeve. Per çdo dite vonese tej afatit te caktuar me siper investitori i paguan mbikqyresit te punimeve nje demshperblim vonese prej 1% te vleres se situacionit te paraqitur per likujdim nga mbikqyresi i punimeve.

6.-Investitori kontrollon e miraton proçesverbalin e preventivin shtese per punimet qe shtohen apo pakesohen ne rast se gjate zbatimit te punimeve per shkaqe te ndryshme lind nevoja e shmangies nga projekti apo qe jane parashikuar me pak ne preventivin fillestar.

7.-Investitori brenda 30(tridhjete) diteve kalendarike nga data e marrjes se njoftimit nga sipermarresi i zbatimit te punimeve per perfundimin e punimeve te objektit,merr ne dorezim nga mbikqyresi i punimeve dosjen e objektit dhe i njofton atij daten e kolaudimit te punimeve te kryera sipas kontrates te sipermarrjes se zbatimit te punimeve te objektit.

8.-Investitori mund qe brenda periudhes se efektshmerise se kontrates se lidhur me mbikqyresin e punimeve per mbikqyrjen e punimeve,te emeroje kolaudatorin apo grupin e kolaudimit,te cilet gezojne te drejten e mbikqyrjes dhe te kontrollit te punimeve gjate gjithe fazave te realizimit te tyre dhe te lejne detyra per korigjimin e te metavete konstatuara.

9.-Investitori mund te kerkoje largimin apo zevendesimin e mbikqyresit te punimeve kur verteton mangesi serioze ne veprimtarine e tij si :

*Mangesi ne realizimin e detyrave te percaktuar ne piken "I" te kesaj kontrate.

*Nderprerje e paarsyeshme te punimeve dhe zgjatje e theksuar pa shkak te tyre.

10.-Kur verehen shkelje te dispozitave ligjore,investitori ka te drejte te urdheroje mbikqyresin e punimeve per pezullimin e punimeve deri ne marrjen e masave perkatese per normalizimin e

..jes. Kur shkeljet e dispozitave ligjore mund te perbejne kundravajtje ..ministrative,vendosen sanksione,ne baze te neneve 15 dhe 16 te kreut III-te te ligjit Nr.8402 date 10.09.1998 "Per kontrollin dhe disiplinimin e punimeve te ndertimit" i ndryshuar.

11.-Ne qofte se me perfundimin e afatit te mbikqyrjes se punimeve te percaktuar ne kontraten e mbikqyrjes se punimeve,punimet e sipermarrjes se zbatimit te punimeve nuk perfundojne,investitori ka te drejte te hartoje kontrate shtese me mbikqyresin e punimeve me afat kohor deri ne perfundim te punimeve te sipermarrjes se zbatimit te tyre,me vlere shtese mbi ate te percaktuar ne kontraten fillestare per mbikqyrjen e punimeve te objektit.

Ne qofte se ai(investitori) nuk vepron keshtu,atehere kontrata e mbikqyrjes se punimeve quhet e perfunduar dhe nga mbikqyresi i punimeve ai(investitori) merr ne dorezim dosjen e mbikqyrjes se punimeve te objektit.

12.-Investitori duhet t'i pergjigjet me shkrim kerkesave,vrejtjeve e sygjerimeve te mbikqyresit te punimeve brenda kohes se domosdoshme per te mos vonuar vazhdimin e punimeve ose zbatimin e tyre pa miratimin e tij(investitorit).

13-Investitori ka te drejten e monitorimit te kesaj kontrate gjate gjithe kohes dhe fazes se realizimit te kryerjes se punimeve ne kete objekt duke ngarkuar me kompetence tekniko-profesionale Departamentin e Sherbimeve Publike.

## *III.- TE PERBASHKETA*

1.-Investitori ose mbikqyresi i punimeve mund te pezullojne zbatimin e kontrates se mbikqyrjes se punimeve,ne qofte se pala tjeter ben shkelje themelore te kontrates.

Shkelje themelore te kontrates perbejne :

*Mbikqyresi i punimeve lejon nderprerjen e punimeve nga sipermarresi per raste kur nuk eshte parashikuar ne programin e punimeve.

*Mbikqyresi i punimeve urdheron pezullimin e perkohshem te punimeve dhe ky urdher pa shkak nuk terhiqet prej tij brenda 15 diteve.

*Mbikqyresi i punimeve falimenton.

*Mbikqyresi i punimeve lejon mos korigjimin e defektit brenda afatit te percaktuar prej tij.

*Investitori lejon zgjatjen pa arsye te afatit te perfundimit te punimeve te percaktuar ne kontraten e mbikqyrjes se punimeve dhe ne kontraten e sipermarrjes se zbatimit te punimeve me shume se 25% te afatit fillestar kohor te perfundimit te punimeve.

*Investitori kur ka arsye objektive,mund te prishe kontraten e lidhur me mbikqyresin e punimeve per mbikqyrjen e punimeve te objektit duke i dhene mbikqyresit te punimeve nje njoftim brenda nje afati prej 15 ditesh.

2.-Investitori dhe mbikqyresi i punimeve do te bejne perpjekje per te zgjidhur ne menyre paqesore,nepermjet bisedimeve te drejtperdrejta çdo mosmareveshje qe lind midis tyre ose lidhur me zbatimin e kontrateve si te zbatimit te punimeve ashtu dhe te mbikqyrjes se punimeve,ne te kundreten keto mosmareveshje zgjidhen nepermjet gjykates.

3.-Ne qofte se pas dates se lidhjes se kontrates per mbikqyrjen e punimeve te objektit ndodhin ndryshime ne ligj,dekret,vendim,udhezim apo akt tjeter nenligjor i Kuvendit apo i Keshillit te Ministrave,qe shkaktojne ndryshime ne shpenzimet e mbikqyresit te punimeve per zbatimin e

..rates,keto ndryshime shpenzimesh do te percaktohen nga investitori duke hartuar kontrate ..ntese.

-Kontrata e perpiluar dhe e miratuar nga te dy palet mbahet ne 4(kater) kopje,ku nje kopje i dorezohet mbikqyresit te punimeve dhe kopjet tjera terhiqen nga ana e investitorit.

| | |
|---|---|
| *PER INVESTITORIN* | *PER MBIKQYRESIN E PUNIMEVE* |
| BASHKIA MALËSI E MADHE | "HE & SK 11" SHPK |
| KRYETAR | ADMINISTRATOR |
| TONIN **MARINAJ** | FESTIM **BREGASI** |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MALËSI E MADHE

HE & SK 11 NIPT: L19008502B

Punoi : Griselda Hotaj, Juriste
Nr.Kopjeve 4 (kater)

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**
**BASHKIA MALESI E MADHE**

Nr.354.prot                                                    Koplik më: 18/2 /2016

**KONTRATË PËR PUNË PUBLIKE**
**NDËRTIM I PEDONALES NË FSHATIN TURISTIK RAZËM**

Në mbështetje të Kodit Civil të Republikes së Shqipërisë, në mbështetjet te Ligjit nr.9643 dt.20/11/2006 "Per Prokurimin Publik" i ndryshuar, në bazë të VKM Nr.914 Dt.29.12.2014 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", Kodit Civil tw R.SH-së, lidhet kjo kontratë si më poshtë:

E lidhur sot me datë 18 / 2 /2016, ndërmjet **Bashkisë Malësi e Madhe** (në vazhdim do të quhet **Autoriteti Kontraktor**) përfaqësuar nga **z.Tonin MARINAJ** në cilësinë e Kryetarit të Autoritetit Kontraktor me adresë Koplik M.Madhe dhe bashkimit të operatoreve ekonomik **"BetonPlus Company"** shpk me nr.nipt **K88005701R** me administrator ligjor **z.Marian FIERZA** dhe firmes **"Nika"** shpk me nr.nipt **J76705047U** perfaqesuar nga **zj.Shpresa NIKA**, bashkim ky që do të përfaqësohet nga firma **"Betonplus Company" sipas prokurës së posaçme nr.1562/1.rep, nr.686/1 kol, të dt.22.12.2015.**
**Firma "Betonplus Company" shpk përfaqësohet nga z.Eduard Pllumbaj sipas prokurës së përgjithshme nr.2776 rep Nr.839/3 kol datë 22.04.2015.**

**NENI 1**

Objekti i kësaj kontrate është **"Ndërtimi i Pedonales në Fshatin Turistik Razëm"** sipas projektit, preventivit dhe sipas specifikimeve teknike në dokumentet e tenderit. Kjo kontratë është e detyrueshme për zbatim nga palët sipas kushteve që percaktohen shprehimisht në të, ndërsa për çeshtje të tjera që mund të lindin gjatë zbatimit të saj dhe që nuk parashikohen në këtë kontratë do të zbatohen dispozitat përkatëse të Kodit Civil si dhe dispozitat ligjore të posaçme.

**NENI 2**

Vlera e kësaj kontrate, deri në perfundim të punimeve të objektit është: 22.472.058 (njëzet e dy milion e katërqind e shtatëdhjetë e dy mijë e pesëdhjetë e tetë) lekë.

**NENI 3**

Çmimi i kontrates është fiks dhe i pandryshueshem. Autoriteti Kontraktor nuk pranon asnjë rritje të këtij çmimi që mund të pretendohet nga kontaktuesi sikur një rritje e vleres të pretendohet si rrezultat i rritjes së çmimeve të materialeve, kostos së transportit apo te rritjes së



BETONPLUS sh.p.k. COMPANY jo vetem beton...
NIKA SH.P.K. NIPT: J76705047U SHKODER ALBANIA

taksave,siguracioneve, pagave të punojesve, e te tjera të kësaj natyre, të bëra me dispozitat ligjore dhe nenligjore.

**NENI 4**

Sipërmarresi detyrohet që të depozitoje në llogarinë e Autoritetit Kontraktor një shumë në masen 10% te vleres së kontrates si garanci për realizimin e punimeve (formulari i sigurimit të kontratës).

**NENI 5**

Punimet do të fillojnë ditën e nesërme të datës së nënshkrimit të kontratës me mbikqyrsin e punimeve sipas procedurave ligjore. Afati i perfundimit të punimeve të objektit në bazë të grafikut të punimeve llogaritur nga data e kur punimet do te fillojne (data e nenshkrimit te kontrates me mbikqyrsin e punimeve) është 8 (tetë) muaj. Ky afat mund të ndryshohet vetëm në rastet e parashikuara në ligj.

**NENI 6**

Kontrata ka forcen e ligjit për palët. Kjo mund te zgjidhet apo ndryshohet sipas rasteve të parashikuara në ligj. Në këtë rast detyrimisht do të hartohet një aneks-kontrate në formen verbale në të cilen do të percaktohen të gjitha ndryshimet për të cilat palët kanë rënë dakord.

**NENI 7**

Garancia e defekteve është në shumen 1.123.600 ((njëmilion e njëqind e njëzet e tre mijë e gjashqind) leke. Periudha e garancisë do të jetë 2(dy) vite nga data e firmosjes së aktit të kolaudimit.

**NENI 8**

Nga data e fillimit të punimeve deri në përfundim të tyre fund të periudhes se "garancise per defektet", kontraktuesi do te perballoje rreziqet per shkak te demtimeve personale, vdekjes, humbjes ose demtimit te pasurise (perfshi pa kufizime punimet, materialet dhe paisjet).

**NENI 9**

Mbikqyresi i punimeve (që do të kontraktohet nga Bashkia në perputhje me LPP) është përgjegjës per mbikqyrjen e ndertimit te objektit, ne perputhje me projektin dhe kushtet teknike ne fuqine dhe cilesine e zbatimit te punimeve dhe te materialeve te ndertimit per likuijdimin e situacioneve dhe per plotesimin e dokumentacionit te dosjes se objektit qe nga momenti i fillimit te punimeve dhe deri ne ate te realizimit te plote te objektit.

## NENI 10

Çdo ndryshim ne sasi i urdheruar nga Autoriteti Kontraktor, i cili sjell rritjen e vleres se kontrates, si dhe per cdo situate te paparashikuar qe sjell zgjatjen e afatit te perfundimit do te jete detyrimisht objekt i proces-verbali me shkrim.

## NENI 11

Përdorimi i fondit rezerve do të behet vetem me miratimin e Autoritetit Kontraktor pas kërkesës me shkrim të argumentuar.

## NENI 12

Menjehere sapo te nënshkruhet kontrata e supervisionit, kontraktuesi detyrohet te dorezoje tek supervizori grafikun e punimeve te objektit. Supervizori do te firmose situacionin duke kontrolluar librezen e masave ne menyre periodike, me qellim qe marrja ne dorezim e objektit te mos kete probleme me volumet ose cilesine. Ne kete grafik duhet te percaktohet rralla e punimeve, afati i kryerjes se cdo procesi pune dhe vlerat qe ai do te realizoje. Paraqitja e ketij grafiku perben kusht themelor te kesaj kontrate.

## NENI 13

Kontraktuesi do te permbushe te gjitha detyrimet per sigurimet qe rrjedhin nga aktet ligjore e nënligjore në fuqi. Gjithashtu duhet të marrë persiper edhe rreziqet qe mund te lindin nga data e fillimit të punimeve deri në daten e perfundimit të periudhës së garancisë si :

1.Demtimin e punimeve.

2.Humbjen dhe/ose demtimin e materialeve dhe paisjeve.

3.Plagosjen ose vdekjen e personelit në punë.

## NENI 14

Punimet në objekt nga ana e kontraktuesit do të kryhen në përputhje të plotë me projektin, specifikimet teknike dhe preventivin me te cilat kontraktuesi është njohur dhe mbi bazen e te cilave ka berë vleresimin dhe ka paraqitur oferten si dhe KTZ dhe grafikut të miratuar me fillimin e punimeve.

## NENI 15

Ne rast te kryerjes se punimeve në kundershtim me sa parashikohet me siper, kontraktuesi do te pergjigjet vetë për shpenzimet e kryera mbi vlerën fikse të percaktuar në këtë kontratë dhe për vonesat në perfundimin e objektit, sic parashikohet ne nenin 30 të kësaj kontrate.

## NENI 16

Zbatimi i punimeve nga ana e sipermarresit do të behet në perputhje të plote me KTZ në fuqi sipas llojit të punimeve. Kontraktuesi mban pergjegjesi per qendrushmerine e objektit dhe per

punimete e maskuara qe ka kryer. Materialet qe do te perdoren ne objekt duhet te jene te reja, ne perputhje me standartet ne fuqi dhe te shoqeruara me çertifikatat cilesise qe leshohen nga nje laborator i licensuar ose nga nje laborator i kontrollit te cilësisë.

**NENI 17**

Cdo here qe drejtuesi i punimeve njoftohet apo verifikon nje defekt apo te metë në cilësinë e punimeve, të materialeve të ndertimit apo të punimeve të maskuara, drejtuesi i punimeve mban proces-verbalin perkates duke lene detyra dhe kontraktuesi do te korrigjoje defektin apo te maten shpenzimet e veta brenda afatit te parashikuar nga njoftimi i drejtuesit te punimeve. Ne perfundim te afatit te caktuar per riparimin te metave, Autoriteti Kontraktor kontrollon zbatimin e detyrave te lena dhe kur ato jane zbatuar ben shenimin perkates ne proces-verbalin e mbajtur.

**NENI 18**

Ne rast se detyrat e lena ne proces-verbal nuk jane zbatuar nga ana e kontraktuesit ne afatin e caktuar, Bashkise i lind e drejta qe ta zgjidhë kontraten në mënyrë të njëanshme. Drejtuesi i punimeve do te vleresoje koston e korrigjimit te defektit apo te te metes dhe kontraktuesi do te paguaje kete shume, ose Autoriteti Kontraktor do ta mbaje kete shume duke e zbritur nga pagesa e llogarise perfundimtare. Ne rast se kjo nuk mjafton pjesen tjeter e ndal nga garancia e derdhur nga kontraktuesi per garantimin e perfundimit te punimeve.

**NENI 19**

Në rast së kontraktuesi gjatë vazhdimit të punimeve kryen punime me cilesi te dobet apo perdor materiale qe nuk plotesojne kerkesat e standarteve shteterore te cilat vene ne rrezik qendrushmerine e objektit, Autoriteti Kontraktor jo vetem ka te drejte te zgjidhë kontraten në mënyrë të njeanshme, të mos lejoje likujdimin e punimeve te kryera, por edhe te propozojë perjashtimin nga pjesemarrja në tender firmën pjesemarrese për një periudhe deri në 3(tre)vjet.

**NENI 20**

Preventivi perfshin e gjitha zerat e punimeve që duhen të kryhen për perfundimin e objektit dhe përdoret për të llogaritur vleren e kontratës.

**NENI 21**

Kontraktuesi do të fillojë punën ditën e neserme të dates së nenshkrimit të kontrates me mbikqyrsin e punimeve. Në rast vonese të shkaktuar nga mos lirimi në kohë i shesh ndërtimit Autoriteti Kontraktor bën shtyrjen e afatit të dorezimit të objektit dhe në kete rast kontraktuesi nuk ka te drejte te pretendoje asnje demshperblim per kete vonese.

**NENI 22**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MALËSI E MADHE

BETONPLUS COMPANY jo vetëm beton

NIKA SH.P.K NIPT J76705047U SHKODER-ALBANIA

Në rast se kontraktuesi (me perjashtim të vonesës së shkaktuar nga moslirimi i sheshit të ndërtimit, apo në rastet e tjera të parashikuara në ligj nuk fillon punimet në afatin e percaktuar ose pas fillimit te punimeve i nderpret ato pa shkak ligjor dhe nuk i rifillon brenda nje periudhe kohe prej 15 ditesh, Autoritetit Kontraktor i lind e drejta ta zgjidhë këtë kontratë në menyrë të njeanshme.

**NENI 23**

Mbikqyresi i punimeve do te kerkoje nga kontraktuesi zbatimin e grafikut te punimeve per cdo ze pune ne kohe dhe ne vlere dhe ne rast se do te konstatoje shkelje te tij do te marrë masat sipas ligjit dhe të njoftoje menjehere Autoritetin Kontraktor. Autoriteti Kontraktor per mosrealizimin e punimeve sipas grafikut te punimeve te realizuar nga ai vete, do te mbaje vleren sipas nenit 34 te KPK te Dokumenteve te Standarde.

**NENI 24**

Ne rast se kontraktuesi ne mbarim te gjysmes se afatit te perfundimit te objektit nuk ka realizuar punimet me vlere sipas grafikut, Autoriteti Kontraktor ka te drejte te zgjidhë kontraten ne menyre te njeanshme duke konfiskuar kontraktuesit Sigurimin e Kontrates.

**NENI 25**

Autoriteti Kontraktor do te paguaje kontraktuesin ne baze te situacioneve mujore qe kontrollohen dhe miratohen nga mbikqyresi i punimeve. Me paraqitjen e situacioneve kontraktuesi, pagesat behen brenda 30 diteve nga dita e paraqitjes se situacioneve. Kontraktuesi nuk ka te drejte te pretendoje ndaj Autoritetit Kontraktor (Bashkisë) asnje demshperblim per mosfinancim ne kohe te punimeve ne rastin e çeljes me vonese te fondeve nga financuesi.

**NENI 26**

Zerat e punimeve per te cilat nuk eshte vene cmimi per nje njesi ne oferten e paraqitur do te konsiderohen si te mbuluara nga vlerat e tjera te perfshira ne kontrate.

**NENI 27**

Ne rast se situacioni i paraqitur nuk i paguhet kontraktuesit ne kohe brenda 30 diteve, me perjashtim te rastit te parashikuar ne nenin 25, Autoriteti Kontraktor detyrohet te paguaje sipas nenit 34 te kushteve te pergjithshme te kontrates.

**NENI 28**

Ne qofte se situacioni i nje muaji se bashku me interesat perkatese nuk i paguhet kontraktuesit edhe mbas 60 diteve tjera, ketij te fundit i lind e drejta qe ta prishe kete kontrate ne menyre te njeanshme dhe të vazhdojë procedurat sipas ligjit për likujdimin e punimeve të kryera.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MALËSI E MADHE

BETONPLUS sh.p.k. COMPANY jo vetëm beton...

NIKA SH.P.K. NIPT:J76705047U SHKODER-ALBANIA

**NENI 29**

Ne perfundim te objektit ose ne rastin e zgjidhjes se kesaj kontrate çdo arsye qofte kontraktuesi do te paraqese situacionin perfundimtar per shumen qe pretendon se duhet te shlyhet, gjithmone ne perputhje me sa parashikohet ne kontrate.

**NENI 30**

Ne rast te shkeljes se afatit perfundimtar te objektit sic eshte parashikuar ne kete kontrate, kontraktuesi detyrohet te paguaje nje kamate vonese te sipas nenit 34 te kushteve te pergjithshme te kontratës.

**NENI 31**

Autoriteti Kontraktor e ndal kete kamate vonese nga situacioni perfundimtar dhe ne rast se kjo nuk mjafton e pjesen tjeter e ndal nga garancia qe kontraktuesi ka derdhur ne llogari te Autoritetit Kontraktor per garantimin e perfundimit te punimeve.

**NENI 32**

Ne rast te zgjidhjes se kesaj kontrate pala qe e zgjidh ate do te njoftoje menjehere me shkrim palen tjeter dhe do te kerkoje zbatimin e te gjitha detyrimeve qe percaktohen ne kontrate për aq sa është realizuar deri në atë moment.

**NENI 33**

Ne cdo rast te zgjidhjes se kontrates kontraktuesi detyrohet te ndaloje menjehere punimet, te largoje mjetet dhe materialet nga kantieri, te siguroje ruajtjen e objektit deri ne marrjen ne dorezim nga Autoriteti Kontraktor dhe te paraqese siguracionin per punimet e kryera. Autoriteti Kontraktor brenda 30 diteve duhet te marre ne dorezim punimet e kryera dhe te beje likuidimin e pageses.

**NENI 34**

Kur konstatohen gabime të zbatimit të projektit apo shkelje të cilesise se punimeve nga kontraktuesi por qe nuk mund te riparohen dhe nuk ndikojne negativisht ne anen konstruktive apo funksionale te objektit Autoriteti Kontraktor ka te drejte qe nga garancia e kontraktuesi te mbaje nje vleren përkatëse.

**NENI 35**

Kontraktuesi me perfundimin e punimeve njofton me shkrim Autoritetin Kontraktor se objekti eshte perfunduar plotesisht pa asnje te mete dhe eshte i gatshem per t'u kolauduar dhe per tu marre ne dorezim.

**NENI 36**

Autoriteti Kontraktor me marrjen e këtij njoftimi nga supervizori brenda 30 diteve duhet te beje kolaudimin dhe marrjen ne dorezim te objektit ne perputhje te plote me dispozitat ligjore e nenligjore ne fuqi.

**NENI 37**

Ne qofte se Autoriteti Kontraktor gjate periudhes se kolaudimit dhe marrjes ne dorezim te objektit konstaton të meta apo mangesi të cdo natyre qofshin ato, mban proces-verbal te vecante duke caktuar nje afat per riparimin e te metave dhe plotesimin e mangesive nga kontraktuesi me shpenzimet e ketij te fundit.

**NENI 38**

Ne rast se pas 15 ditësh, kontraktuesi nuk ka filluar punen per riparimin e mangesive, Autoriteti Kontraktor ka te drejte te caktoje nje sipermarres tjeter per riparimin e te metave dhe plotesimin e mangesive dhe te gjitha shpenzimet e kryera i ndalen kontraktuesit te pare nga pagesa e llogarise perfundimtare dhe ne rast se kjo nuk eshte e mjaftueshme i ndalen nga garancia.

**NENI 39**

Kontraktuesi është i detyruar te shlyeje të gjitha taksat, tatimet, siguracionet e nevojshme qe parashikohen ne dispozitat ligjore e nenligjore ne fuqi.

**NENI 40**

Per taksat e percaktuara me legjislacionin qe ka hyre ne fuqi 28 dite para hapjes se ofertave te cilave kontraktuesi duhet t'i kete te parashikuara ne vleren e kontrates, Autoriteti Kontraktor nuk do te njohe asnje shtese ne pagese.

**NENI 41**

Çdo mosmarveshje qe mund te linde gjate zbatimit te kesaj kontrate do te zgjidhet me mirekuptim nepermjet bisedimeve te drejteperdrejta nga palet. Ne rast se mosmarreveshja nuk do te mund te zgjidhet me mirekuptim atehere pala e interesuar ka te drejte te kaloje çeshtjen ne Gjykaten e Rrethit Gjyqesor Shkoder, per ta zgjidhur ate.

**NENI 42**

Kjo kontrate u lexua dhe u nenshkrua nga palet pa verejtje dhe me vullnetin e lire kontraktor. Kjo kontrate eshte e detyrueshme per zbatim dhe sjell efekte juridike nga momenti i nenshkrimit te saj deri në përfundim të të gjithë objektit. Perpilimi i saj behet ne 5 (pesë) kopje ku, një kopje e merr perfaqesuesi i firmes dhe të tjerat i mban Autoriteti Kontraktor.

Pjesë e kësaj kontrate janë kushtet e përgjithshme dhe të vecanta të saj.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MALËSI E MADHE
BETONPLUS COMPANY sh.p.k. je vetëm beton...
NIKA SH.P.K. NIPT L75705047U SHKODER-ALBANIA

## KUSHTET E PËRGJITHSHME TË KONTRATËS

### Punët – Procedura e Hapur

**Neni 1: Qëllimi**

1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për kryerjen e Punëve të prokuruara ne bazë të legjislacionit të prokurimit.

1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërise parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.

1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.

1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e parashikuara në pjesë të tjera të kontratës.

1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

**Neni 2: Përkufizime**

2.1 "Preventiv total" do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt te cilat jane orientuese, plotesuar me cmimin total të përcaktuar që është pjesë e Ofertes në një kontratë me çelsa ne dore.

2.2 "Preventiv per njesi" do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt shoqeruar me cmimet per njesi te pandryshuara që janë pjesë e Ofertes në një kontratë me punime ne matje.

2.3 "Afati i realizimit te punimeve" do të thotë data që Punët duhet të perfundojnë siç është shprehur në Grafikun për realizimin Punimeve , e vertetuar nga enti prokurues.

2.4 "Kontratë" do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe kontraktorit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjitjet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.

2.5 "Cmim kontrate" do të thotë çmimi që i paguhet kontraktorit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.

2.6 "Realizimi i punimeve" do të thotë data e vërtetuar nga Autoriteti Kontraktor se Punët janë mbaruar.

2.7 "Defekt" do të thotë çdo pjesë e Punimeve e paperfunduar në përputhje me kontratën.

2.8 "Data e hyrjes" do të thotë data që Autoriteti Kontraktor lejon kontraktorin në kantier.

2.9 "Data e fillimit" eshte perfshire ne Të dhënat e kontrates. Ajo eshte data kur kontraktori do të filloje punimet e ndertimit. Në se kjo nuk realizohet, "data e fillimit "do te jete dita në të cilën do të paguhet paradhenia.

2.10 "Pajisje" do të thotë makineritë dhe veglat e kontraktorit të sjella përkohësisht në kantier për realizimin e Ndertimeve.

2.11 "Materiale" do të thotë të gjitha furnizimet, duke përfshirë ato të konsumit, të përdorura nga kontraktori për kryerjen e punimeve.

2.12 "Objekt i kontratës" do të thotë të gjitha Punët që kontraktori do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.

2.13 "Palë(t)" do të thotë nënshkruesit e kontratës.

2.14 "Drejtues projekti" do të thotë personi i emëruar nga Autoriteti Kontraktor që është përgjegjës për administrimin e kontratës për Autoritetin Kontraktor.

2.15 "Autoritet Kontraktor" do të thotë Autoriteti Kontraktor qe eshte pjese e kesaj kontrate dhe që kontrakton punët objekt i kësaj kontrate. Ky term kudo qe përdoret ka kuptim të njëjtë me ate te perkufizuar ne ligj.

2.16 "Kantier" do të thotë vendi fizik i Punimeve.

2.17 "Raport i inspektimit të kantierit" do të thotë dokumentat e përfshira në dokumentat e tenderit që pasqyrojne informacion faktik dhe të interpretuar rreth kushteve të sipërfaqes dhe nëntokës së kantierit.

2.18 "Nënkontraktues" do të thotë çdo person fizik ose ligjor ose kombinim i mësipërm, që furnizon Punët, materialet ose pajisjet për ose në emër të kontraktorit.

2.19 "Kontraktor" do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate siguron Punimet.

2.20 "Standarte Teknike" do të thotë specifikimet e aprovuara nga një trup i posaçëm standartizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarte të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose përkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.

2.21 "Ngritja e kantierit" do të thotë punimet e ndertimit të përkohshme, të ndërtuara e instaluara, që janë të nevojshme për zbatimin e punimeve të ndërtimit.

2.22 "Punime" do të thotë ajo që Autoriteti Kontraktor i kërkon nga kontraktori të gërmojë, ndërtojë, riparojë, rinovojë ose instalojë siç parashikohet në dokumentat e tenderit duke përfshirë shërbimet në lidhje me to, gjithashtu të përkufizuara në dokumentat e tenderit.

**Neni 3: Hartimi i Kontratës**

3.1 Njoftimi i ofertes fituese do të sherbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në dokumentat e tenderit.

3.2 Ekzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke sanksionuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

**Neni 4: Praktikat e Korruptuara, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve**

4.1 Autoriteti Kontraktor mund t'i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se kontraktori ka kryer veprime të korruptuara. Veprimet e korruptuara përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.

4.2 Kontraktori nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ent që ka marrë pjesë në pregatitjen e dokumentave të tenderit për këtë prokurim.

4.3 Kontraktori duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t'i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

**Neni 5: Informacioni Konfidencial**

5.1 Kontraktori dhe Autoriteti Kontraktues duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.

5.2 Kontraktori mund t'i japë nënkontraktorit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar qe nënkontraktorin të zbatojë punën e tij sipas kontatës. Në rast të tillë, kontraktori duhet të përfshijë në kontratën e tij me nënkontraktorin një dispozitë që premton ruajtjen e konfidencës siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

**Neni 6: Prona Intelektuale**

6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës do t'i përkasin Autoritetit Kontraktor i cili mund t'i përdorë ato sipas gjykimit të tij.

6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, kontraktori, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i dorëzojë Autoritetit Kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramët, skicimet, specifikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose pregatitura nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës. Kontraktori mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, po nuk duhet t'i përdori për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.

6.3 Kontraktori duhet të garantojë Autoritetin Kontraktor zhveshjen nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale, që mund të dalin nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër sipas kontratës.

6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër të mbrojtur e të furnizuar sipas kontratës,

kontraktori duhet t'i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të kontraktorit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

**Neni 7: Origjina e Materialeve**

7.1 Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së materialeve, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.

7.2 Kontraktori mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e materialeve.

7.3 Për qëllime verifikimi "origjinë" do të thotë vendi ku materialet janë nxjerrë, bashkuar ose prodhuar. materialet janë prodhuar kur, nëpërmjet prodhimit, procesimit, ose mbledhjes së mjaftueshme të komponentëve, rezulton një produkt i ri i njohur në tregti që është mjaft i ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentët e tij.

7.4 Origjina e materialeve ka dallim nga kombësia e kontraktorit ose nënkontraktorit që furnizon me materiale.

**Neni 8: Vendimet e Drejtuesit të Projektit**

8.1 Drejtuesi i projektit do të vendosë për çështjet e kontratës midis kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor

8.2 Drejtuesi i Projektit mund të delegojë ndonjë nga detyrat dhe përgjegjësitë e tij tek të tjerët përveç zgjidhjen e mosmarrveshjeve dhe konflikteve. Drejtuesi i projektit duhet të njoftojë kontraktorin për delegimet e bëra apo të revokuara.

**Neni 9: Komunikimi**

9.1 Çdo komunikim midis palëve duhet të bëhet me shkrim.

**Neni 10: Bashkëpunimi në Kantier me të Tjerët**

10.1 Kontraktori duhet të bashkëpunojë dhe të ndajë kantierin me firma të tjera, autoritete publike, shërbimet publike dhe Autoritetin Kontraktor siç kërkohet dhe përkufizohet në Grafikun e realizimit te punimeve.

**Neni 11: Përgjegjësia e Autoritetit Kontraktor**

11.1 Autoriteti Kontraktor ka përgjegjësi të kompensojë kontraktorin për dëmtime të pajisjeve të kontraktorit deri në masën që lidhet me veprime me faj të Autoritetit Kontraktor ose të projekteve të Autoritetit Kontraktor me perjashtim te rastit kur keto te fundit, kishin gabime te dukshe qe mund te ishin konstatuar lehtesisht nga kontraktuesi.

**Neni 12: Raporti i Inspektimit të Kantierit dhe Kushtet e Kantierit**

12.1 Autoriteti Kontraktor nuk mban asnjë përgjegjësi për konkluzionet ose interpretimet e bëra në raportin e inspektimit të kantierit.

12.2 Kontraktori pranon se i ka marrë të gjitha hapat e nevojshme për të verifikuar natyrën dhe vendin e Punimeve dhe se ka inspektuar dhe pajtohet me kushtet e përgjithshme dhe lokale që mund të ndikojnë në kryerjen ose koston e Punëve.

**Neni 13: Kontraktori që Kryen Punimet**

13.1 Kontraktori duhet të kryejë dhe mbarojë Punimet në përputhje me specifikimet teknike të paraqitura në dokumentat e tenderit.

13.2 Kontraktori nuk mban përgjegjësi për gabimet në projekt, të dhëna, planimetri ose aspekte të tjera të specifikimeve teknike, të dhëna nga Autoriteti Kontraktor, me përjashtim të rasteve kur gabimi ishte aq i dukshëm sa kontraktori duhet ta kishte vëne re dhe ta kishte reklamuar këtë te Autoriteti Kontraktor.

13.3 Kodet dhe standartet që do zbatohen do të jenë të shprehura në dokumentat e tenderit. Nëse gjatë egzekutimit të kontratës, ka ndryshime në zbatimin e kodeve ose standarteve, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pasi të jenë aprovuar nga Autoriteti Kontraktor.

**Neni 14: Ekzekutimi i Punimeve**

14.1 Kontraktori duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëherë sapo ta lidhe atë dhe duhet t'i mbarojë Punët brenda Afatit të Mbarimit.

**Neni 15: Ngritja e Kantierit**

15.1 Kontraktori mban përgjegjësi për projektin e Ngritjes se Kantierit.

15.2 Kontraktori duhet të paraqesë të gjitha planet për Ngritjen e Kantierit tek drejtuesi i projektit për shqyrtimin dhe miratimin e tij.

**Neni 16: Sigurimi Teknik dhe Mjedisor**

16.1 Kontraktori do të mbajë përgjegjësi për sigurinë e të gjitha aktiviteteve në kantier.

16.2 Kontratori do të sigurojë kantierin në mënyrë të tillë që të minimizojë dëmtimet e mjedisit. Për shembull, ai duhet të kursejë energjinë, ujin dhe burime të tjera, të reduktojë humbjen dhe të minimizojë përdorimin e substancave varfëruese të ozonit, çlirimin e gazrave, Lëndët e përbëra organike te rezikshme dhe substanca të tjera, që dëmtojnë shëndetin dhe mjedisin.

**Neni 17: Zbulimet**

17.1 Çdo gjë me interes historik ose me vlerë të konsiderueshme e zbuluar papritur në kantier do të deklarohen per te vepruar konform legjislacionit ne fuqi. Kontraktori duhet të njoftojë drejtuesin e projektit për ndonjë zbulim të tillë dhe të ndjekë udhezimet e drejtuesit të projektit për procedurën e administrimit të objekteve.

**Neni 18: Disponimi i Kantierit**

18.1 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi të drejtën e disponimit të kantierit kontraktorit në datën e hyrjes të shprehur në dokumentat e tenderit. Nëse disponimi i ndonjë pjese të kantierit nuk jepet brenda datës së hyrjes për kantierin ose asaj pjese të kantierit siç parashikohet në

dokumentat e tenderit, do të konsiderohet se Autoriteti Kontraktor ka vonuar fillimin e zbatimit të kontratës, dhe kontraktorit i lind e drejta të kërkoje amendimin e kontratës në lidhje me shtyrjen e Afatit të Mbarimit. Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori do të mbajnë procesverbal për datën e hyrjes.

**Neni: 19: Raportimi i Grafikut të Zbatimit**

19.1 Menjëherë pas lidhjes së kontratës, kontraktori duhet t'i paraqesë drejtuesit të projektit një program plani që tregon metodat e përgjithshme, rregullimet, porositë, afatet dhe rrugët kritike për aktivitetet e Punimeve .

19.2 Në intervale të skeduara rregullisht siç është aprovuar nga drejtuesi i projektit, kontraktori duhet të përgatisë raportime duke treguar progresin e arritur në çdo aktivitet dhe efektet e progresit në punën e mbetur, duke përfshirë çdo ndryshim në sekuencën e aktiviteteve.

**Neni 20: Paralajmërimi në Kohë**

20.1 Kontraktori duhet të paralajmërojë drejtuesin e projektit sa më shpejt të jetë e mundur për ngjarje dhe rrethana specifike që mund të ndodhin në të ardhmen apo që mund të ndikojnë negativisht në zbatimin e kontratës, duke përfshirë cilësinë e punës dhe vonesën në afate.

**Neni 21: Kontrolli i Cilësisë**

21.1 Kontraktori do të jetë plotësisht përgjegjës për kontrollin e cilësisë dhe zbatimin e kontratës.

21.2 Sapo të lidhë kontratën, kontraktori duhet t'i paraqesë drejtuesit të projektit një plan për kontrollin e cilësisë së aktiviteteve në zbatimin e kontratës.

21.3 Drejtuesi i projektit duhet të kontrollojë punën e kontraktorit dhe të njoftojë kontraktorin për defekte që mund të jenë gjetur.

21.4 Sa herë që të jepet njoftimi për defekte, kontraktori duhet të korrigjojë defektin brenda afatit të parashikuar në njoftim.

**Neni 22: Defektet e Pakorrigjuara**

22.1 Nëse kontraktori nuk e ka korrigjuar një defekt brenda kohës së specifikuar në njoftimin për defektin nga drejtuesi i projektit, drejtuesi i projektit do të llogarise koston e korrigjimit të defektit dhe kjo shumë do të mbahet nga çdo pagesë që i duhet bërë kontraktorit deri sa defekti të korrigjohet. Dështimi për të korrigjuar defektin brenda një afati të arsyeshëm përbën shkak për zgjidhje kontrate për arsye mospërmbushje në favor të Autoriteti Kontraktor.

**Neni 23: Përgjegjësitë e Autoriteti Kontrakotr**

23.1 Nga Afati i fillimit deri në Afatin e Realizimit te Plote, Autoriteti Kontraktor do të jetë përgjegjës për:

(a) dëmtim personal, vdekje ose humbje apo dëmtim të pasurisë për shkak të neglizhencës ose ndërhyrjes, qoftë edhe të ligjshme nga Autoriteti Kontraktor apo nga çdo person i punësuar/ kontraktuar nga Autoriteti Kontraktor, përveç kontraktorit.

(b) dëmtim të Punimeve, materialeve dhe pajisjeve deri në ate masë qe lidhet me fajin e Autoritetit Kontraktor apo me projektin e tij.

**Neni 24: Përgjegjësitë e kontraktorit**

24.1 Nga Afati i fillimit deri në Afatin e Realizimit, kontraktori do të jetë përgjegjës për dëmtim personal, vdekje ose humbje apo dëmtim të pasurisë, dhe pasuri të tjera dhe që nuk mbulohen nga Autoriteti Kontraktor sipas Nenit 23.

**Neni 25: Sigurimi**

25.1 Kontraktori duhet të sigurojë objektin, me emra të përbashkët të Autoritetit Kontraktor dhe kontraktorit, nga data e hyrjes ne kantier deri në afatin e realizimit të plote, në shumat e shprehura në KVK për humbje ose dëmtim të punimeve, pajisjeve, materialeve; humbje ose dëmtim të kantierit ose pronave të tjera në kantier dhe dëmtimet personale ose vdekjet e palëve të treta.

25.2 Polica e sigurimit do të dorëzohet tek drejtuesi i projektit për aprovim brenda 30 ditëve pas shpalljes së fituesit të kontratës. Ky siguracion duhet të mbulojë kompensimin e kërkuar për të kompensuar humbjen ose dëmin e shkaktuar. Nëse kontraktori dështon të sigurojë policën e sigurimit, kontrata do të konsiderohet e anulluar. Megjithatë, Autoriteti Kontraktor, mund të vendosë të zgjasë periudhën e paraqitjes të policës së sigurimit ose të bëjë vetë siguracionin dhe të zbresi koston e tij nga pagesa që i jep kontraktorit.

25.3 Kushtet e siguracionit nuk mund të ndryshohen pa aprovimin paraprak të Autoritetit Kontraktor.

**Neni 26: Testimet dhe Inspektimet**

26.1 Kontraktori duhet të bëjë të gjitha testet dhe inspektimet e kërkuara nga dispozitat e kontratës. Kosto e këtyre testimeve dhe inspektimeve duhet të financohet tërësisht nga kontraktori brenda çmimit të kontratës

26.2 Autoriteti Kontraktor me shpenzimet e tij, ka të drejtë të ndjekë testimet dhe/ose inspektimet. Nëse materialet prodhohen ose pregatiten në vende të ndryshme nga ato të kontraktorit, kontraktori duhet të sigurojë leje për Autoritetin Kontraktor për të ndjekur këto testime dhe inspektime.

26.3 Autoriteti Kontraktor gjithashtu mund t'i kërkojë kontraktorit të bëjë testime ose inspektime shtesë të paparashikuara në kontratë por të gjykuara të nevojshme për të verifikuar se Punimet janë konform specifikimeve dhe kushteve të kontratës. Autoriteti Kontraktor do të mbajë përgjegjësi për koston e këtyre testimeve. Gjithashtu, nëse këto teste ndalojnë progresin e punës së kontraktorit, Autoriteti Kontraktor do të bjerë dakort të ndryshojë grafikun.

26.4 Autoriteti Kontraktor do të refuzojë çdo punim që nuk e kalon testimin dhe/ose inspektimin ose nuk është konform specifikimeve teknike dhe kushteve të kërkuara në zbatimin e kontratës.

26.5 As ekzekutimi i testeve as inspektimi i punimeve nuk do ta lirojë kontraktorin nga çdo garanci ose detyrim tjetër sipas kontratës.

**Neni 27 Garancitë**

27.1 Kontraktori garanton se materialet e trupëzuara me punët janë të reja, të papërdorura dhe të modeleve të fundit dhe se trupëzojnë përmirësimet e fundit në projekt dhe materiale, me përjashtim kur parashikohet ndryshe në kontratë.

27.2 Me përjashtim të ndonjë parashikimi në kontratë ose nga ligji, kontraktori garanton se materialet nuk kanë defekte të shkaktuara nga ndonjë veprim ose mosveprim i kontraktorit apo të shkaktuara nga projektimi, materialet dhe puna nën kushte normale përdorimi, për kushtet që mbizotërojnë në Shqipëri.

**Neni 28: Çmimi i Kontratës**

28.1 Çmimet e kontraktorit për Punët e kryera sipas kontratës nuk duhet të ndryshojnë nga çmimet e ofruar nga kontraktori në ofertën e tij.

**Neni 29: Kushtet e Pagesës**

29.1 Çmimi i kontratës, duke përfshirë edhe pagesat paraprake, duhet të paguhen siç specifikohet në kontratë.

29.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet më një dispozitë tjetër në kontratës, pagesa do të bëhet me monedhë Shqiptare. Kursi i këmbimit të monedhave të ndryshme do të jetë kursi i Bankës së Shqipërisë në ditën kur është dërguar për publikim njoftimi i kontratës dhe i përcaktuar në kontratë.

29.3 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, kontraktori ka të drejtë të marrë pagesa periodike gjatë progresit të zbatimit të projektit. Grafiku i pagesave periodike do të parashikohet në KVK. Kur bëhet një pagesë e parashikuar, kontraktori duhet të paraqese nje deklarate me situacionin e muajit tek drejtuesi i projektit ku deklaron se plani sipas grafikut është permbushur. Komunikata gjithashtu duhet të shprehë vlerën e punës së ekzekutuar duke hequr shumën e grumbulluar të verifikuar më parë, si dhe shumën e pagesës paraprake të papaguar dhe çdo shumë të mbajtur në pritje të korrigjimit të një defekti.

29.4 Drejtuesi i projektit duhet të kontrollojë punimet e ekzekutuara nga kontraktori dhe duhet të verifikojë shumën që duhet t'i paguhet kontraktorit, brenda 20 ditëve pune nga data që kontraktori paraqet komunikatën e tij tek drejtuesi i projektit.

29.5 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, pagesa e periodike për Punët do të bëhet brenda 30 ditëve kalendarike nga data që progresi i grafikut të zbatimit është verifikuar nga drejtuesi i projektit.

29.6 Data e pagesës do të jetë dita që fondet xhirohen nga llogaria e Autoritetit Kontraktor.

**Neni 30: Vonesa në Bërjen e Pagesës**

30.1 Shperblimi per demet e shkaktuara si rezultat i vonesës në pagesë konsiston në kamaten e arritur nga data e fillimit te vonesës së debitorit (Autoriteti Kontraktor), në monedhën zyrtare të vendit ku do të bëhet pagesa. Përqindja e kamates parashikohet me ligj. Në fund të çdo viti kamatat e arrira i shtohen shumës totale, mbi të cilën është bërë llogaritja e tyre.

30.2 Kamata ligjore paguhet pa qene i detyruar kreditori ( kontraktori) te provoje ndonje dem. Nëse kreditori (kontraktori) provon se ka pesuar nje dem me te madh se kamata ligjore, debitori (Autoriteti Kontraktor ) duhet të paguajë pjesën e mbetur të demit.

**Neni 31: Nryshimi i Ligjeve dhe Rregulloreve**

31.1 Nëse pas datës së nënshkrimit të kontratës, ndonjë ligj, rregullore, urdhëresë, urdhër ose procedurë me efektin e ligjit në Republikën e Shqipërisë hyn në fuqi, nxirret ose ndryshon dhe ndikon kushtet, duke përfshirë datën e dorëzimit, ose çmimin e kontratës, kushtet ose çmimi i kontratës do të rregullohen në atë masë sa kontraktori është ndikuar në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kontratës.

**Neni 32: Forca Madhore**

32.1 Kontraktori nuk duhet të mbajë përgjegjësi për humbjen e sigurimit te kontrates, dëmeve të likuidueshme ose ndërprerjen për mosplotësim, nëse dhe deri në masën që vonesa në zbatim ose ndonjë dështim tjetër në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kontratës, vijnë si pasojë e ngjarjeve të Forcës Madhore.

32.2 Për qëllimet e këtij neni "Forcë Madhore" do të thotë një ngjarje jashtë kontrollit të kontraktorit dhe e paparashikueshme. Ngjarje të tilla mund të përfshijnë, por nuk kufizohen nga, veprimet e Autoritetit Kontraktor, qoftë në kapacitetin e tij sovran ose kontraktual, lufta ose revolucionet, zjarri, përmbytja, tërmeti, epidemitë, shtrëngime të karantinës dhe embargo tranziti.

32.3 Nëse ndodh ndonjë situatë e Forcës Madhore, kontraktori duhet të njoftojë menjehere Blerësin Publik. Me përjashtim kur Autoriteti Kontraktor jep udhëzime të ndryshme, kontraktori duhet të vazhdojë të zbatojë detyrimet e tij sipas kontratës në masën praktikisht të arsyeshme dhe duhet të kërkojë të gjitha mjetet e arsyeshme për zbatimin që nuk pengohet nga Forca Madhore.

**Neni 33: Vonesa në Zbatim dhe Zgjatja e Afatit**

33.1 Me përjashtim kur parashikohet ndryshe, kontraktori duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëherë pas nënshkrimit të saj.

33.2 Me përjashtim kur Autoriteti Kontraktor është dakort për zgjatje të afatit të kontratës, ka të drejtë të kërkojë dëmet për vonesën në zbatim, nëse kontraktori dështon në dorëzimin e punës brenda Afatit së Dorëzimit të Plotë të specifikuar në kontratë.

33.3 Autoriteti Kontraktor mund të zbresë shumën e dëmeve të likuidueshme që duhen paguar nga shuma e pagesës ndaj kontraktorit. Në rast të tillë Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi kontraktorit njoftim me shkrim për shumën dhe arsyen e zbritjes.

33.4 Autoriteti Kontraktor do të jetë dakort për një zgjatje të afatit, në rastin e Forcës Madhore.

33.5 Autoriteti Kontraktor, mund të jetë dakort për zgjatje të afatit edhe në rrethana të tjera në se është në interesin publik për ta bërë këtë. Ne rast se kontraktori ndeshet me kushte që pengojnë zbatimin në kohë, kontraktori duhet të njoftojë menjehere Autoritetin Kontraktor me shkrim për vonesën, shkakun dhe datën e propozuar të dorëzimit ose përfundimit. Autoriteti Kontraktor duhet të vlerësojë kërkesën. Nëse Autoriteti Kontraktor është dakort



REPUBLIKA E SHQIPERISE - BASHKIA MALESI E MADHE
BETONPLUS COMPANY jo vetem beton...
NIKA SH.P.K. NIPT: J76700047U SHKODER-ALBANIA

me vonesën, zgjatja do të hyjë në fuqi me një amendament me shkrim të kontratës të nënshkruar nga Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori.

**Neni 34: Dëmet e Likujdueshme për Vonesën në Mbarimin e Punimeve**

34.1 Dëmet e likuidueshme për vonesën në mbarimin e Punimeve do të llogariten me tarifat e mëposhtme ditore:

Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 6 muaj, tarifa ditore do të jetë 4/1000 të vlerës korresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës, por kjo vlere do te llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontrates.

Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 2/1000 të vlerës korresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës, por kjo vlere do te llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontrates.

Për kontratat me periudhë zbatimi më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 1/1000 të vlerës korresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës, por kjo vlere do te llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontrates.

**Neni 35: Negociatat dhe Amendamentet**

35.1 Palët nuk do të negociojnë ndryshime ose amendamente të asnjë kushti të kontratës që do të ndryshonte dukshëm kushtet që përbëjnë bazën e përzgjedhjes së kontraktorit.

35.2 Asnjë amendament ose variacion tjetër i kontratës nuk do të jetë i vlefshëm pa qënë me shkrim, me datë, i referohet shprehimisht kontratës dhe nënshkruhet nga një përfaqsues i autorizuar i kontraktorit dhe Autoriteti Kontraktor.

35.3 Çdo heqje dore nga të drejtat, pushtetet ose ndreqjet që mund të bëhen nga palët sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim, të ketë datë dhe të firmoset nga një përfaqsues i autorizuar i palës që bën këtë dorëheqje dhe duhet të specifikojë të drejtën dhe masën në të cilën ajo lëshohet.

**Neni 36: Ndryshimi i Porosisë**

36.1 Kushtet e kontratës nuk janë subjekt rinegocimi dhe amendimi pas hyrjes në fuqi me përjashtim kur lejohet specifikisht dhe parashikohet në kushtet e kontratës. Çdo amendament i kontratës duhet të bëhet me shkrim dhe firmosur nga Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori.

36.2 Ndertime shtesë mund të porositen vetëm në rethana të përcaktuar në LPP dhe me kusht që shtesa e kontratës të mos i kalojë 20% të çmimit origjinal të kontratës.

36.3 Autoriteti Kontraktor në çdo kohë, mund të porosisë kontraktorin të bëjë ndryshime brenda qëllimit të përgjithshëm të kontratës në secilin nga elementët e më poshtëm:

Korrigjime në projektin, vizatimin ose specifikimet e Punëve

Korrigjime në materiale

Korrigjime në sasi

36.4 Përpara se të kërkojë një ndryshim, Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori duhet të bien dakort për çdo rritje ose ulje të çmimit të kontratës dhe/ose ndryshim në grafikun e zbatimit ose përfundimit që është shkaktuar nga ndryshimi. Porosia e ndryshuar duhet të materilizojë amendamentet e marrveshjes. Autoriteti Kontraktor nuk ka të drejtë të nxjerrë



BETONPLUS COMPANY jo vetëm beton...

NIKA SH.P.K. NIPT: J76705047U SHKODER-ALBANIA

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MALËSI E MADHE

pretendime për pajtimin me ndryshimin e porositur përveç rregullimeve të siguruara në amendamentet e marrveshjes.

36.5 Ndryshimi i porosise nuk do te jete i vlefshem nese nuk formalizohet sipas kerkesave te Nenit 35 te ketyre kushteve te pergjithshme.

**Neni 37: Preventivi për Njësi ose në Total**

37.1 Kontrata do të përfshijë një Preventiv në Total nëse është një kontratë me shumë totale ose një Preventiv për Njësi nëse është një kontratë me çmim njësie. Nëse është një kontratë me çmim njësie, preventivi për njësi do të përmbajë volumet e zërave të ndërtimit, instalimin, testimin dhe komisionet që bëhen nga kontraktori.

37.2 Preventivi për Njësi do të përdoret për të llogaritur çmimin e kontratës. Kontraktori do të paguhet për sasinë e realizuar me tarifën në preventivin në njësi për secilin zë punimesh.

**Neni 38: Mbarimi dhe marrja përsipër e ndërtimeve**

38.1 Kontraktori duhet t'i kërkojë drejtuesit të projektit t'i lëshojë një certifikatë për mbarimin e Punimeve dhe drejtuesi i projektit do t'a bëjë këtë sapo të vendosi se Punimet janë mbaruar plotësisht.

38.2 Nëse drejtuesi i projektit zbulon se Punimet nuk janë përfunduar plotësisht, drejtuesi i projektit do t'i japi udhezime me shkrim kontraktorit që specifikojnë zerat e punimeve ose aktivitetet që duhen përfunduar para se të lëshohet certifikata.

38.3 Nëse drejtuesi i projektit zbulon defekte në Punime, drejtuesi i projektit duhet t'i japi kontraktorit njoftim me shkrim duke specifikuar defektet që duhet të korrigjohen para se të lëshohet certifikata.

**Neni 39: Ndërprerja për Mosplotësim**

39.1 Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në tërësi ose pjesërisht nëse:
a) kontraktori dështon në kryerjen e Punëve brenda periudhës së specifikuar në kontratë ose brenda zgjatjes së dhënë; ose,
b) kontraktori dështon të zbatojë ndonjë detyrim tjetër të kontratës.

39.2 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi kontraktorit njoftim me shkrim për ndërprerjen për mosplotësim dhe t'i japi kontraktorit 15 ditë të ndreqë mosplotësimin me përjashtim kur ndërprerja është bërë për veprime të korruptuara ose të paligjshme, rast në të cilin ndërprerja do të jetë e menjëhershme.

39.3 Të gjitha materialet, Ngritja e Kantierit dhe Punët e përfundura do të bëhen pronë e Autoriteti Kontraktor nëse kontrata ndërpritet për mosplotësim te kushteve te saj

**Neni 40: Ndërprerja për Shkak të Falimentimit**

40.1 ________________________________ Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse kontraktori falimenton ose bëhet i paaftë të paguajë.

40.2 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi kontraktorit njoftim me shkrim për ndërprerjen.

**Neni 41: Ndërprerja për Shkak të Interesit Publik**

41.1 Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse gjykon se ky veprim duhet ndërmarrë për t'i shërbyer sa më mirë interesit publik.

41.2 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi kontraktorit lajmërim me shkrim për ndërprerjen.

41.3 Autoriteti Kontraktor duhet të paguajë kontraktorin për të gjitha Punët e pranuara dhe të kryera përpara ndërprerjes dhe duhet t'i paguajë kontraktorit dëmet e shkaktuara për kryerjen e pjesshme të Punëve. Në llogaritjen e shumës së dëmeve, kontraktori do të kërkohet të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të minimizuar dëmet.

**Neni 42: Nënkontraktimi**

42.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është në formën e një marrveshjeje të shkruar me anë të së cilës kontraktori i beson kryerjen e një pjese të detyrimeve të kontratës së tij një pale të tretë.

42.2 Kontraktori nuk duhet të nënkontraktojë pa aprovimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktor. Kontraktori duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktor për elementet e kontratës që nënkontraktohet dhe dokumentacinin që provon aftësine e nën-kontraktorit. Autoriteti Kontraktor duhet të lajmërojë kontraktorin për vendimin e tij, brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke shprehur arsyet nëse e aprovon apo jo atë.

42.3 Cdo nenkontraktor duhet te kete te drejte te marre pjese ne prokurimin publik sipas Ligjit mbi Prokurimin Publik. Autoriteti mund të parashikojë pagesa direkete tek nënkontraktori për punët që do të kryejë

42.4 Kontraktori mbetet plotësisht përgjegjës për zbatimin e kontratës pavarësisht nga sjellja e nenkontraktorit.

**Neni 43: Transferimi i të Drejtave**

43.1 Kontraktori nuk duhet të transferojë, tërësisht ose pjesërisht, detyrimet e tij sipas kontratës me përjashtim kur jepet miratimi paraprak nga Autoriteti Kontraktor.

**Neni 44: Sigurimi i Kontrates**

44.1 Përpara nënshkrimit të kontratës, kontraktuesi duhet ti dorëzojë Autoriteti Kontraktor sigurimin e kontratës në shumën dhe formën e kërkuar.

44.2 Shuma e sigurimit te kontrates duhet t'i paguhet Autoriteti Kontraktor si kompensim për çdo humbje të rezultuar nga dështimi i kontraktori në plotësimin e detyrimeve të tij sipas kontratës.

44.3 Sigurimi i kontrates do t'i kthehet kontraktorit jo më vonë se 30 ditë pas datës sëmarrjes në dorëzim të punimeve. Megjithatë, pesë (5) përqind e sigurimit do të mbahet deri në përmbushjen e kënaqshme të detyrimeve të garancisë.

**Neni 45: Baza Ligjore**

45.1 Kontrata do të rregullohet dhe interpretohet sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.

**Neni 46: Zgjidhja e Mosmarrveshjeve**

46.1 Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori duhet të bëjnë çdo përpjekje të zgjidhin mosmarrveshjet ose konfliktet e ndodhura midis tyre ose në lidhje me këtë marrveshje me negociata direkte.

46.2 Në se palët dështojnë në zgjidhjen e mosmarrveshjes ose konfliktit, ato i drejtohen zgjidhjes së marrveshjeve sipas kontratës dhe procedurave juridike në fuqi sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë.

**Neni 47: Përfaqsimi i Palëve**

47.1 Çdo palë duhet të emërojë me shkrim një person ose strukture organizative, që do të jetë përgjegjës, në emër të palës, për marrjen e komunikatave dhe për përfaqësimin e palës në çështjet e lidhura me egzekutimin e kontratës.

47.2 Secila palë duhet të lajmërojë palën tjetër menjëherë për ndonjë ndryshim në emërimin e përfaqsuesit të palës. Në se njëra palë dështon të lajmërojë, duhet të marri përsipër çdo humbje të shkaktuar nga dështimi për të dhënë njoftim të mjaftueshëm.

47.3 Palët mund të emërojnë persona ose struktura organizative shtesë për të përfaqsuar palën në veprime ose veprimtari të veçanta në të cilin rast njoftimi me shkrim duhet dhënë dhe duhet të përcaktojë shtrirjen e autoritetit të përfaqsuesit.

**Neni 48: Lajmërimet**

48.1 Çdo lajmërim i dhënë nga njëra palë tjetrës sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim në adresën e specifikuar në kontratë.

48.2 Njoftimi do të ketë efekt sapo të dorëzohet.

**Neni 49: Llogaritja e Afateve**

49.1 Të gjitha referencat e ditëve do të jenë ditë kalendarike me përjashtim kur parashikohet ndryshe.

## KUSHTET E VEÇANTA

**Punët – Procedura e Hapur**

Kushtet e veçanta të Kontratës do të plotësojnë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës. Në rast se ka mospërputhje midis KPK dhe KVK do të mbizotërojne Kushtet e veçanta të kontratës.

**Neni 1: Përkufizime**

1.1 Autoriteti Kontraktor është Bashkia Malesi e Madhe

1.2 Kontraktori është Bashkimi i operatoreve Beton Plus Company shpk dhe Nika shpk.

**Neni 2: Sigurimi i Kontrates**

2.1 Sigurimi i kontratës në shumën prej *(10% të vlerës së ofertës)* duhet të ofrohet nga kontraktori për të siguruar ekzekutimin e detyrimeve të tij sipas kontratës.

2.2 Sigurimi i kontratës do t'i lëshohet ose kthehet, menjëherë, kontraktorit sipas skedarit të mëposhtëm: Nr.Serial 0014401 tw Kompanisw sw Sigurimeve INTERSIG me date 22.01.2016

______________________________________________

______________________________________________

**Neni 3: Drejtuesi i Projektit**

3.1 Drejtuesi i Projektit do të jetë: ______________________

3.2 Adresa/pika e kontaktit:______________________

**Neni 4: Kantieri**

4.1 Kantieri i Punëve do të jetë (Pershkrimi i saktë i vendddodhjes së objektit që do të realizohet): **ne fshatin turistik Razem**

**Neni 5 Data e Fillimit**

5.1 Kontraktorit do t'i jepet leja për të hyrë në kantier më: ne daten e emrimit te mbikqyrsit.

**Neni 6: Siguracioni**

6.1 Nga Data e hyrjes deri në Afatin e Mbarimit kontraktori duhet të ketë siguracion që mbulon deri në shumën prej: sipas polices se sigurimit nr.serial 0000537 nr.135 date 22.01.2016 te kompanise INTERSIG

a. Për dëmtime ose humbje të Punëve dhe Materialeve: ______________

b. Për dëmtime ose humbje të Pajisjeve: ______________

c. Për dëmtime ose humbje të pasurisë përveç Punëve, Materialeve dhe Pajisjeve: __

d. Për dëmtim personal ose vdekje të personave në kantier: ______________

**Neni 7: Inspektimet dhe Testimet**

7.1 Inspektimet dhe testimet para vërtetimit të mbarimit të Punëve do të përfshijnë: ______________

______________________________________________

________________________________________

________________________________________

**Neni 8: Lloji i Kontratës**

8.1 Kjo kontratë do të çmohet si një

- ❑ Kontratë me Çmim Njësie të bazuar në çmimet e njësisë të shprehura në Preventivin në Njësi
- ❑ Kontratë me Shumë Totale

**Neni 9: Grafiku i Pagesës**

9.1 Pagesa duhet bërë sipas grafikut të mëposhtëm: ____________________________

________________________________________

9.2 Pagesa për Punët duhet bërë brenda ________ ditëve nga data që kontraktori paraqet një dokument që deklaron se objektivi për pagesën është arritur subjekt ky i konfirmimit të dokumentit nga drejtuesi i projektit. Nëse është lënë e paplotësuar, periudha kohore do të jetë 30 ditë.

9.3 Monedha e pagesës do të jetë ______. Nëse nuk është specifikuar, pagesa do bëhet me monedhën Shqiptare.

**Neni 10. Pagesa Paraprake**

10.1 Përqindja e pagesës paraprake do të jetë _____. Nëse nuk është specifikuar, kontraktori nuk do të marrë pagesë paraprake.

10.2 Nëse është premtuar një pagesë paraprake, avanca do të paguhet brenda ______ ditëve nga marrja e sigurimit te kontrates.

10.3 Nëse jepet pagesa paraprake, shuma do të hiqet nga pagesa që duhet t'i jepet kontraktorit sipas formulës së mëposhtme:________________________________

________________________________________

**Neni 11. Shërbimet në Lidhje me to**

11.1 Kushtet e veçanta të mëposhme do të zbatohen për kryerjen e pagesës së shërbimeve të lidhura

________________________________________

________________________________________

________________________________________

________________________________________

**Neni 12. Zbritja e garancisë së kontratës**

12.1 Nëse parashikohet zbritje periodike të garancisë së kontratës ajo kryhet si më poshtë

________________________________________

________________________________________

Nëse nuk plotësohet, garancia mbetet e pandryshuar.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA MALËSI E MADHE
BETONPLUS sh.p.k. COMPANY jo vetëm beton
NIKA SH.P.K. NIPT: J67050470 SHKODER-ALBANIA

PALET:

| AUTORITETI KONTRAKTOR | KONTRAKTUESI |
|---|---|
| Bashkia Malësi e Madhe<br>Kryetar<br>Tonin MARINAJ | Bashkimi i Operatorëve<br>Beton Plus Company<br>Përfaqësues me prokurë<br>Eduard PLLUMBAJ |
| | Nika SHPK<br>Administratore<br>Shpresa NIKA |

REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA MALESI E MADHE

# KONTRATË
# PUNË PUBLIKE

## *" REHABILITIMI I QENDRES SE QYTETIT KOPLIK "*

**2016**
**KOPLIK**
**MALËSI E MADHE**

REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA MALESI E MADHE

**Nr. 2860 Prot.** **Date: 07/11/2016**

# KONTRATË

(Punë Publike)

"Rehabilitimi i Qendres së Qytetit Koplik "

Në mbështetje të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, Ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 " Për Prokurimet Publike" i ndryshuar, VKM NR. 914 date 29.12.2014 " Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik",

Lidhur sot me datë ____.____.2016, nën vullnetin e plotë dhe të lirë, midis palëve:

**Bashkia Malësi e Madhe**, e përfaqësuar nga z. **Tonin Marinaj** (Kryetar), përfaqësues i vetëm që më poshtë do të quhet: ***"Autoriteti Kontraktor"***, dhe

**Operatorit Ekonomik** : " STERKAJ " shpk, me NIPT J68310708M , perfaqesuar nga z. Lulezim Sterkaj/ Administrator, qe me poshte do te quhen " ***Kontraktori*** ".

# KUSHTET E PËRGJITHSHME TË KONTRATËS

## Neni 1

## Qëllimi

1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për kryerjen e Punëve të prokuruara ne bazë të legjislacionit të prokurimit.

1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërise parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.

1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.

1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e parashikuara në pjesë të tjera të kontratës.

1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

## Neni 2

## Përkufizime

2.1 "Preventiv total" do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt te cilat jane orientuese, plotesuar me cmimin total të përcaktuar që është pjesë e Ofertes në një kontratë me çelsa ne dore.

2.2 "Preventiv per njesi" do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt shoqeruar me cmimet per njesi te pandryshuara që janë pjesë e Ofertes në një kontratë me punime ne matje.

2.3 "Afati i realizimit te punimeve" do të thotë data që Punët duhet të perfundojnë siç është shprehur në Grafikun për realizimin Punimeve , e vertetuar nga enti prokurues.

2.4 "Kontratë" do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe kontraktorit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjitjet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.

2.5 "Cmim kontrate" do të thotë çmimi që i paguhet kontraktorit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.

2.6 "Realizimi i punimeve" do të thotë data e vërtetuar nga Autoriteti Kontraktor se Punët janë mbaruar.

2.7 "Defekt" do të thotë çdo pjesë e Punimeve e paperfunduar në përputhje me kontratën.

2.8 "Data e hyrjes" do të thotë data që Autoriteti Kontraktor lejon kontraktorin në kantier.

2.9 "Data e fillimit" eshte perfshire ne Të dhënat e kontrates. Ajo eshte data kur kontraktori do të filloje punimet e ndertimit. Në se kjo nuk realizohet, "data e fillimit "do te jete dita në të cilën do të paguhet paradhenia.

2.10 "Pajisje" do të thotë makineritë dhe veglat e kontraktorit të sjella përkohësisht në kantier për realizimin e Ndertimeve.

2.11 "Materiale" do të thotë të gjitha furnizimet, duke përfshirë ato të konsumit, të përdorura nga kontraktori për kryerjen e punimeve.

2.12 "Objekt i kontratës" do të thotë të gjitha Punët që kontraktori do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.

2.13 "Palë(t)" do të thotë nënshkruesit e kontratës.

2.14 "Drejtues projekti" do të thotë personi i emëruar nga Autoriteti Kontraktor që është përgjegjës për administrimin e kontratës për Autoritetin Kontraktor.

2.15 "Autoritet Kontraktor" do të thotë Autoriteti Kontraktor qe eshte pjese e kesaj kontrate dhe që kontrakton punët objekt i kësaj kontrate. Ky term kudo qe përdoret ka kuptim të njëjtë me ate te perkufizuar ne ligj.

2.16 "Kantier" do të thotë vendi fizik i Punimeve.

2.17 "Raport i inspektimit të kantierit" do të thotë dokumentat e përfshira në dokumentat e tenderit që pasqyrojne informacion faktik dhe të interpretuar rreth kushteve të sipërfaqes dhe nëntokës së kantierit.

2.18 "Nënkontraktues" do të thotë çdo person fizik ose ligjor ose kombinim i mësipërm, që furnizon Punët, materialet ose pajisjet për ose në emër të kontraktorit.

2.19 "Kontraktor" do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate siguron Punimet.

2.20 "Standarte Teknike" do të thotë specifikimet e aprovuara nga një trup i posaçëm standartizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarte të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose përkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.

2.21 "Ngritja e kantierit" do të thotë punimet e ndertimit të përkohshme, të ndërtuara e instaluara, që janë të nevojshme për zbatimin e punimeve të ndërtimit.

2.22 "Punime" do të thotë ajo që Autoriteti Kontraktor i kërkon nga kontraktori të gërmojë, ndërtojë, riparojë, rinovojë ose instalojë siç parashikohet në dokumentat e tenderit duke përfshirë shërbimet në lidhje me to, gjithashtu të përkufizuara në dokumentat e tenderit.

**Neni 3**

**Hartimi i Kontratës**

3.1 Njoftimi i ofertes fituese do të sherbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në dokumentat e tenderit.

3.2 Ekzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke sanksionuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

**Neni 3/1**

**Objekti i Kontrates**

Objekti kësaj kontratë është "Rehabilitimi i Qendres së Qytetit Koplik ", sipas projektit, preventivit dhe sipas specifikimeve teknike në dokumentat e tenderit.

**Neni 3/2**
**Vlera e Kontrates**

Kontrata lidhet me një vlerë totale 201.575.661 (dyqindenjemilionepeseqindeshtatedhjeteepesemijeegjashteqindegjashtedhjeteenje) leke me TVSH , sipas ofertes ekonomike bashkëngjitur kësaj kontrate. Financimi i objektit kryhet nga Fondi i Zhvillimit të Rajoneve, në bazë te VKM Nr. 10 date 10.03.2016. Vlera per vitin 2016 eshte 104.398.166 (njeqindekatermilionetreqindenentedhjeteetetemijeenjeqindegjashtedhjeteegjashte) Lek me TVSH, dhe per vitin 2017 eshte 97.177.495 (nentedhjeteeshtatemilionenjeqindeshtatedhjeteeshtatemijeekaterqindenentedhjeteepese)Lek me TVSH.

**Neni 3/3**

**Afati i Kontrates**

Afati maksimal i ekzekutimit te kontrates eshte 8 muaj nga lidhja e kontrates.

## Neni 4

### Praktikat e Korruptuara, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

4.1 Autoriteti Kontraktor mund t'i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se kontraktori ka kryer veprime të korruptuara. Veprimet e korruptuara përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.

4.2 Kontraktori nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ent që ka marrë pjesë në pregatitjen e dokumentave të tenderit për këtë prokurim.

4.3 Kontraktori duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t'i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

## Neni 5

### Informacioni Konfidencial

5.1 Kontraktori dhe Autoriteti Kontraktues duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.

5.2 Kontraktori mund t'i japë nënkontraktorit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar qe nënkontraktorin të zbatojë punën e tij sipas kontatës. Në rast të tillë, kontraktori duhet të përfshijë në kontratën e tij me nënkontraktorin një dispozitë që premton ruajtjen e konfidencës siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

## Neni 6

### Prona Intelektuale

6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës do t'i përkasin Autoritetit Kontraktor i cili mund t'i përdorë ato sipas gjykimit të tij.

6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, kontraktori, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i dorëzojë Autoritetit Kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramët, skicimet, specifikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose pregatitura nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës. Kontraktori mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, po nuk duhet t'i përdori për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.

6.3 Kontraktori duhet të garantojë Autoritetin Kontraktor zhveshjen nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale, që mund të dalin nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër sipas kontratës.

6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi

i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër të mbrojtur e të furnizuar sipas kontratës, kontraktori duhet t'i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të kontraktorit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

## Neni 7

## Origjina e Materialeve

7.1 Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së materialeve, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.

7.2 Kontraktori mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e materialeve.

7.3 Për qëllime verifikimi "origjinë" do të thotë vendi ku materialet janë nxjerrë, bashkuar ose prodhuar. materialet janë prodhuar kur, nëpërmjet prodhimit, procesimit, ose mbledhjes së mjaftueshme të komponentëve, rezulton një produkt i ri i njohur në tregti që është mjaft i ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentët e tij.

7.4 Origjina e materialeve ka dallim nga kombësia e kontraktorit ose nënkontraktorit që furnizon me materiale.

## Neni 8

## Vendimet e Drejtuesit të Projektit

8.1 Drejtuesi i projektit do të vendosë për çështjet e kontratës midis kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor

8.2 Drejtuesi i Projektit mund të delegojë ndonjë nga detyrat dhe përgjegjësitë e tij tek të tjerët përveç zgjidhjen e mosmarrveshjeve dhe konflikteve. Drejtuesi i projektit duhet të njoftojë kontraktorin për delegimet e bëra apo të revokuara.

## Neni 9

## Komunikimi

9.1 Çdo komunikim midis palëve duhet të bëhet me shkrim.

## Neni 10

## Bashkëpunimi në Kantier me të Tjerët

10.1 Kontraktori duhet të bashkëpunojë dhe të ndajë kantierin me firma të tjera, autoritete publike, shërbimet publike dhe Autoritetin Kontraktor siç kërkohet dhe përkufizohet në Grafikun e realizimit te punimeve.

## Neni 11

## Përgjegjësia e Autoritetit Kontraktor

11.1 Autoriteti Kontraktor ka përgjegjësi të kompensojë kontraktorin për dëmtime të pajisjeve të kontraktorit deri në masën që lidhet me veprime me faj të Autoritetit Kontraktor ose të projekteve të Autoritetit Kontraktor me perjashtim te rastit kur keto te fundit, kishin gabime te dukshe qe mund te ishin konstatuar lehtesisht nga kontraktuesi.

## Neni 12

## Raporti i Inspektimit të Kantierit dhe Kushtet e Kantierit

12.1 Autoriteti Kontraktor nuk mban asnjë përgjegjësi për konkluzionet ose interpretimet e bëra në raportin e inspektimit të kantierit.

12.2 Kontraktori pranon se i ka marrë të gjitha hapat e nevojshme për të verifikuar natyrën dhe vendin e Punimeve dhe se ka inspektuar dhe pajtohet me kushtet e përgjithshme dhe lokale që mund të ndikojnë në kryerjen ose koston e Punëve.

## Neni 13

## Kontraktori që Kryen Punimet

13.1 Kontraktori duhet të kryejë dhe mbarojë Punimet në përputhje me specifikimet teknike të paraqitura në dokumentat e tenderit.

13.2 Kontraktori nuk mban përgjegjësi për gabimet në projekt, të dhëna, planimetri ose aspekte të tjera të specifikimeve teknike, të dhëna nga Autoriteti Kontraktor, me përjashtim të rasteve kur gabimi ishte aq i dukshëm sa kontraktori duhet ta kishte vëne re dhe ta kishte reklamuar këtë te Autoriteti Kontraktor.

13.3 Kodet dhe standartet që do zbatohen do të jenë të shprehura në dokumentat e tenderit. Nëse gjatë egzekutimit të kontratës, ka ndryshime në zbatimin e kodeve ose standarteve, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pasi të jenë aprovuar nga Autoriteti Kontraktor.

## Neni 14

## Ekzekutimi i Punimeve

14.1 Kontraktori duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëherë sapo ta lidhe atë dhe duhet t'i mbarojë Punët brenda Afatit të Mbarimit.

## Neni 15

## Ngritja e Kantierit

15.1 Kontraktori mban përgjegjësi për projektin e Ngritjes se Kantierit.

15.2 Kontraktori duhet të paraqesë të gjitha planet për Ngritjen e Kantierit tek drejtuesi i projektit për shqyrtimin dhe miratimin e tij.

## Neni 16

## Sigurimi Teknik dhe Mjedisor

16.1 Kontraktori do të mbajë përgjegjësi për sigurinë e të gjitha aktiviteteve në kantier.

16.2 Kontratori do të sigurojë kantierin në mënyrë të tillë që të minimizojë dëmtimet e mjedisit. Për shembull, ai duhet të kursejë energjinë, ujin dhe burime të tjera, të reduktojë humbjen dhe të minimizojë përdorimin e substancave varfëruese të ozonit, çlirimin e gazrave, Lëndët e përbëra organike te rezikshme dhe substanca të tjera, që dëmtojnë shëndetin dhe mjedisin.

## Neni 17

## Zbulimet

17.1 Çdo gjë me interes historik ose me vlerë të konsiderueshme e zbuluar papritur në kantier do të deklarohen per te vepruar konform legjislacionit ne fuqi. Kontraktori duhet të njoftojë drejtuesin e projektit për ndonjë zbulim të tillë dhe të ndjekë udhezimet e drejtuesit të projektit për procedurën e administrimit të objekteve.

## Neni 18

## Disponimi i Kantierit

18.1 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi të drejtën e disponimit të kantierit kontraktorit në datën e hyrjes të shprehur në dokumentat e tenderit. Nëse disponimi i ndonjë pjese të kantierit nuk jepet brenda datës së hyrjes për kantierin ose asaj pjese të kantierit siç parashikohet në dokumentat e tenderit, do të konsiderohet se Autoriteti Kontraktor ka vonuar fillimin e zbatimit të kontratës, dhe kontraktorit i lind e drejta të kërkoje amendimin e kontratës në lidhje me shtyrjen e Afatit të Mbarimit. Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori do të mbajnë procesverbal për datën e hyrjes.

## Neni 19

## Raportimi i Grafikut të Zbatimit

19.1 Menjëherë pas lidhjes së kontratës, kontraktori duhet t'i paraqesë drejtuesit të projektit një program plani që tregon metodat e përgjithshme, rregullimet, porositë, afatet dhe rrugët kritike për aktivitetet e Punimeve .

19.2 Në intervale të skeduara rregullisht siç është aprovuar nga drejtuesi i projektit, kontraktori duhet të përgatisë raportime duke treguar progresin e arritur në çdo aktivitet dhe efektet e progresit në punën e mbetur, duke përfshirë çdo ndryshim në sekuencën e aktiviteteve.

## Neni 20

### Paralajmërimi në Kohë

20.1 Kontraktori duhet të paralajmërojë drejtuesin e projektit sa më shpejt të jetë e mundur për ngjarje dhe rrethana specifike që mund të ndodhin në të ardhmen apo që mund të ndikojnë negativisht në zbatimin e kontratës, duke përfshirë cilësinë e punës dhe vonesën në afate.

## Neni 21

### Kontrolli i Cilësisë

21.1 Kontraktori do të jetë plotësisht përgjegjës për kontrollin e cilësisë dhe zbatimin e kontratës.

21.2 Sapo të lidhë kontratën, kontraktori duhet t'i paraqesë drejtuesit të projektit një plan për kontrollin e cilësisë së aktiviteteve në zbatimin e kontratës.

21.3 Drejtuesi i projektit duhet të kontrollojë punën e kontraktorit dhe të njoftojë kontraktorin për defekte që mund të jenë gjetur.

21.4 Sa herë që të jepet njoftimi për defekte, kontraktori duhet të korrigjojë defektin brenda afatit të parashikuar në njoftim.

## Neni 22

### Defektet e Pakorrigjuara

22.1 Nëse kontraktori nuk e ka korrigjuar një defekt brenda kohës së specifikuar në njoftimin për defektin nga drejtuesi i projektit, drejtuesi i projektit do të llogarise koston e korrigjimit të defektit dhe kjo shumë do të mbahet nga çdo pagesë që i duhet bërë kontraktorit deri sa defekti të korrigjohet. Dështimi për të korrigjuar defektin brenda një afati të arsyeshëm përbën shkak për zgjidhje kontrate për arsye mospërmbushje në favor të Autoriteti Kontraktor.

## Neni 23

### Përgjegjësitë e Autoriteti Kontrakotr

23.1 Nga Afati i fillimit deri në Afatin e Realizimit te Plote, Autoriteti Kontraktor do të jetë përgjegjës për:

(a) dëmtim personal, vdekje ose humbje apo dëmtim të pasurisë për shkak të neglizhencës ose ndërhyrjes, qoftë edhe të ligjshme nga Autoriteti Kontraktor apo nga çdo person i punësuar/ kontraktuar nga Autoriteti Kontraktor, përveç kontraktorit.

(b) dëmtim të Punimeve, materialeve dhe pajisjeve deri në ate masë qe lidhet me fajin e Autoritetit Kontraktor apo me projektin e tij.

## Neni 24

### Përgjegjësitë e kontraktorit

24.1 Nga Afati i fillimit deri në Afatin e Realizimit, kontraktori do të jetë përgjegjës për dëmtim personal, vdekje ose humbje apo dëmtim të pasurisë, dhe pasuri të tjera dhe që nuk mbulohen nga Autoriteti Kontraktor sipas Nenit 23.

### Neni 25

### Sigurimi

25.1 Kontraktori duhet të sigurojë objektin, me emra të përbashkët të Autoritetit Kontraktor dhe kontraktorit, nga data e hyrjes ne kantier deri në afatin e realizimit të plote, në shumat e shprehura në KVK për humbje ose dëmtim të punimeve, pajisjeve, materialeve; humbje ose dëmtim të kantierit ose pronave të tjera në kantier dhe dëmtimet personale ose vdekjet e palëve të treta.

25.2 Polica e sigurimit do të dorëzohet tek drejtuesi i projektit për aprovim brenda 30 ditëve pas shpalljes së fituesit të kontratës. Ky siguracion duhet të mbulojë kompensimin e kërkuar për të kompensuar humbjen ose dëmin e shkaktuar. Nëse kontraktori dështon të sigurojë policën e sigurimit, kontrata do të konsiderohet e anulluar. Megjithatë, Autoriteti Kontraktor, mund të vendosë të zgjasë periudhën e paraqitjes të policës së sigurimit ose të bëjë vetë siguracionin dhe të zbresi koston e tij nga pagesa që i jep kontraktorit.

25.3 Kushtet e siguracionit nuk mund të ndryshohen pa aprovimin paraprak të Autoritetit Kontraktor.

### Neni 26

### Testimet dhe Inspektimet

26.1 Kontraktori duhet të bëjë të gjitha testet dhe inspektimet e kërkuara nga dispozitat e kontratës. Kosto e këtyre testimeve dhe inspektimeve duhet të financohet tërësisht nga kontraktori brenda çmimit të kontratës

26.2 Autoriteti Kontraktor me shpenzimet e tij, ka të drejtë të ndjekë testimet dhe/ose inspektimet. Nëse materialet prodhohen ose pregatiten në vende të ndryshme nga ato të kontraktorit, kontraktori duhet të sigurojë leje për Autoritetin Kontraktor për të ndjekur këto testime dhe inspektime.

26.3 Autoriteti Kontraktor gjithashtu mund t'i kërkojë kontraktorit të bëjë testime ose inspektime shtesë të paparashikuara në kontratë por të gjykuara të nevojshme për të verifikuar se Punimet janë konform specifikimeve dhe kushteve të kontratës. Autoriteti Kontraktor do të mbajë përgjegjësi për koston e këtyre testimeve. Gjithashtu, nëse këto teste ndalojnë progresin e punës së kontraktorit, Autoriteti Kontraktor do të bjerë dakort të ndryshojë grafikun.

26.4 Autoriteti Kontraktor do të refuzojë çdo punim që nuk e kalon testimin dhe/ose inspektimin ose nuk është konform specifikimeve teknike dhe kushteve të kërkuara në zbatimin e kontratës.

26.5 As ekzekutimi i testeve as inspektimi i punimeve nuk do ta lirojë kontraktorin nga çdo garanci ose detyrim tjetër sipas kontratës.

## Neni 27

## Garancitë

27.1 Kontraktori garanton se materialet e trupëzuara me punët janë të reja, të papërdorura dhe të modeleve të fundit dhe se trupëzojnë përmirësimet e fundit në projekt dhe materiale, me përjashtim kur parashikohet ndryshe në kontratë.

27.2 Me përjashtim të ndonjë parashikimi në kontratë ose nga ligji, kontraktori garanton se materialet nuk kanë defekte të shkaktuara nga ndonjë veprim ose mosveprim i kontraktorit apo të shkaktuara nga projektimi, materialet dhe puna nën kushte normale përdorimi, për kushtet që mbizotërojnë në Shqipëri.

## Neni 28

## Çmimi i Kontratës

28.1 Çmimet e kontraktorit për Punët e kryera sipas kontratës nuk duhet të ndryshojnë nga çmimet e ofruar nga kontraktori në ofertën e tij.

## Neni 29

## Kushtet e Pagesës

29.1 Çmimi i kontratës, duke përfshirë edhe pagesat paraprake, duhet të paguhen siç specifikohet në kontratë.

29.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet më një dispozitë tjetër në kontratës, pagesa do të bëhet me monedhë Shqiptare. Kursi i këmbimit të monedhave të ndryshme do të jetë kursi i Bankës së Shqipërisë në ditën kur është dërguar për publikim njoftimi i kontratës dhe i përcaktuar në kontratë.

29.3 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, kontraktori ka të drejtë të marrë pagesa periodike gjatë progresit të zbatimit të projektit. Grafiku i pagesave periodike do të parashikohet në KVK. Kur bëhet një pagesë e parashikuar, kontraktori duhet të paraqese nje deklarate me situacionin e muajit tek drejtuesi i projektit ku deklaron se plani sipas grafikut është permbushur. Komunikata gjithashtu duhet të shprehë vlerën e punës së ekzekutuar duke hequr shumën e grumbulluar të verifikuar më parë, si dhe shumën e pagesës paraprake të papaguar dhe çdo shumë të mbajtur në pritje të korrigjimit të një defekti.

29.4 Drejtuesi i projektit duhet të kontrollojë punimet e ekzekutuara nga kontraktori dhe duhet të verifikojë shumën që duhet t'i paguhet kontraktorit, brenda 20 ditëve pune nga data që kontraktori paraqet komunikatën e tij tek drejtuesi i projektit.

29.5 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, pagesa e periodike për Punët do të bëhet brenda 30 ditëve kalendarike nga data që progresi i grafikut të zbatimit është verifikuar nga drejtuesi i projektit.

29.6 Data e pagesës do të jetë dita që fondet xhirohen nga llogaria e Autoritetit Kontraktor.

## Neni 30

## Vonesa në Bërjen e Pagesës

30.1 Shperblimi per demet e shkaktuara si rezultat i vonesës në pagesë konsiston në kamaten e arritur nga data e fillimit te vonesës së debitorit (Autoriteti Kontraktor), në monedhën zyrtare të vendit ku do të bëhet pagesa. Përqindja e kamates parashikohet me ligj. Në fund të çdo viti kamatat e arrira i shtohen shumës totale, mbi të cilën është bërë llogaritja e tyre.

30.2 Kamata ligjore paguhet pa qene i detyruar kreditori ( kontraktori) te provoje ndonje dem. Nëse kreditori (kontraktori) provon se ka pesuar nje dem me te madh se kamata ligjore, debitori (Autoriteti Kontraktor ) duhet të paguajë pjesën e mbetur të demit.

## Neni 31

## Nryshimi i Ligjeve dhe Rregulloreve

31.1 Nëse pas datës së nënshkrimit të kontratës, ndonjë ligj, rregullore, urdhëresë, urdhër ose procedurë me efektin e ligjit në Republikën e Shqipërisë hyn në fuqi, nxirret ose ndryshon dhe ndikon kushtet, duke përfshirë datën e dorëzimit, ose çmimin e kontratës, kushtet ose çmimi i kontratës do të rregullohen në atë masë sa kontraktori është ndikuar në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kontratës.

## Neni 32

## Forca Madhore

32.1 Kontraktori nuk duhet të mbajë përgjegjësi për humbjen e sigurimit te kontrates, dëmeve të likuidueshme ose ndërprerjen për mosplotësim, nëse dhe deri në masën që vonesa në zbatim ose ndonjë dështim tjetër në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kontratës, vijnë si pasojë e ngjarjeve të Forcës Madhore.

32.2 Për qëllimet e këtij neni "Forcë Madhore" do të thotë një ngjarje jashtë kontrollit të kontraktorit dhe e paparashikueshme. Ngjarje të tilla mund të përfshijnë, por nuk kufizohen nga, veprimet e Autoritetit Kontraktor, qoftë në kapacitetin e tij sovran ose kontraktual, lufta ose revolucionet, zjarri, përmbytja, tërmeti, epidemitë, shtrëngime të karantinës dhe embargo tranziti.

32.3 Nëse ndodh ndonjë situatë e Forcës Madhore, kontraktori duhet të njoftojë menjehere Bleresin Publik. Me përjashtim kur Autoriteti Kontraktor jep udhëzime të ndryshme, kontraktori duhet të vazhdojë të zbatojë detyrimet e tij sipas kontratës në masën praktikisht të arsyeshme dhe duhet të kërkojë të gjitha mjetet e arsyeshme për zbatimin që nuk pengohet nga Forca Madhore.

## Neni 33

## Vonesa në Zbatim dhe Zgjatja e Afatit

33.1 Me përjashtim kur parashikohet ndryshe, kontraktori duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëherë pas nënshkrimit të saj.

33.2 Me përjashtim kur Autoriteti Kontraktor është dakort për zgjatje të afatit të kontratës, ka të drejtë të kërkojë dëmet për vonesën në zbatim, nëse kontraktori dështon në dorëzimin e punës brenda Afatit së Dorëzimit të Plotë të specifikuar në kontratë.

33.3 Autoriteti Kontraktor mund të zbresë shumën e dëmeve të likuidueshme që duhen paguar nga shuma e pagesës ndaj kontraktorit. Në rast të tillë Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi kontraktorit njoftim me shkrim për shumën dhe arsyen e zbritjes.

33.4 Autoriteti Kontraktor do të jetë dakort për një zgjatje të afatit, në rastin e Forcës Madhore.

33.5 Autoriteti Kontraktor, mund të jetë dakort për zgjatje të afatit edhe në rrethana të tjera në se është në interesin publik për ta bërë këtë. Ne rast se kontraktori ndeshet me kushte që pengojnë zbatimin në kohë, kontraktori duhet të njoftojë menjehere Autoritetin Kontraktor me shkrim për vonesën, shkakun dhe datën e propozuar të dorëzimit ose përfundimit. Autoriteti Kontraktor duhet të vlerësojë kërkesën. Nëse Autoriteti Kontraktor është dakort me vonesën, zgjatja do të hyjë në fuqi me një amendament me shkrim të kontratës të nënshkruar nga Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori.

**Neni 34**

**Dëmet e Likujdueshme për Vonesën në Mbarimin e Punimeve**

34.1 Dëmet e likuidueshme për vonesën në mbarimin e Punimeve do të llogariten me tarifat e mëposhtme ditore:
   a) Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 6 muaj, tarifa ditore do të jetë 4/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës, por kjo vlere do te llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontrates.
   b) Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 2/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës, por kjo vlere do te llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontrates.
   c) Për kontratat me periudhë zbatimi më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 1/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës, por kjo vlere do te llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontrates.

**Neni 35**

**Negociatat dhe Amendamentet**

35.1 Palët nuk do të negociojnë ndryshime ose amendamente të asnjë kushti të kontratës që do të ndryshonte dukshëm kushtet që përbëjnë bazën e përzgjedhjes së kontraktorit.

35.2 Asnjë amendament ose variacion tjetër i kontratës nuk do të jetë i vlefshëm pa qënë me shkrim, me datë, i referohet shprehimisht kontratës dhe nënshkruhet nga një përfaqsues i autorizuar i kontraktorit dhe Autoriteti Kontraktor.

35.3 Çdo heqje dore nga të drejtat, pushtetet ose ndreqjet që mund të bëhen nga palët sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim, të ketë datë dhe të firmoset nga një përfaqsues i

autorizuar i palës që bën këtë dorëheqje dhe duhet të specifikojë të drejtën dhe masën në të cilën ajo lëshohet.

## Neni 36

## Ndryshimi i Porosisë

36.1 Kushtet e kontratës nuk janë subjekt rinegocimi dhe amendimi pas hyrjes në fuqi me përjashtim kur lejohet specifikisht dhe parashikohet në kushtet e kontratës. Çdo amendament i kontratës duhet të bëhet me shkrim dhe firmosur nga Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori.

36.2 Ndertime shtesë mund të porositen vetëm në rethana të përcaktuar në LPP dhe me kusht që shtesa e kontratës të mos i kalojë 20% të çmimit origjinal të kontratës.

36.3 Autoriteti Kontraktor në çdo kohë, mund të porosisë kontraktorin të bëjë ndryshime brenda qëllimit të përgjithshëm të kontratës në secilin nga elementët e më poshtëm:

a) Korrigjime në projektin, vizatimin ose specifikimet e Punëve
b) Korrigjime në materiale
c) Korrigjime në sasi

36.4 Përpara se të kërkojë një ndryshim, Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori duhet të bien dakort për çdo rritje ose ulje të çmimit të kontratës dhe/ose ndryshim në grafikun e zbatimit ose përfundimit që është shkaktuar nga ndryshimi. Porosia e ndryshuar duhet të materilizojë amendamentet e marrveshjes. Autoriteti Kontraktor nuk ka të drejtë të nxjerrë pretendime për pajtimin me ndryshimin e porositur përveç rregullimeve të siguruara në amendamentet e marrveshjes.

36.5 Ndryshimi i porosise nuk do te jete i vlefshem nese nuk formalizohet sipas kerkesave te Nenit 35 te ketyre kushteve te pergjithshme.

## Neni 37

## Preventivi për Njësi ose në Total

37.1 Kontrata do të përfshijë një Preventiv në Total nëse është një kontratë me shumë totale ose një Preventiv për Njësi nëse është një kontratë me çmim njësie. Nëse është një kontratë me çmim njësie, preventivi për njësi do të përmbajë volumet e zërave të ndërtimit, instalimin, testimin dhe komisionet që bëhen nga kontraktori.

37.2 Preventivi për Njësi do të përdoret për të llogaritur çmimin e kontratës. Kontraktori do të paguhet për sasinë e realizuar me tarifën në preventivin në njësi për secilin zë punimesh.

## Neni 38

## Mbarimi dhe marrja përsipër e ndërtimeve

38.1 Kontraktori duhet t'i kërkojë drejtuesit të projektit t'i lëshojë një certifikatë për mbarimin e Punimeve dhe drejtuesi i projektit do t'a bëjë këtë sapo të vendosi se Punimet janë mbaruar plotësisht.

38.2 Nëse drejtuesi i projektit zbulon se Punimet nuk janë përfunduar plotësisht, drejtuesi i projektit do t'i japi udhezime me shkrim kontraktorit që specifikojnë zerat e punimeve ose aktivitetet që duhen përfunduar para se të lëshohet certifikata.

38.3 Nëse drejtuesi i projektit zbulon defekte në Punime, drejtuesi i projektit duhet t'i japi kontraktorit njoftim me shkrim duke specifikuar defektet që duhet të korrigjohen para se të lëshohet certifikata.

## Neni 39

## Ndërprerja për Mosplotësim

39.1 Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në tërësi ose pjesërisht nëse:
a) kontraktori dështon në kryerjen e Punëve brenda periudhës së specifikuar në kontratë ose brenda zgjatjes së dhënë; ose,
b) kontraktori dështon të zbatojë ndonjë detyrim tjetër të kontratës.

39.2 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi kontraktorit njoftim me shkrim për ndërprerjen për mosplotësim dhe t'i japi kontraktorit 15 ditë të ndreqë mosplotësimin me përjashtim kur ndërprerja është bërë për veprime të korruptuara ose të paligjshme, rast në të cilin ndërprerja do të jetë e menjëhershme.

39.3 Të gjitha materialet, Ngritja e Kantierit dhe Punët e përfundura do të bëhen pronë e Autoriteti Kontraktor nëse kontrata ndërpritet për mosplotësim te kushteve te saj

## Neni 40

## Ndërprerja për Shkak të Falimentimit

40.1 Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse kontraktori falimenton ose bëhet i paaftë të paguajë.

40.2 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi kontraktorit njoftim me shkrim për ndërprerjen.

## Neni 41

## Ndërprerja për Shkak të Interesit Publik

41.1 Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse gjykon se ky veprim duhet ndërmarrë për t'i shërbyer sa më mirë interesit publik.

41.2 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi kontraktorit lajmërim me shkrim për ndërprerjen.

41.3 Autoriteti Kontraktor duhet të paguajë kontraktorin për të gjitha Punët e pranuara dhe të kryera përpara ndërprerjes dhe duhet t'i paguajë kontraktorit dëmet e shkaktuara për kryerjen e pjesshme të Punëve. Në llogaritjen e shumës së dëmeve, kontraktori do të kërkohet të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të minimizuar dëmet.

### Neni 42

### Nënkontraktimi

42.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është në formën e një marrveshjeje të shkruar me anë të së cilës kontraktori i beson kryerjen e një pjese të detyrimeve të kontratës së tij një pale të tretë.

42.2 Kontraktori nuk duhet të nënkontraktojë pa aprovimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktor. Kontraktori duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktor për elementet e kontratës që nënkontraktohet dhe dokumentacinin që provon aftësine e nën-kontraktorit. Autoriteti Kontraktor duhet të lajmërojë kontraktorin për vendimin e tij, brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke shprehur arsyet nëse e aprovon apo jo atë.

42.3 Cdo nenkontraktor duhet te kete te drejte te marre pjese ne prokurimin publik sipas Ligjit mbi Prokurimin Publik. Autoriteti mund të parashikojë pagesa direkete tek nënkontraktori për punët që do të kryejë

42.4 Kontraktori mbetet plotësisht përgjegjës për zbatimin e kontratës pavarësisht nga sjellja e nenkontraktorit.

### Neni 43

### Transferimi i të Drejtave

43.1 Kontraktori nuk duhet të transferojë, tërësisht ose pjesërisht, detyrimet e tij sipas kontratës me përjashtim kur jepet miratimi paraprak nga Autoriteti Kontraktor.

### Neni 44

### Sigurimi i Kontrates

44.1 Përpara nënshkrimit të kontratës, kontraktuesi duhet ti dorëzojë Autoriteti Kontraktor sigurimin e kontratës në shumën dhe formën e kërkuar.

44.2 Shuma e sigurimit te kontrates duhet t'i paguhet Autoriteti Kontraktor si kompensim për çdo humbje të rezultuar nga dështimi i kontraktori në plotësimin e detyrimeve të tij sipas kontratës.

44.3 Sigurimi i kontrates do t'i kthehet kontraktorit jo më vonë se 30 ditë pas datës sëmarrjes në dorëzim të punimeve. Megjithatë, pesë (5) përqind e sigurimit do të mbahet deri në përmbushjen e kënaqshme të detyrimeve të garancisë.

### Neni 45

### Baza Ligjore

45.1 Kontrata do të rregullohet dhe interpretohet sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.

### Neni 46

### Zgjidhja e Mosmarrveshjeve

46.1 Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori duhet të bëjnë çdo përpjekje të zgjidhin mosmarrveshjet ose konfliktet e ndodhura midis tyre ose në lidhje me këtë marrveshje me negociata direkte.

46.2 Në se palët dështojnë në zgjidhjen e mosmarrveshjes ose konfliktit, ato i drejtohen zgjidhjes së marrveshjeve sipas kontratës dhe procedurave juridike në fuqi sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë.

### Neni 47

### Përfaqesimi i Palëve

47.1 Çdo palë duhet të emërojë me shkrim një person ose strukture organizative, që do të jetë përgjegjës, në emër të palës, për marrjen e komunikatave dhe për përfaqësimin e palës në çështjet e lidhura me egzekutimin e kontratës.

47.2 Secila palë duhet të lajmërojë palën tjetër menjëherë për ndonjë ndryshim në emërimin e përfaqsuesit të palës. Në se njëra palë dështon të lajmërojë, duhet të marri përsipër çdo humbje të shkaktuar nga dështimi për të dhënë njoftim të mjaftueshëm.

47.3 Palët mund të emërojnë persona ose struktura organizative shtesë për të përfaqsuar palën në veprime ose veprimtari të veçanta në të cilin rast njoftimi me shkrim duhet dhënë dhe duhet të përcaktojë shtrirjen e autoritetit të përfaqsuesit.

### Neni 48

### Lajmërimet

48.1 Çdo lajmërim i dhënë nga njëra palë tjetrës sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim në adresën e specifikuar në kontratë.

48.2 Njoftimi do të ketë efekt sapo të dorëzohet.

### Neni 49

### Llogaritja e Afateve

49.1 Të gjitha referencat e ditëve do të jenë ditë kalendarike me përjashtim kur parashikohet ndryshe.

## KUSHTET E VEÇANTA

Kushtet e veçanta të Kontratës do të plotësojnë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës. Në rast se ka mospërputhje midis KPK dhe KVK do të mbizotërojne Kushtet e veçanta të kontratës.

### Neni 1

### Përkufizime

1.1 Autoriteti Kontraktor është Bashkia Malesi e Madhe, me NIPT: K48420701I, perfaqesuar nga z. Tonin Marinaj (Kryetar).

1.2 Kontraktori është " STERKAJ " shpk, me NIPT: J68310708M, nga z. Lulezim Sterkaj/ Administrator, adresa Tiranë, Njesia Bashkiake Nr. 5, Blv. Bajram Curri, mrapa pallateve Agimi, pallati 7/1B, kati 2.

### Neni 2

### Sigurimi i Kontrates

2.1 Sigurimi i kontratës në shumën prej *(10% të vlerës së ofertës)* duhet të ofrohet nga kontraktori për të siguruar ekzekutimin e detyrimeve të tij sipas kontratës. (Kontraktuesi ka paraqitur formularin e sigurimit te kontrates me Nr. Serie 0045700, date: 15.09.2016, nga " SIGAL UNICA GROUP AUSTRIA ", ne shumen 20 158 000 (njezetmilionenjeqindepesedhjeteetetemije) lek.

2.2 Sigurimi i kontratës do t'i lëshohet ose kthehet, menjëherë, kontraktorit sipas skedarit të mëposhtëm:

Jo më vonë se 30 ditë pas datës së marrjes në dorëzim të punimeve. Megjithatë, pesë (5) përqind e sigurimit do të mbahet deri në përmbushjen e kënaqshme të detyrimeve të garancisë.

### Neni 3

### Drejtuesi i Projektit

3.1 Drejtuesi i Projektit do të jetë: " HE & SK 11 " shpk, Nr. NIPT-i: L19008502B

3.2 Adresa/pika e kontaktit: Gjirokaster Tepelene, Lagja "Mustafa Matohiti ", Rruga "Mustafa Matohiti ",banesa nr. 31, shkalla nr.1, kati perdhe.

## Neni 4

## Kantieri

4.1 Kantieri i Punëve do të jetë (Pershkrimi i saktë i venddodhjes së objektit që do të realizohet):

Qender, Koplik

## Neni 5

## Data e Fillimit

5.1 Kontraktorit do t'i jepet leja për të hyrë në kantier më: 07.11.2016

## Neni 6

## Siguracioni

2.3 Nga Data e hyrjes deri në Afatin e Mbarimit kontraktori duhet të ketë siguracion që mbulon deri në shumën prej: (Kontraktuesi ka paraqitur Policen e sigurimit me Nr. Serie 003024, date: 15.09.2016, nga " SIGAL UNICA GROUP AUSTRIA ")

a. Për dëmtime ose humbje të Punëve dhe Materialeve: ______________________
b. Për dëmtime ose humbje të Pajisjeve: ______________________________
c. Për dëmtime ose humbje të pasurisë përveç Punëve, Materialeve dhe Pajisjeve: _____
d. Për dëmtim personal ose vdekje të personave në kantier: ____________________

## Neni 7

## Inspektimet dhe Testimet

7.1 Inspektimet dhe testimet para vërtetimit të mbarimit të Punëve do të përfshijnë: ________

____________________________________________________________

____________________________________________________________

____________________________________________________________

## Neni 8

## Lloji i Kontratës

8.1 Kjo kontratë do të çmohet si një

- ☐ Kontratë me Çmim Njësie të bazuar në çmimet e njësisë të shprehura në Preventivin në Njësi
- ☐ Kontratë me Shumë Totale

**Neni 9**

**Grafiku i Pagesës**

9.1 Pagesa duhet bërë sipas grafikut të mëposhtëm: ________________________________
________________________________________________________________

9.2 Pagesa për Punët duhet bërë brenda ________ ditëve nga data që kontraktori paraqet një dokument që deklaron se objektivi për pagesën është arritur subjekt ky i konfirmimit të dokumentit nga drejtuesi i projektit. Nëse është lënë e paplotësuar, periudha kohore do të jetë 30 ditë.

9.3 Monedha e pagesës do të jetë ______. Nëse nuk është specifikuar, pagesa do bëhet me monedhën Shqiptare.

9.4 Pagesa do te behet ne llogarine bankare:

BANKA AMERIKANE E INVESTIMEVE S.A

Emri i llogarise: " STERKAJ " SHPK

IBAN: AL33210110290000000001402115

**Neni 10**

**Pagesa Paraprake**

10.1 Përqindja e pagesës paraprake do të jetë _____. Nëse nuk është specifikuar, kontraktori nuk do të marrë pagesë paraprake.

10.2 Nëse është premtuar një pagesë paraprake, avanca do të paguhet brenda ______ ditëve nga marrja e sigurimit te kontrates.

10.3 Nëse jepet pagesa paraprake, shuma do të hiqet nga pagesa që duhet t'i jepet kontraktorit sipas formulës së mëposhtme:________________________________
________________________________________________________________

**Neni 11**

**Shërbimet në Lidhje me to**

11.1 Kushtet e veçanta të mëposhme do të zbatohen për kryerjen e pagesës së shërbimeve të lidhura

______________________________________________

______________________________________________

______________________________________________

______________________________________________

**Neni 12.**
**Zbritja e garancisë së kontratës**

12.1 Nëse parashikohet zbritje periodike të garancisë së kontratës ajo kryhet si më poshtë

______________________________________________

______________________________________________

Nëse nuk plotësohet, garancia mbetet e pandryshuar.

**Neni 13**
**Afati i Garancise se defekteve**

Periudha e garancise se defekteve do te jete 1 (nje) vit nga data e firmosjes se aktit te kolaudimit.

-Kontrata nenshkruhet ne 5 kopje, nje i jepet kontraktuesit ndersa 4 i mban Autoriteti Kontraktor.

**PALET KONTRAKTORE**

**BASHKIA MALESI E MADHE**

TONIN MARINAJ

KRYETAR

**"STERKAJ " SHPK**

LULEZIM STERKAJ

ADMINISTRATOR

Punoi: Enkeleda Smakaj (Juriste)
Nr. Fq: 21

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALËSI E MADHE

Nr.407 Prot.

Koplik, më 2.10.2017

# KONTRATË

## (Punë Publike)

## Për

### " RIKUALIFIKIMI I QENDRES BAJZE KASTRATI, LOTI I-RE "

Në mbështetje të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, Ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 " Për Prokurimet Publike" i ndryshuar, VKM NR. 914 date 29.12.2014 " Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar,

Lidhur sot me datë 2.10.2017, nën vullnetin e plotë dhe të lirë, midis palëve:

**Bashkia Malësi e Madhe** me Nipt: K48420701I, e përfaqësuar nga z. Tonin Marinaj (Kryetar), përfaqësues i vetëm që më poshtë do të quhet: ***"Autoriteti Kontraktor"***, dhe

**" CURRI " SHPK,** me NIPT: J 67902718 S, e perfaqesuar nga z. Faik Curri/Administrator, adresa: Tirane, Njesia Bashkiake, Nr. 10, Rruga Kajo Karafili, Pallati Bimbashi 8/2, shkalla II, Ap. 2B, qe me poshte do te quhen ***"Kontraktori"***.

NDERTIM - PROJEKTIM CURRI Tel/Fax: 04 2232098 TIRANE - ALBANIA



Adresa:Koplik-Qender tel:021122650/2651 e-mail:bashkiamalesiemadhe@hotmail.com

KUSHTET E PËRGJITHSHME TË KONTRATËS
**Punët – Procedura e Hapur**

**Neni 1: Qëllimi**

1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për kryerjen e Punëve të prokuruara ne bazë të legjislacionit të prokurimit.

1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërise parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.

1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.

1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e parashikuara në pjesë të tjera të kontratës.

1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

**Neni 2: Përkufizime**

2.1 "Preventiv total" do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt te cilat jane orientuese, plotesuar me cmimin total të përcaktuar që është pjesë e Ofertes në një kontratë me çelsa ne dore.

2.2 "Preventiv per njesi" do të thotë volumet e punes te dhena ne projekt shoqeruar me cmimet per njesi te pandryshuara që janë pjesë e Ofertes në një kontratë me punime ne matje.

2.3 "Afati i realizimit te punimeve" do të thotë data që Punët duhet të perfundojnë siç është shprehur në Grafikun për realizimin Punimeve , e vertetuar nga enti prokurues.

2.4 "Kontratë" do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Autoritetit Kontraktor dhe kontraktorit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjitjet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.

2.5 "Cmim kontrate" do të thotë çmimi që i paguhet kontraktorit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.

2.6 "Realizimi i punimeve" do të thotë data e vërtetuar nga Autoriteti Kontraktor se Punët janë mbaruar.

2.7 "Defekt" do të thotë çdo pjesë e Punimeve e paperfunduar në përputhje me kontratën.

NDERTIM - PROJEKTIM CURRI Tel/Fax: 04-2232098 TIRANE - ALBANIA



Adresa:Koplik-Qender tel:021122650/2651 e-mail:bashkiamalesiemadhe@hotmail.com

2.8 "Data e hyrjes" do të thotë data që Autoriteti Kontraktor lejon kontraktorin në kantier.

2.9 "Data e fillimit" eshte perfshire ne Të dhënat e kontrates. Ajo eshte data kur kontraktori do të filloje punimet e ndertimit. Në se kjo nuk realizohet, "data e fillimit "do te jete dita në të cilën do të paguhet paradhenia.

2.10 "Pajisje" do të thotë makineritë dhe veglat e kontraktorit të sjella përkohësisht në kantier për realizimin e Ndertimeve.

2.11 "Materiale" do të thotë të gjitha furnizimet, duke përfshirë ato të konsumit, të përdorura nga kontraktori për kryerjen e punimeve.

2.12 "Objekt i kontratës" do të thotë të gjitha Punët që kontraktori do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.

2.13 "Palë(t)" do të thotë nënshkruesit e kontratës.

2.14 "Drejtues projekti" do të thotë personi i emëruar nga Autoriteti Kontraktor që është përgjegjës për administrimin e kontratës për Autoritetin Kontraktor.

2.15 "Autoritet Kontraktor" do të thotë Autoriteti Kontraktor qe eshte pjese e kesaj kontrate dhe që kontrakton punët objekt i kësaj kontrate. Ky term kudo qe përdoret ka kuptim të njëjtë me ate te perkufizuar ne ligj.

2.16 "Kantier" do të thotë vendi fizik i Punimeve.

2.17 "Raport i inspektimit të kantierit" do të thotë dokumentat e përfshira në dokumentat e tenderit që pasqyrojne informacion faktik dhe të interpretuar rreth kushteve të sipërfaqes dhe nëntokës së kantierit.

2.18 "Nënkontraktues" do të thotë çdo person fizik ose ligjor ose kombinim i mësipërm, që furnizon Punët, materialet ose pajisjet për ose në emër të kontraktorit.

2.19 "Kontraktor" do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate siguron Punimet.

2.20 "Standarte Teknike" do të thotë specifikimet e aprovuara nga një trup i posaçëm standartizimi për zbatimin e vazhdueshëm ose të përsëritur. Standarte të tilla përdoren si rregulla, rregullore ose përkufizim të karakteristikave për të siguruar se materialet dhe shërbimet e procesuara i përgjigjen qëllimit.

2.21 "Ngritja e kantierit" do të thotë punimet e ndertimit të përkohshme, të ndërtuara e instaluara, që janë të nevojshme për zbatimin e punimeve të ndërtimit.

2.22 "Punime" do të thotë ajo që Autoriteti Kontraktor i kërkon nga kontraktori të gërmojë, ndërtojë, riparojë, rinovojë ose instalojë siç parashikohet në dokumentat e tenderit duke përfshirë shërbimet në lidhje me to, gjithashtu të përkufizuara në dokumentat e tenderit.

NDERTIM - PROJEKTIM CURRI Tel/Fax: 04 2232098 TIRANE - ALBANIA



Adresa:Koplik-Qender tel:021122650/2651 e-mail:bashkiamalesiemadhe@hotmail.com

**Neni 3: Hartimi i Kontratës**

3.1 Njoftimi i ofertes fituese do të sherbejë për hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në dokumentat e tenderit.

3.2 Ekzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke sanksionuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

**Neni 3/1: Objekti i kontratës**

Objekti kësaj kontratë është " Rikualifikimi i qendres Bajze Kastrati, Loti I-re ", sipas projektit, preventivit dhe sipas specifikimeve teknike në dokumentat e tenderit.

**Neni 3/2: Vlera e kontratës**

Kontrata lidhet me një vlerë totale 99 789 752 (nentedhjeteenentemilioneshtateqindetetedhjeteenentemijeeshtateqindepesedhjeteedy) leke me TVSH , sipas ofertes ekonomike bashkëngjitur kësaj kontrate. Financimi i objektit kryhet me fonde nga Fondi per zhvillimin e Rajoneve:
Per vitin 2017: 30 000 000 (tridhjetemilion) me TVSH.

Per vitin 2018: 69 789 752

(gjashtedhjeteenentemilioneshtateqindetetedhjeteenenetemijeeshtateqindepesedhjeteedy)

leke me TVSH.

**Neni 3/3: Kohezgjatja e kontrates**

Afati maksimal i kryerjes se punimeve eshte 12 muaj nga lidhja e kontrates.

**Neni 4: Praktikat e Korruptuara, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve**

4.1 Autoriteti Kontraktor mund t'i kërkojë gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën nëse zbulon se kontraktori ka kryer veprime të korruptuara. Veprimet e korruptuara përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.

4.2 Kontraktori nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose ent që ka marrë pjesë në pregatitjen e dokumentave të tenderit për këtë prokurim.

4.3 Kontraktori duhet të lejojë Autoritetin Kontraktor të inspektojë llogaritë dhe regjistrat që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t'i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktor.

**Neni 5: Informacioni Konfidencial**

5.1 Kontraktori dhe Autoriteti Kontraktues duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.

CURRI
Tel/Fax: 04 2232098
TIRANE - ALBANIA



Adresa:Koplik-Qender tel:021122650/2651 e-mail:bashkiamalesiemadhe@hotmail.com

5.2 Kontraktori mund t'i japë nënkontraktorit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktor deri në masën e kërkuar qe nënkontraktorin të zbatojë punën e tij sipas kontatës. Në rast të tillë, kontraktori duhet të përfshijë në kontratën e tij me nënkontraktorin një dispozitë që premton ruajtjen e konfidencës siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

**Neni 6: Prona Intelektuale**

6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës do t'i përkasin Autoritetit Kontraktor i cili mund t'i përdorë ato sipas gjykimit të tij.

6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, kontraktori, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i dorëzojë Autoritetit Kontraktor të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramët, skicimet, specifikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose pregatitura nga kontraktori gjatë zbatimit të kontratës. Kontraktori mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, po nuk duhet t'i përdori për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktor.

6.3 Kontraktori duhet të garantojë Autoritetin Kontraktor zhveshjen nga përgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale, që mund të dalin nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër sipas kontratës.

6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoritetit Kontraktor në lidhje me ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i materialeve, skicave ose çdo prone tjetër të mbrojtur e të furnizuar sipas kontratës, kontraktori duhet t'i japë Autoritetit Kontraktor të gjitha provat dhe informacionin në posedim të kontraktorit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

**Neni 7: Origjina e Materialeve**

7.1 Nuk ka asnjë kufizim për kombësinë e origjinës së materialeve, përveç atyre që mund të jenë përcaktuar në ndonjë Rezolutë të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara.

7.2 Kontraktori mund të jetë i detyruar të verifikojë origjinën e materialeve.

7.3 Për qëllime verifikimi "origjinë" do të thotë vendi ku materialet janë nxjerrë, bashkuar ose prodhuar. materialet janë prodhuar kur, nëpërmjet prodhimit, procesimit, ose mbledhjes së mjaftueshme të komponentëve, rezulton një produkt i ri i njohur në tregti që është mjaft i ndryshëm në karakteristikat bazë ose në qëllim apo përdorim nga komponentët e tij.

7.4 Origjina e materialeve ka dallim nga kombësia e kontraktorit ose nënkontraktorit që furnizon me materiale.

NDERTIM - PROJEK...
CURRI
Tel/Fax: 04 2232098
TIRANE - ALBANIA

**Neni 8: Vendimet e Drejtuesit të Projektit**

8.1 Drejtuesi i projektit do të vendosë për çështjet e kontratës midis kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor

8.2 Drejtuesi i Projektit mund të delegojë ndonjë nga detyrat dhe përgjegjësitë e tij tek të tjerët përveç zgjidhjen e mosmarrveshjeve dhe konflikteve. Drejtuesi i projektit duhet të njoftojë kontraktorin për delegimet e bëra apo të revokuara.

**Neni 9: Komunikimi**

9.1 Çdo komunikim midis palëve duhet të bëhet me shkrim.

**Neni 10: Bashkëpunimi në Kantier me të Tjerët**

10.1 Kontraktori duhet të bashkëpunojë dhe të ndajë kantierin me firma të tjera, autoritete publike, shërbimet publike dhe Autoritetin Kontraktor siç kërkohet dhe përkufizohet në Grafikun e realizimit te punimeve.

**Neni 11: Përgjegjësia e Autoritetit Kontraktor**

11.1 Autoriteti Kontraktor ka përgjegjësi të kompensojë kontraktorin për dëmtime të pajisjeve të kontraktorit deri në masën që lidhet me veprime me faj të Autoritetit Kontraktor ose të projekteve të Autoritetit Kontraktor me perjashtim te rastit kur keto te fundit, kishin gabime te dukshe qe mund te ishin konstatuar lehtesisht nga kontraktuesi.

**Neni 12: Raporti i Inspektimit të Kantierit dhe Kushtet e Kantierit**

12.1 Autoriteti Kontraktor nuk mban asnjë përgjegjësi për konkluzionet ose interpretimet e bëra në raportin e inspektimit të kantierit.

12.2 Kontraktori pranon se i ka marrë të gjitha hapat e nevojshme për të verifikuar natyrën dhe vendin e Punimeve dhe se ka inspektuar dhe pajtohet me kushtet e përgjithshme dhe lokale që mund të ndikojnë në kryerjen ose koston e Punëve.

**Neni 13: Kontraktori që Kryen Punimet**

13.1 Kontraktori duhet të kryejë dhe mbarojë Punimet në përputhje me specifikimet teknike të paraqitura në dokumentat e tenderit.

13.2 Kontraktori nuk mban përgjegjësi për gabimet në projekt, të dhëna, planimetri ose aspekte të tjera të specifikimeve teknike, të dhëna nga Autoriteti Kontraktor, me përjashtim të rasteve kur gabimi ishte aq i dukshëm sa kontraktori duhet ta kishte vëne re dhe ta kishte reklamuar këtë te Autoriteti Kontraktor.

13.3 Kodet dhe standartet që do zbatohen do të jenë të shprehura në dokumentat e tenderit. Nëse gjatë egzekutimit të kontratës, ka ndryshime në zbatimin e kodeve ose standarteve, këto ndryshime do të zbatohen vetëm pasi të jenë aprovuar nga Autoriteti Kontraktor.

NDERTIM - PROJEKTIM CURRI Tel/Fax: 04 2232098



Adresa:Koplik-Qender tel:021122650/2651 e-mail:bashkiamalesiemadhe@hotmail.com

**Neni 14: Ekzekutimi i Punimeve**

14.1 Kontraktori duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëherë sapo ta lidhe atë dhe duhet t'i mbarojë Punët brenda Afatit të Mbarimit.

**Neni 15: Ngritja e Kantierit**

15.1 Kontraktori mban përgjegjësi për projektin e Ngritjes se Kantierit.

15.2 Kontraktori duhet të paraqesë të gjitha planet për Ngritjen e Kantierit tek drejtuesi i projektit për shqyrtimin dhe miratimin e tij.

**Neni 16: Sigurimi Teknik dhe Mjedisor**

16.1 Kontraktori do të mbajë përgjegjësi për sigurinë e të gjitha aktiviteteve në kantier.

16.2 Kontratori do të sigurojë kantierin në mënyrë të tillë që të minimizojë dëmtimet e mjedisit. Për shembull, ai duhet të kursejë energjinë, ujin dhe burime të tjera, të reduktojë humbjen dhe të minimizojë përdorimin e substancave varfëruese të ozonit, çlirimin e gazrave, Lëndët e përbëra organike te rezikshme dhe substanca të tjera, që dëmtojnë shëndetin dhe mjedisin.

**Neni 17: Zbulimet**

17.1 Çdo gjë me interes historik ose me vlerë të konsiderueshme e zbuluar papritur në kantier do të deklarohen per te vepruar konform legjislacionit ne fuqi. Kontraktori duhet të njoftojë drejtuesin e projektit për ndonjë zbulim të tillë dhe të ndjekë udhezimet e drejtuesit të projektit për procedurën e administrimit të objekteve.

**Neni 18: Disponimi i Kantierit**

18.1 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi të drejtën e disponimit të kantierit kontraktorit në datën e hyrjes të shprehur në dokumentat e tenderit. Nëse disponimi i ndonjë pjese të kantierit nuk jepet brenda datës së hyrjes për kantierin ose asaj pjese të kantierit siç parashikohet në dokumentat e tenderit, do të konsiderohet se Autoriteti Kontraktor ka vonuar fillimin e zbatimit të kontratës, dhe kontraktorit i lind e drejta të kërkoje amendimin e kontratës në lidhje me shtyrjen e Afatit të Mbarimit. Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori do të mbajnë procesverbal për datën e hyrjes.

**Neni: 19: Raportimi i Grafikut të Zbatimit**

19.1 Menjëherë pas lidhjes së kontratës, kontraktori duhet t'i paraqesë drejtuesit të projektit një program plani që tregon metodat e përgjithshme, rregullimet, porositë, afatet dhe rrugët kritike për aktivitetet e Punimeve .

19.2 Në intervale të skeduara rregullisht siç është aprovuar nga drejtuesi i projektit, kontraktori duhet të përgatisë raportime duke treguar progresin e arritur në çdo aktivitet dhe efektet e progresit në punën e mbetur, duke përfshirë çdo ndryshim në sekuencën e aktiviteteve.

NDERTIM - PROJEKTIM CURRI Tel/Fax: 04 2232098 TIRANE - ALBANIA



Adresa:Koplik-Qender tel:021122650/2651 e-mail:bashkiamalesiemadhe@hotmail.com

**Neni 20: Paralajmërimi në Kohë**

20.1 Kontraktori duhet të paralajmërojë drejtuesin e projektit sa më shpejt të jetë e mundur për ngjarje dhe rrethana specifike që mund të ndodhin në të ardhmen apo që mund të ndikojnë negativisht në zbatimin e kontratës, duke përfshirë cilësinë e punës dhe vonesën në afate.

**Neni 21: Kontrolli i Cilësisë**

21.1 Kontraktori do të jetë plotësisht përgjegjës për kontrollin e cilësisë dhe zbatimin e kontratës.

21.2 Sapo të lidhë kontratën, kontraktori duhet t'i paraqesë drejtuesit të projektit një plan për kontrollin e cilësisë së aktiviteteve në zbatimin e kontratës.

21.3 Drejtuesi i projektit duhet të kontrollojë punën e kontraktorit dhe të njoftojë kontraktorin për defekte që mund të jenë gjetur.

21.4 Sa herë që të jepet njoftimi për defekte, kontraktori duhet të korrigjojë defektin brenda afatit të parashikuar në njoftim.

**Neni 22: Defektet e Pakorrigjuara**

22.1 Nëse kontraktori nuk e ka korrigjuar një defekt brenda kohës së specifikuar në njoftimin për defektin nga drejtuesi i projektit, drejtuesi i projektit do të llogarise koston e korrigjimit të defektit dhe kjo shumë do të mbahet nga çdo pagesë që i duhet bërë kontraktorit deri sa defekti të korrigjohet. Dështimi për të korrigjuar defektin brenda një afati të arsyeshëm përbën shkak për zgjidhje kontrate për arsye mospërmbushje në favor të Autoriteti Kontraktor.

**Neni 23: Përgjegjësitë e Autoriteti Kontrakotr**

23.1 Nga Afati i fillimit deri në Afatin e Realizimit te Plote, Autoriteti Kontraktor do të jetë përgjegjës për:

(a) dëmtim personal, vdekje ose humbje apo dëmtim të pasurisë për shkak të neglizhencës ose ndërhyrjes, qoftë edhe të ligjshme nga Autoriteti Kontraktor apo nga çdo person i punësuar/ kontraktuar nga Autoriteti Kontraktor, përveç kontraktorit.

(b) dëmtim të Punimeve, materialeve dhe pajisjeve deri në ate masë qe lidhet me fajin e Autoritetit Kontraktor apo me projektin e tij.

**Neni 24: Përgjegjësitë e kontraktorit**

24.1 Nga Afati i fillimit deri në Afatin e Realizimit, kontraktori do të jetë përgjegjës për dëmtim personal, vdekje ose humbje apo dëmtim të pasurisë, dhe pasuri të tjera dhe që nuk mbulohen nga Autoriteti Kontraktor sipas Nenit 23.

**Neni 25: Sigurimi**

25.1 Kontraktori duhet të sigurojë objektin, me emra të përbashkët të Autoritetit Kontraktor dhe kontraktorit, nga data e hyrjes ne kantier deri në afatin e realizimit të plote, në shumat e shprehura në KVK për humbje ose dëmtim të punimeve, pajisjeve, materialeve; humbje ose



Adresa:Koplik-Qender tel:021122650/2651 e-mail:bashkiamalesiemadhe@hotmail.com

dëmtim të kantierit ose pronave të tjera në kantier dhe dëmtimet personale ose vdekjet e palëve të treta.

25.2 Polica e sigurimit do të dorëzohet tek drejtuesi i projektit për aprovim brenda 30 ditëve pas shpalljes së fituesit të kontratës. Ky siguracion duhet të mbulojë kompensimin e kërkuar për të kompensuar humbjen ose dëmin e shkaktuar. Nëse kontraktori dështon të sigurojë policën e sigurimit, kontrata do të konsiderohet e anulluar. Megjithatë, Autoriteti Kontraktor, mund të vendosë të zgjasë periudhën e paraqitjes të policës së sigurimit ose të bëjë vetë siguracionin dhe të zbresi koston e tij nga pagesa që i jep kontraktorit.

25.3 Kushtet e siguracionit nuk mund të ndryshohen pa aprovimin paraprak të Autoritetit Kontraktor.

**Neni 26: Testimet dhe Inspektimet**

26.1 Kontraktori duhet të bëjë të gjitha testet dhe inspektimet e kërkuara nga dispozitat e kontratës. Kosto e këtyre testimeve dhe inspektimeve duhet të financohet tërësisht nga kontraktori brenda çmimit të kontratës

26.2 Autoriteti Kontraktor me shpenzimet e tij, ka të drejtë të ndjekë testimet dhe/ose inspektimet. Nëse materialet prodhohen ose pregatiten në vende të ndryshme nga ato të kontraktorit, kontraktori duhet të sigurojë leje për Autoritetin Kontraktor për të ndjekur këto testime dhe inspektime.

26.3 Autoriteti Kontraktor gjithashtu mund t'i kërkojë kontraktorit të bëjë testime ose inspektime shtesë të paparashikuara në kontratë por të gjykuara të nevojshme për të verifikuar se Punimet janë konform specifikimeve dhe kushteve të kontratës. Autoriteti Kontraktor do të mbajë përgjegjësi për koston e këtyre testimeve. Gjithashtu, nëse këto teste ndalojnë progresin e punës së kontraktorit, Autoriteti Kontraktor do të bjerë dakort të ndryshojë grafikun.

26.4 Autoriteti Kontraktor do të refuzojë çdo punim që nuk e kalon testimin dhe/ose inspektimin ose nuk është konform specifikimeve teknike dhe kushteve të kërkuara në zbatimin e kontratës.

26.5 As ekzekutimi i testeve as inspektimi i punimeve nuk do ta lirojë kontraktorin nga çdo garanci ose detyrim tjetër sipas kontratës.

**Neni 27 Garancitë**

27.1 Kontraktori garanton se materialet e trupëzuara me punët janë të reja, të papërdorura dhe të modeleve të fundit dhe se trupëzojnë përmirësimet e fundit në projekt dhe materiale, me përjashtim kur parashikohet ndryshe në kontratë.

27.2 Me përjashtim të ndonjë parashikimi në kontratë ose nga ligji, kontraktori garanton se materialet nuk kanë defekte të shkaktuara nga ndonjë veprim ose mosveprim i kontraktorit apo të shkaktuara nga projektimi, materialet dhe puna nën kushte normale përdorimi, për kushtet që mbizotërojnë në Shqipëri.

NDERTIM PROJEKTIM CURRI Tel/Fax: 04 2232098 TIRANE - ALBANIA



Adresa:Koplik-Qender tel:021122650/2651 e-mail:bashkiamalesiemadhe@hotmail.com

**Neni 28: Çmimi i Kontratës**

28.1 Çmimet e kontraktorit për Punët e kryera sipas kontratës nuk duhet të ndryshojnë nga çmimet e ofruar nga kontraktori në ofertën e tij.

**Neni 29: Kushtet e Pagesës**

29.1 Çmimi i kontratës, duke përfshirë edhe pagesat paraprake, duhet të paguhen siç specifikohet në kontratë.

29.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet më një dispozitë tjetër në kontratës, pagesa do të bëhet me monedhë Shqiptare. Kursi i këmbimit të monedhave të ndryshme do të jetë kursi i Bankës së Shqipërisë në ditën kur është dërguar për publikim njoftimi i kontratës dhe i përcaktuar në kontratë.

29.3 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, kontraktori ka të drejtë të marrë pagesa periodike gjatë progresit të zbatimit të projektit. Grafiku i pagesave periodike do të parashikohet në KVK. Kur bëhet një pagesë e parashikuar, kontraktori duhet të paraqese nje deklarate me situacionin e muajit tek drejtuesi i projektit ku deklaron se plani sipas grafikut është permbushur. Komunikata gjithashtu duhet të shprehë vlerën e punës së ekzekutuar duke hequr shumën e grumbulluar të verifikuar më parë, si dhe shumën e pagesës paraprake të papaguar dhe çdo shumë të mbajtur në pritje të korrigjimit të një defekti.

29.4 Drejtuesi i projektit duhet të kontrollojë punimet e ekzekutuara nga kontraktori dhe duhet të verifikojë shumën që duhet t'i paguhet kontraktorit, brenda 20 ditëve pune nga data që kontraktori paraqet komunikatën e tij tek drejtuesi i projektit.

29.5 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, pagesa e periodike për Punët do të bëhet brenda 30 ditëve kalendarike nga data që progresi i grafikut të zbatimit është verifikuar nga drejtuesi i projektit.

29.6 Data e pagesës do të jetë dita që fondet xhirohen nga llogaria e Autoritetit Kontraktor.

**Neni 30: Vonesa në Bërjen e Pagesës**

30.1 Shperblimi per demet e shkaktuara si rezultat i vonesës në pagesë konsiston në kamaten e arritur nga data e fillimit te vonesës së debitorit (Autoriteti Kontraktor), në monedhën zyrtare të vendit ku do të bëhet pagesa. Përqindja e kamates parashikohet me ligj. Në fund të çdo viti kamatat e arrira i shtohen shumës totale, mbi të cilën është bërë llogaritja e tyre.

30.2 Kamata ligjore paguhet pa qene i detyruar kreditori ( kontraktori) te provoje ndonje dem. Nëse kreditori (kontraktori) provon se ka pesuar nje dem me te madh se kamata ligjore, debitori (Autoriteti Kontraktor ) duhet të paguajë pjesën e mbetur të demit.

**Neni 31: Nryshimi i Ligjeve dhe Rregulloreve**

31.1 Nëse pas datës së nënshkrimit të kontratës, ndonjë ligj, rregullore, urdhëresë, urdhër ose procedurë me efektin e ligjit në Republikën e Shqipërisë hyn në fuqi, nxirret ose ndryshon dhe ndikon kushtet, duke përfshirë datën e dorëzimit, ose çmimin e kontratës, kushtet ose



Adresa:Koplik-Qender tel:021122650/2651 e-mail:bashkiamalesiemadhe@hotmail.com

çmimi i kontratës do të rregullohen në atë masë sa kontraktori është ndikuar në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kontratës.

**Neni 32: Forca Madhore**

32.1 Kontraktori nuk duhet të mbajë përgjegjësi për humbjen e sigurimit te kontrates, dëmeve të likuidueshme ose ndërprerjen për mosplotësim, nëse dhe deri në masën që vonesa në zbatim ose ndonjë dështim tjetër në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kontratës, vijnë si pasojë e ngjarjeve të Forcës Madhore.

32.2 Për qëllimet e këtij neni "Forcë Madhore" do të thotë një ngjarje jashtë kontrollit të kontraktorit dhe e paparashikueshme. Ngjarje të tilla mund të përfshijnë, por nuk kufizohen nga, veprimet e Autoritetit Kontraktor, qoftë në kapacitetin e tij sovran ose kontraktual, lufta ose revolucionet, zjarri, përmbytja, tërmeti, epidemitë, shtrëngime të karantinës dhe embargo tranziti.

32.3 Nëse ndodh ndonjë situatë e Forcës Madhore, kontraktori duhet të njoftojë menjehere Blerësin Publik. Me përjashtim kur Autoriteti Kontraktor jep udhëzime të ndryshme, kontraktori duhet të vazhdojë të zbatojë detyrimet e tij sipas kontratës në masën praktikisht të arsyeshme dhe duhet të kërkojë të gjitha mjetet e arsyeshme për zbatimin që nuk pengohet nga Forca Madhore.

**Neni 33: Vonesa në Zbatim dhe Zgjatja e Afatit**

33.1 Me përjashtim kur parashikohet ndryshe, kontraktori duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëherë pas nënshkrimit të saj.

33.2 Me përjashtim kur Autoriteti Kontraktor është dakort për zgjatje të afatit të kontratës, ka të drejtë të kërkojë dëmet për vonesën në zbatim, nëse kontraktori dështon në dorëzimin e punës brenda Afatit së Dorëzimit të Plotë të specifikuar në kontratë.

33.3 Autoriteti Kontraktor mund të zbresë shumën e dëmeve të likuidueshme që duhen paguar nga shuma e pagesës ndaj kontraktorit. Në rast të tillë Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi kontraktorit njoftim me shkrim për shumën dhe arsyen e zbritjes.

33.4 Autoriteti Kontraktor do të jetë dakort për një zgjatje të afatit, në rastin e Forcës Madhore.

33.5 Autoriteti Kontraktor, mund të jetë dakort për zgjatje të afatit edhe në rrethana të tjera në se është në interesin publik për ta bërë këtë. Ne rast se kontraktori ndeshet me kushte që pengojnë zbatimin në kohë, kontraktori duhet të njoftojë menjehere Autoritetin Kontraktor me shkrim për vonesën, shkakun dhe datën e propozuar të dorëzimit ose përfundimit. Autoriteti Kontraktor duhet të vlerësojë kërkesën. Nëse Autoriteti Kontraktor është dakort me vonesën, zgjatja do të hyjë në fuqi me një amendament me shkrim të kontratës të nënshkruar nga Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori.

**Neni 34: Dëmet e Likujdueshme për Vonesën në Mbarimin e Punimeve**

34.1 Dëmet e likuidueshme për vonesën në mbarimin e Punimeve do të llogariten me tarifat e mëposhtme ditore:

NDERTIM - PROJEKTIM CURRI Tel/Fax: 04 2232098 TIRANE - ALBANIA



Adresa:Koplik-Qender tel:021122650/2651 e-mail:bashkiamalesiemadhe@hotmail.com

a) Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 6 muaj, tarifa ditore do të jetë 4/1000 të vlerës korresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës, por kjo vlere do te llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontrates.
b) Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 2/1000 të vlerës korresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës, por kjo vlere do te llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontrates.
c) Për kontratat me periudhë zbatimi më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 1/1000 të vlerës korresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës, por kjo vlere do te llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontrates.

**Neni 35: Negociatat dhe Amendamentet**

35.1 Palët nuk do të negociojnë ndryshime ose amendamente të asnjë kushti të kontratës që do të ndryshonte dukshëm kushtet që përbëjnë bazën e përzgjedhjes së kontraktorit.

35.2 Asnjë amendament ose variacion tjetër i kontratës nuk do të jetë i vlefshëm pa qënë me shkrim, me datë, i referohet shprehimisht kontratës dhe nënshkruhet nga një përfaqsues i autorizuar i kontraktorit dhe Autoriteti Kontraktor.

35.3 Çdo heqje dore nga të drejtat, pushtetet ose ndreqjet që mund të bëhen nga palët sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim, të ketë datë dhe të firmoset nga një përfaqsues i autorizuar i palës që bën këtë dorëheqje dhe duhet të specifikojë të drejtën dhe masën në të cilën ajo lëshohet.

**Neni 36: Ndryshimi i Porosisë**

36.1 Kushtet e kontratës nuk janë subjekt rinegocimi dhe amendimi pas hyrjes në fuqi me përjashtim kur lejohet specifikisht dhe parashikohet në kushtet e kontratës. Çdo amendament i kontratës duhet të bëhet me shkrim dhe firmosur nga Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori.

36.2 Ndertime shtesë mund të porositen vetëm në rethana të përcaktuar në LPP dhe me kusht që shtesa e kontratës të mos i kalojë 20% të çmimit origjinal të kontratës.

36.3 Autoriteti Kontraktor në çdo kohë, mund të porosisë kontraktorin të bëjë ndryshime brenda qëllimit të përgjithshëm të kontratës në secilin nga elementët e më poshtëm:
a) Korrigjime në projektin, vizatimin ose specifikimet e Punëve
b) Korrigjime në materiale
c) Korrigjime në sasi

36.4 Përpara se të kërkojë një ndryshim, Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori duhet të bien dakort për çdo rritje ose ulje të çmimit të kontratës dhe/ose ndryshim në grafikun e zbatimit ose përfundimit që është shkaktuar nga ndryshimi. Porosia e ndryshuar duhet të materilizojë amendamentet e marrveshjes. Autoriteti Kontraktor nuk ka të drejtë të nxjerrë pretendime për pajtimin me ndryshimin e porositur përveç rregullimeve të siguruara në amendamentet e marrveshjes.

NDERTIM - PROJEKTIM CURRI Tel/Fax: 04 2232098 TIRANE - ALBANIA



Adresa:Koplik-Qender tel:021122650/2651 e-mail:bashkiamalesiemadhe@hotmail.com

36.5 Ndryshimi i porosise nuk do te jete i vlefshem nese nuk formalizohet sipas kerkesave te Nenit 35 te ketyre kushteve te pergjithshme.

**Neni 37: Preventivi për Njësi ose në Total**

37.1 Kontrata do të përfshijë një Preventiv në Total nëse është një kontratë me shumë totale ose një Preventiv për Njësi nëse është një kontratë me çmim njësie. Nëse është një kontratë me çmim njësie, preventivi për njësi do të përmbajë volumet e zërave të ndërtimit, instalimin, testimin dhe komisionet që bëhen nga kontraktori.

37.2 Preventivi për Njësi do të përdoret për të llogaritur çmimin e kontratës. Kontraktori do të paguhet për sasinë e realizuar me tarifën në preventivin në njësi për secilin zë punimesh.

**Neni 38: Mbarimi dhe marrja përsipër e ndërtimeve**

38.1 Kontraktori duhet t'i kërkojë drejtuesit të projektit t'i lëshojë një certifikatë për mbarimin e Punimeve dhe drejtuesi i projektit do t'a bëjë këtë sapo të vendosi se Punimet janë mbaruar plotësisht.

38.2 Nëse drejtuesi i projektit zbulon se Punimet nuk janë përfunduar plotësisht, drejtuesi i projektit do t'i japi udhezime me shkrim kontraktorit që specifikojnë zerat e punimeve ose aktivitetet që duhen përfunduar para se të lëshohet certifikata.

38.3 Nëse drejtuesi i projektit zbulon defekte në Punime, drejtuesi i projektit duhet t'i japi kontraktorit njoftim me shkrim duke specifikuar defektet që duhet të korrigjohen para se të lëshohet certifikata.

**Neni 39: Ndërprerja për Mosplotësim**

39.1 Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në tërësi ose pjesërisht nëse:
a) kontraktori dështon në kryerjen e Punëve brenda periudhës së specifikuar në kontratë ose brenda zgjatjes së dhënë; ose,
b) kontraktori dështon të zbatojë ndonjë detyrim tjetër të kontratës.

39.2 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi kontraktorit njoftim me shkrim për ndërprerjen për mosplotësim dhe t'i japi kontraktorit 15 ditë të ndreqë mosplotësimin me përjashtim kur ndërprerja është bërë për veprime të korruptuara ose të paligjshme, rast në të cilin ndërprerja do të jetë e menjëhershme.

39.3 Të gjitha materialet, Ngritja e Kantierit dhe Punët e përfundura do të bëhen pronë e Autoriteti Kontraktor nëse kontrata ndërpritet për mosplotësim te kushteve te saj

**Neni 40: Ndërprerja për Shkak të Falimentimit**

40.1 Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse kontraktori falimenton ose bëhet i paaftë të paguajë.

40.2 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi kontraktorit njoftim me shkrim për ndërprerjen.

NDERTIM - PROJEKTIM CURRI Tel/Fax: 04 2232098 TIRANE - ALBANIA



Adresa:Koplik-Qender tel:021122650/2651 e-mail:bashkiamalesiemadhe@hotmail.com

**Neni 41: Ndërprerja për Shkak të Interesit Publik**

41.1 Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse gjykon se ky veprim duhet ndërmarrë për t'i shërbyer sa më mirë interesit publik.

41.2 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi kontraktorit lajmërim me shkrim për ndërprerjen.

41.3 Autoriteti Kontraktor duhet të paguajë kontraktorin për të gjitha Punët e pranuara dhe të kryera përpara ndërprerjes dhe duhet t'i paguajë kontraktorit dëmet e shkaktuara për kryerjen e pjesshme të Punëve. Në llogaritjen e shumës së dëmeve, kontraktori do të kërkohet të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të minimizuar dëmet.

**Neni 42: Nënkontraktimi**

42.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është në formën e një marrveshjeje të shkruar me anë të së cilës kontraktori i beson kryerjen e një pjese të detyrimeve të kontratës së tij një pale të tretë.

42.2 Kontraktori nuk duhet të nënkontraktojë pa aprovimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktor. Kontraktori duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktor për elementet e kontratës që nënkontraktohet dhe dokumentacinin që provon aftësine e nën-kontraktorit. Autoriteti Kontraktor duhet të lajmërojë kontraktorin për vendimin e tij, brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke shprehur arsyet nëse e aprovon apo jo atë.

42.3 Cdo nenkontraktor duhet te kete te drejte te marre pjese ne prokurimin publik sipas Ligjit mbi Prokurimin Publik. Autoriteti mund të parashikojë pagesa direkete tek nënkontraktori për punët që do të kryejë

42.4 Kontraktori mbetet plotësisht përgjegjës për zbatimin e kontratës pavarësisht nga sjellja e nenkontraktorit.

**Neni 43: Transferimi i të Drejtave**

43.1 Kontraktori nuk duhet të transferojë, tërësisht ose pjesërisht, detyrimet e tij sipas kontratës me përjashtim kur jepet miratimi paraprak nga Autoriteti Kontraktor.

**Neni 44: Sigurimi i Kontrates**

44.1 Përpara nënshkrimit të kontratës, kontraktuesi duhet ti dorëzojë Autoriteti Kontraktor sigurimin e kontratës në shumën dhe formën e kërkuar.

44.2 Shuma e sigurimit te kontrates duhet t'i paguhet Autoriteti Kontraktor si kompensim për çdo humbje të rezultuar nga dështimi i kontraktori në plotësimin e detyrimeve të tij sipas kontratës.

44.3 Sigurimi i kontrates do t'i kthehet kontraktorit jo më vonë se 30 ditë pas datës sëmarrjes në dorëzim të punimeve. Megjithatë, pesë (5) përqind e sigurimit do të mbahet deri në përmbushjen e kënaqshme të detyrimeve të garancisë.

NDERTIM - PROJEKTIM CURRI Tel/Fax: 04 2232098 TIRANE - ALBANIA



Adresa:Koplik-Qender tel:021122650/2651 e-mail:bashkiamalesiemadhe@hotmail.com

**Neni 45: Baza Ligjore**

45.1 Kontrata do të rregullohet dhe interpretohet sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.

**Neni 46: Zgjidhja e Mosmarrveshjeve**

46.1 Autoriteti Kontraktor dhe kontraktori duhet të bëjnë çdo përpjekje të zgjidhin mosmarrveshjet ose konfliktet e ndodhura midis tyre ose në lidhje me këtë marrveshje me negociata direkte.

46.2 Në se palët dështojnë në zgjidhjen e mosmarrveshjes ose konfliktit, ato i drejtohen zgjidhjes së marrveshjeve sipas kontratës dhe procedurave juridike në fuqi sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë.

**Neni 47: Përfaqsimi i Palëve**

47.1 Çdo palë duhet të emërojë me shkrim një person ose strukture organizative, që do të jetë përgjegjës, në emër të palës, për marrjen e komunikatave dhe për përfaqësimin e palës në çështjet e lidhura me egzekutimin e kontratës.

47.2 Secila palë duhet të lajmërojë palën tjetër menjëherë për ndonjë ndryshim në emërimin e përfaqsuesit të palës. Në se njëra palë dështon të lajmërojë, duhet të marri përsipër çdo humbje të shkaktuar nga dështimi për të dhënë njoftim të mjaftueshëm.

47.3 Palët mund të emërojnë persona ose struktura organizative shtesë për të përfaqsuar palën në veprime ose veprimtari të veçanta në të cilin rast njoftimi me shkrim duhet dhënë dhe duhet të përcaktojë shtrirjen e autoritetit të përfaqsuesit.

**Neni 48: Lajmërimet**

48.1 Çdo lajmërim i dhënë nga njëra palë tjetrës sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim në adresën e specifikuar në kontratë.

48.2 Njoftimi do të ketë efekt sapo të dorëzohet.

**Neni 49: Llogaritja e Afateve**

49.1 Të gjitha referencat e ditëve do të jenë ditë kalendarike me përjashtim kur parashikohet ndryshe.

NDERTIM - PROJEKTIM CURRI Tel/Fax: 04 2232098 TIRANE - ALBANIA



Adresa:Koplik-Qender tel:021122650/2651 e-mail:bashkiamalesiemadhe@hotmail.com

## KUSHTET E VEÇANTA
**Punët – Procedura e Hapur**

Kushtet e veçanta të Kontratës do të plotësojnë Kushtet e Përgjithshme të Kontratës. Në rast se ka mospërputhje midis KPK dhe KVK do të mbizotërojne Kushtet e veçanta të kontratës.

**Neni 1: Përkufizime**

1.1 Autoriteti Kontraktor është Bashkia Malësi e Madhe me Nipt: K48420701I, e përfaqësuar nga z. Tonin Marinaj (Kryetar), përfaqësues i vetëm që më poshtë do të quhet "Autoriteti Kontraktor"

1.2 Kontraktori është " CURRI " SHPK, me NIPT: J 67902718 S, e perfaqesuar nga z. Faik Curri/ Administrator, adresa: Tirane, Njesia Bashkiake, Nr. 10, Rruga Kajo Karafili, Pallati Bimbashi 8/2, shkalla II, Ap. 2B.

**Neni 2: Sigurimi i Kontrates**

2.1 Sigurimi i kontratës në shumën prej *(10% të vlerës së ofertës)* duhet të ofrohet nga kontraktori për të siguruar ekzekutimin e detyrimeve të tij sipas kontratës. ( Kontraktori ka paraqitur sigurimin e kontrates me date 27.09.2017 ne vleren 9 978 976 (nentemilionenenteqindeshtatedhjeteetetemijeenenteqindeshtatedhjeteegjashte) lek, me nr.Serie: 46452499 prane Shoqeri Sigurimesh " ALBSIG ".

2.2 Sigurimi i kontratës do t'i lëshohet ose kthehet, menjëherë, kontraktorit sipas skedarit të mëposhtëm:

________________________________________

________________________________________

**Neni 3: Drejtuesi i Projektit**

3.1 Drejtuesi i Projektit do të jetë: InfraKonsult SHPK, NIPT: L 21512022 F

**3.2** Adresa/pika e kontaktit: Tirane Njesia Bashkiake nr. 8, rruga Qemal Stafa, pallati 25, hyrja 4, apartamenti 4, perballe Qendres Lincoln.

**Neni 4: Kantieri**

4.1 Kantieri i Punëve do të jetë (Pershkrimi i saktë i vendodhjes së objektit që do të realizohet): Bajze, Njesia Adm Kastrat.

**Neni 5: Data e Fillimit**

5.1 Kontraktorit do t'i jepet leja për të hyrë në kantier më: 2.10.2017



Adresa:Koplik-Qender tel:021122650/2651 e-mail:bashkiamalesiemadhe@hotmail.com

**Neni 6: Siguracioni**

6.1 Nga Data e hyrjes deri në Afatin e Mbarimit kontraktori duhet të ketë siguracion që mbulon deri në shumën prej:

a. Për dëmtime ose humbje të Punëve dhe Materialeve: ________________________
b. Për dëmtime ose humbje të Pajisjeve: ________________________
c. Për dëmtime ose humbje të pasurisë përveç Punëve, Materialeve dhe Pajisjeve: _____
d. Për dëmtim personal ose vdekje të personave në kantier: ____________________

**Neni 7: Inspektimet dhe Testimet**

7.1 Inspektimet dhe testimet para vërtetimit të mbarimit të Punëve do të përfshijnë: ________
________________________________________
________________________________________
________________________________________

**Neni 8: Lloji i Kontratës**

8.1 Kjo kontratë do të çmohet si një

- ❑ Kontratë me Çmim Njësie të bazuar në çmimet e njësisë të shprehura në Preventivin në Njësi
- ❑ Kontratë me Shumë Totale

**Neni 9: Grafiku i Pagesës**

9.1 Pagesa duhet bërë sipas grafikut të mëposhtëm: ______________________________

9.2 Pagesa për Punët duhet bërë brenda _________ ditëve nga data që kontraktori paraqet një dokument që deklaron se objektivi për pagesën është arritur subjekt ky i konfirmimit të dokumentit nga drejtuesi i projektit. Nëse është lënë e paplotësuar, periudha kohore do të jetë 30 ditë.

9.3 Monedha e pagesës do të jetë ______. Nëse nuk është specifikuar, pagesa do bëhet me monedhën Shqiptare.

9.4 Pagesa do te behet ne llogarine bankare te CURRI SHPK

BANKA KOMBETARE TREGTARE

Nr. llogarise: 110009383

**Neni 10: Pagesa Paraprake**

10.1 Përqindja e pagesës paraprake do të jetë _____. Nëse nuk është specifikuar, kontraktori nuk do të marrë pagesë paraprake.

10.2 Nëse është premtuar një pagesë paraprake, avanca do të paguhet brenda ______ ditëve nga marrja e sigurimit te kontrates.

NDERTIM - PROJEKTIM CURRI Tel/Fax: 04 2232098 TIRANE - ALBANIA



Adresa:Koplik-Qender tel:021122650/2651 e-mail:bashkiamalesiemadhe@hotmail.com

10.3 Nëse jepet pagesa paraprake, shuma do të hiqet nga pagesa që duhet t'i jepet kontraktorit sipas formulës së mëposhtme:________________________________

________________________________________________

**Neni 11: Shërbimet në Lidhje me to**

11.1 Kushtet e veçanta të mëposhtme do të zbatohen për kryerjen e pagesës së shërbimeve të lidhura

________________________________________________

________________________________________________

________________________________________________

________________________________________________

**Neni 12: Zbritja e garancisë së kontratës**

12.1 Nëse parashikohet zbritje periodike të garancisë së kontratës ajo kryhet si më poshtë

________________________________________________

___________________________________________

Nëse nuk plotësohet, garancia mbetet e pandryshuar.

**Neni 13: Afati i Garancise se defekteve**

Periudha e garancise se defekteve do te jete 1 (nje) vit nga data e firmosjes se aktit te kolaudimit.

**PALET KONTRAKTORE**

| | |
|---|---|
| **BASHKIA MALESI E MADHE** | **" CURRI " SHPK** |
| **TONIN MARINAJ** | **FAIK CURRI** |
| **KRYETAR** | **ADMINISTRATOR** |

Konceptoi: E. Smakaj (Jurist)



Adresa:Koplik-Qender tel:021122650/2651 e-mail:bashkiamalesiemadhe@hotmail.com

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALËSI E MADHE

Nr. 4076 Prot. Koplik, më 2.10.2017

# KONTRATË

## (Punë Publike)

## Për

### " SUPERVIZIM RIKUALIFIKIMI I QENDRES BAJZE KASTRATI, LOTI I-RE "

Në mbështetje të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, Ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 " Për Prokurimet Publike" i ndryshuar, VKM NR. 914 date 29.12.2014 " Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar,
Lidhur sot me datë 2.10.2017, nën vullnetin e plotë dhe të lirë, midis palëve:

**Bashkia Malësi e Madhe** me Nipt: K48420701I, e përfaqësuar nga z. Tonin Marinaj (Kryetar), përfaqësues i vetëm që më poshtë do të quhet: ***"Autoriteti Kontraktor"***, dhe

InfraKonsult SHPK, NIPT: L 21512022 F,perfaqesuar nga z. Redi Strug /Administrator, adresa: Tirane Tirane TIRANE Njesia Bashkiake nr. 8, rruga "Qemal Stafa", pallati 25, hyrja 4, apartamenti 4, perballe Qendres Lincoln, qe me poshte do te quhen ***"Kontraktuesi"***.

InfraKonsult
konsulence inxhinierike
Tirana, Albania

# KUSHTET E PËRGJITHSHME
## Shërbimet –Kërkesë për propozim

**Neni 1: Qellimi**

1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për kryerjen e sherbimeve të prokuruara me anë të procedurës kërkesë për propozim.

1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërise parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.

1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.

1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e paraqitura në pjesë të tjera të kontratës.

1.5 Kushtet e kontratës përfshijnë, gjithashtu, Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

**Neni 2: Përkufizime**

2.1 "Kontratë" do të thotë marrëveshja e shkruar e lidhur midis Blerësit Publik dhe Kontraktuesit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjitjet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.

2.2 "Cmim kontrate" do të thotë çmimi që i paguhet Kontraktuesit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.

2.3 "Objekt i kontratës" do të thotë të gjitha Shërbimet që Kontraktuesi do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.

2.4 "Palë (t)" do të thotë nënshkruesit e kontratës.

2.5 "Autoriteti Kontraktor" do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate blen sherbimin. Ky term kudo qe përdoret ka kuptim të njëjtë me ate te perkufizuar ne ligj.

2.6 "Kontraktues" do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate shet Shërbimet.

2.7 "Shërbime" do të thotë të gjitha detyrat që do të kryhen nga Kontraktuesi sipas kontratës.



Adresa:Koplik-Qender tel:021122650/2651 e-mail:bashkiamalesiemadhe@hotmail.com

2.8 "Termat e References" shprehin objektin dhe qëllimin e kontratës, përcaktojne detyrat, kërkesat, objektivat, shpërndarjen, vendin dhe dorëzimin e Shërbimeve që do të sigurohen.

**Neni 3: Hartimi i Kontratës**

3.1 Njoftimi i ofertes fituese do të sherbeje per hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në Dokumentat e Tenderit.

3.2 Egzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke trupëzuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

**Neni 3/1: Objekti i kontratës**

Objekti këtij kontratë është "Supervizim Rikualifikimi i qendres Bajze Kastrati, Loti I-re", sipas projektit, preventivit dhe sipas specifikimeve teknike në dokumentat e tenderit.

**Neni 3/2: Vlera e kontratës**

Kontrata lidhet me një vlerë totale 1 135 920 (njemilionenjeqindetridhjeteepesemijeenenteqindenjezet) leke me TVSH , sipas ofertes ekonomike bashkëngjitur këtij kontrate. Financimi i objektit kryhet me fonde nga Buxheti i Bashkise

**Neni 3/3: Kohezgjatja e kontrates**
Afati maksimal i kryerjes se punimeve eshte duke filluar nga data e lidhjes se kontrates deri ne përfundim te punimeve te ndertimit ne objektin Rikualifikimi i qendres Bajze Kastrati, Loti I-re. (12 muaj).

**Neni 4 Praktikat Korruptive, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve**

4.1 Autortiteti Kontraktues mund t'i kërkojë Gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën në se zbulon se Kontraktuesi ka kryer veprime korruptive. Veprimet korruptive përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.

4.2 Kontraktuesi nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose njësi që ka marrë pjesë në përgatitjen e dokumentave të tenderit për këtë prokurim.

4.3 Kontraktuesi duhet të lejojë Autoritetin Kontraktues të inspektojë llogaritë dhe procesverbalet që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t'i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktues.

**Neni 5 Informacioni Konfidencial**

5.1 Kontraktuesi dhe Autoriteti Kontraktor duhet të mbajnë në konfidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.

5.2 Kontraktuesi mund t'i japë nenkontraktuesit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktues deri në masën e kërkuar për nën-kontraktuesin në mënyrë që ai të kryejë punën e tij sipas kontatës. Në rast të tillë, Kontraktuesi duhet të

Infrakonsult Konsulence Inxhinierike


Adresa:Koplik-Qender tel:021122650/2651 e-mail:bashkiamalesiemadhe@hotmail.com

përfshijë në kontratën e tij me nënkontraktuesin një dispozitë që premton ruajtjen e konfidencës siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

**Neni 6 Prona Intelektuale**

6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga Kontraktuesi gjatë Kontrates do t'i përkasin Autoritetit Kontraktues i cili mund t'i përdorë ato sipas gjykimit të tij.

6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, Furnizuesi, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i dorëzojë Autoriteti Kontraktues të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramët, skicimet, specifikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose pregatitura nga Kontraktuesi gjatë kontratës. Kontraktuesi mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, por nuk duhet t'i përdori për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktues.

6.3 Kontraktuesi duhet të sigurojë Autoritetin Kontraktues nga mospërgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale që mund të dalin nga prodhimi ose kryerja e Shërbimeve sipas kontratës.

6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoriteti Kontraktues në lidhje më ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i gjërave të furnizuara sipas kontratës, Kontraktuesi duhet t'i japë Autoriteti Kontraktues të gjitha provat dhe informacionin në posedim të Kontraktuesit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

**Neni 7 Detyrimet e Përgjithshme të Kontraktuesit**

7.1 Kontraktuesi duhet t'i kryejë Shërbimet dhe përmbushi detyrimet e tij me të gjitha përpjekjet, eficiente dhe ekonomike në pajtim me teknikat dhe praktikat profesionale te pranuara ne përgjithësi.

7.2 Kontraktuesi duhet të ndjekë praktika të shëndosha të biznesit dhe të përdorë teknologji të avancuar dhe të përshtatshme si dhe metoda të sigurta.

7.3 Në se kontrata kërkon kryerjen e shërbimeve këshillimore profesionale, Kontraktuesi duhet të veprojë gjithmonë si një këshillues besnik i Autoriteti Kontraktues, në pajtim me rregullat dhe kodin e sjelljes të profesionit të tij dhe duhet që të mbështesi dhe ruajë gjithmonë interesin publik.

7.4 Në se kontrata kërkon kryerjen e shërbimeve këshillimore profesionale, Kontraktuesi duhet të ushtrojë kujdes të plotë në mardhëniet me palët e treta duke përfshirë median dhe nuk duhet të marrë pjesë në veprime që janë jashte kompetencës së tij në përfaqsimin e Autoritetit Kontraktues.

**Neni 8 Detyrimet e Veçanta të Kontraktuesit**

8.1 Kontraktuesi duhet të kryejë të gjitha Shërbimet siç specifikohet tek Termat e References.


Adresa:Koplik-Qender tel:021122650/2651 e-mail:bashkiamalesiemadhe@hotmail.com

8.2 Kontraktuesi duhet t'i paraqesë Autoritetit Kontraktues të gjitha sherbimet, në sasitë e përcaktuara, siç kërkohen nga kontrata duke përfshirë, por jo të kufizuara nga, të gjitha raportet, dokumentat, studimet, skicimet dhe planimetritë.

8.3 Kontraktuesi duhet të sigurojë raportet e lidhura me zbatimin e Shërbimeve siç kërkohet në kontratë.

**Neni 9 Specifikime dhe Skicime**

9.1 Në se kontrata kërkon shërbime skicimi, Kontraktuesi duhet të pregatisi të gjitha specifikimet dhe skicimet duke përdorur sisteme të pranuara dhe të njohura në përgjithsi të pranueshme për Autoritetet Kontraktues dhe të marri parasysh standartet më të fundit.

9.2 Nëse kontrata kërkon shërbime skicimi, Kontraktuesi duhet të sigurojë se të gjitha specifikimet, skicimet dhe kërkesat e tjera janë pregatitur në bazë asnjanëse përsa i përket nxitjes së konkurencës në prokurimin e objekteve të skicimit.

**Neni 10 Lejet dhe Liçensat**

10.1 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për sigurimin e lejeve ose liçensave sipas kërkesave të Ligjeve të Republikës së Shqipërisë për kryerjen e Shërbimeve në këtë kontratë vec rastit kur palet bien dakord ndryshe.

**Neni 11 Heqja dhe Zëvendësimi i Personelit Kryesor**

11.1 Kontraktuesi duhet të sigurojë aprovim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues përpara heqjes ose zëvendësimit të personelit kryesor siç përshkruhet në oferten e Kontraktuesit.

11.2 Kontraktuesi do të zëvendësojë çdo punonjës në se Autoriteti Kontraktues zbulon se personi ka kryer veprime të jashtëligjshme ose Autoriteti Kontraktues është mjaft i pakënaqur nga puna e personit.

11.3 Nëse bëhet e nevojshme të zëvendësohet ndonjë nga personeli kryesor, Kontraktuesi duhet të sigurojë si zëvendësues një person me kualifikime ekuivalente ose më te mira.

11.4 Kontraktuesi do të paguajë kosto shtesë për zëvendësimin e personelit kryesor me përjashtim kur shkaku i zëvendësimit ka ardhur nga neglizhenca ose mungesa e kujdesit të Autoriteti Kontraktues.

**Neni 12 Vendndodhja**

12.1 Shërbimet duhet të kryhen në vendin ose vendet e specifikuara në kontratë.

12.2 Në se nuk është specifikuar vendi, Autoriteti Kontraktues rezervon të drejtën të aprovojë vendin ose vendet e kryerjes së Shërbimeve, megjithatë, aprovimi nuk duhet të vonohet ne mënyrë të paarsyeshme.

## Neni 13 Siguracioni i Përgjegjësisë Profesionale

13.1 Kontraktuesi duhet të mbajë siguracion për përgjegjësi profesionale sipas rregullave dhe praktikave të njohura në përgjithsi për profesionin për ta zhdëmtuar Autoriteti Kontraktues për dëme të rezultuara nga neglizhenca, gabimet ose mangësitë, në kryerjen e Shërbimeve.

13.2 Nëse nuk është përcaktuar në kontratë shuma minimale e siguracionit, Kontraktuesi duhet të sigurojë siguracion në shumën e njohur në përgjithsi si të mjaftueshme nën rrethanat e Shërbimeve që po sigurohen.

## Neni 14 Çmimi i Kontratës

14.1 Çmimi i kontratës duhet të jetë çmimi i ofruar në oferten e Kontraktuesit dhe i pranuar nga Autoriteti Kontraktues.

## Neni 15 Afatet e Pagesës

15.1 Çmimi i kontratës, duke përfshirë çdo pagesë paraprake, duhet të paguhen në kohë siç specifikohet në kontratë.

15.2 Me përjashtim kur parashikohet nga një dispozitë tjetër në kontratë, pagesa duhet bërë në monedhë Shqiptare. Kursi i shkëmbimit i monedhave të ndryshme do të jetë kursi i Bankes se Shqiperise në ditën kur është dërguar njoftimi i kontratës për botim.

15.3 Me përjashtim kur parashikohet nga një dispozitë tjetër në kontratë, kërkesa e Kontraktuesit për pagesë duhet t'i bëhet Autoriteti Kontraktues me shkrim. Për çdo kërkesë, Kontraktuesi duhet të paraqesë origjinalin dhe kopjen së bashku me një listë të sendeve që përshkruan shërbimet e kryera për të cilat duhet paguar.

15.4 Me përjashtim kur parashikohet nga një dispozitë tjetër në kontratë, pagesa për shërbimet do të bëhet brenda 30 ditëve kalendarike nga dita qe janë kryer Shërbimet, dorëzimi është paraqitur ose arritur, ose nga dita e marrjes së kërkesës për pagesë cilado të jetë më e vonë.

15.5 Data e pagesës do të jëte dita që fondet debitohen nga llogaria e Autoritetit Kontraktues.

## Neni 16 Vonesa në Bërjen e Pagesës

16.1 Dëmet e llogaritura, të shkaktuara si rezultat i vonesës në pagesë, konsistojnë në kamaten që fillon nga data e vonesës së debitorit (Autoritetit Kontraktues), në monedhën zyrtare të vendit ku do të bëhet pagesa. Përqindja e kamates parashikohet me ligj. Në fund të çdo viti, interesi i maturuar i shtohet shumës totale, mbi të cilën është llogaritur interesi i maturuar.

16.2 Kamata ligjore paguhet pa detyruar kreditorin (Kontraktuesin) te provoje ndonje dem. Në se kreditori (Kontraktuesi) provon se ka pesuar një dëm me te madh se kamata ligjore, debitori (Autoriteti Kontraktues) duhet të paguajë pjesën e mbetur të dëmit.

## Neni 17 Ndryshimi i Ligjeve dhe Rregulloreve

17.1 Nëse pas datës së nënshkrimit të kontratës, ndonjë ligj, rregullore, urdhëresë, urdhër ose procedurë me efektin e ligjit në Republikën e Shqipërisë hyn në fuqi, nxirret ose ndryshon


Adresa:Koplik-Qender tel:021122650/2651 e-mail:bashkiamalesiemadhe@hotmail.com

dhe ndikon kushtet, duke përfshirë datën e dorëzimit, ose çmimin e kontratës, kushtet ose çmimi i kontratës do të rregullohen në atë masë sa kontraktuesi është ndikuar në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kontratës.

## Neni 18 Forca Madhore

18.1 Kontraktuesi nuk duhet të mbajë përgjegjësi për humbjen e depozitës së kontrates, dëmet e likuiduara ose ndërprerjen për mosplotësim nëse dhe deri në masën që vonesa në zbatim ose ndonjë dështim tjetër në zbatimin e detyrimeve të tij sipas kontratës vijnë si rezultat i ndodhjes së Forcës Madhore.

18.2 Për qëllimet e këtij neni "Forcë Madhore" do të thotë një ngjarje e paparashikueshme jashtë kontrollit të Kontraktuesit mbi fajin ose neglizhimin. Ngjarje të tilla mund të përfshijnë, por nuk janë të limituara nga, veprimet e Autoritetit Kontraktues qoftë në kapacitetin e tij sovran ose kontraktual, lufta ose revolucionet, zjarri, përmbytja, tërmeti, epidemitë, shtrëngime të karantinës dhe embargo tranziti.

18.3 Në se ndodh ndonjë situatë e Forcës Madhore, Kontraktuesi duhet të njoftojë menjehere Autoriteti Kontraktues. Me përjashtim kur Autoriteti Kontraktues jep direktiva të ndryshme, Kontraktuesi duhet të vazhdojë të zbatojë detyrimet e tij sipas kontratës në masën praktikisht të arsyeshme dhe duhet të kërkojë të gjitha mjetet e arsyeshme për zbatimin që nuk pengohet nga Forca Madhore.

## Neni 19 Vonesa në Zbatim dhe Zgjatja e Afatit

19.1 Me përjashtim kur parashikohet ndryshe, Kontraktuesi duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëherë pas nënshkrimit të saj.

19.2 Me përjashtim të rastit kur Autoriteti Kontraktues është dakord për zgjatje të afatit të kontratës, Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të likuidojë dëmet për vonesën në zbatim nëse Kontraktuesi dështon në kryerjen e Shërbimeve brenda periudhës së Kontrates.

19.3 Autoriteti Kontraktues mund të zbresë shumën e dëmeve të likuiduara që duhet paguar nga shuma e pagesës ndaj Kontraktuesit. Në rast të tillë Autoriteti Kontraktues duhet t'i japi kontraktuesit njoftim me shkrim për shumën dhe arsyen e zbritjes.

19.4 Autoriteti Kontraktues do të jetë dakort për një zgjatje të afatit në rastin e Forcës Madhore.

19.5 Autoriteti Kontraktues mund të jetë dakort për zgjatje të afatit edhe në rrethana të tjera nëse është në interesin publik për ta bërë këtë. Ne rast se Kontraktuesi ndeshet me kushte që pengojnë zbatimin në kohë, Kontraktuesi duhet të njoftojë menjehere Autoritetin Kontraktor me shkrim për vonesën, shkakun dhe datën e propozuar të përfundimit të Shërbimeve. Autoriteti Kontraktor duhet të vlerësojë kërkesën. Nëse Autoriteti Kontraktor është dakort me vonesën, zgjatja do të hyjë në fuqi me një amendament me shkrim të kontratës të nënshkruar nga Autoriteti Kontraktor dhe Kontraktuesi.

## Neni 20 Likuidimi i Dëmeve për Dorëzimin e Vonuar

20.1 Dëmet e likuidueshme për kryerjen e vonuar të Shërbimeve do të llogariten me tarifat e mëposhtme ditore:

a) Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 6 muaj, tarifa ditore do të jetë 4/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.
b) Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 2/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.
c) Për kontratat me periudhë zbatimi më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 1/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.

**Neni 21 Negociatat dhe Amendamentet**

21.1 Palët nuk do të negociojnë ndryshime ose amendamente të asnjë elementi të kontratës që do të ndryshonte mjaftueshëm kushtet që përbëjnë bazën e përzgjedhjes së Kontraktuesit.

21.2 Asnjë amendament ose variacion tjetër i kontratës nuk do të jetë i vlefshëm pa qënë me shkrim, me datë, t'i referohet shprehimisht kontratës dhe nënshkruhet nga një përfaqsues i autorizuar i Kontraktuesit dhe Autoritetit Kontraktor.

21.3 Çdo heqje dore nga të drejtat, pushtetet ose ndreqjet që mund të bëhen nga palët sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim, të ketë datë dhe të firmoset nga një përfaqsues i autorizuar i palës që bën këtë dorëheqje dhe duhet të specifikojë të drejtën dhe masën në të cilën ajo lëshohet.

**Neni 22 Ndryshimi i Porosisë**

22.1 Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të porosisë Shërbime shtesë deri në një sasi që nuk i kalon 20% të çmimit total të kontratës. Çdo porosi shtesë duhet të bëhet në mënyrë konsistente me rregullat dhe procedurat e parashikuara në Ligjin mbi Prokurimin Publik.

**Neni 23 Ndërprerja për Mosplotësim**

23.1 Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në tërësi ose pjesërisht nëse:
a) Kontraktuesi dështon të kryejë Shërbimet brenda periudhës së specifikuar në kontratë ose brenda zgjatjes së dhënë; ose,
b) Kontraktuesi dështon të zbatojë ndonjë detyrim tjetër të kontratës.

23.2 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi Kontraktuesit njoftim me shkrim për ndërprerjen për mosplotësim dhe t'i japi Kontraktuesit 15 ditë të ndreqë mosplotësimin me përjashtim kur ndërprerja është bërë për veprime korruptive ose të paligjshme, rast në të cilin ndërprerja do të jetë e menjëhershme.

**Neni 24 Ndërprerja për Shkak të Falimentimit**

24.1 Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse Kontraktuesi falimenton ose bëhet i paaftë të paguajë.

24.2 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi Kontraktuesit njoftim me shkrim për ndërprerjen.

InfraKonsult Konsulence Inxhinierike Tirane - Albania



Adresa:Koplik-Qender tel:021122650/2651 e-mail:bashkiamalesiemadhe@hotmail.com

**Neni 25 Ndërprerja për Shkak të Interesit Publik**

25.1 Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse gjykon se ky veprim duhet ndërmarrë për t'i shërbyer sa më mirë interesit publik.

25.2 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi Kontraktuesit lajmërim me shkrim për ndërprerjen.

25.3 Autoriteti Kontraktor duhet të paguajë Kontraktuesin për të gjitha Shërbimet e kryera përpara ndërprerjes dhe duhet t'i paguajë Kontraktuesit dëmet e shkaktuara për kryerjen e pjesshme të Shërbimeve. Në llogaritjen e shumës së dëmeve, Kontraktuesi do të kërkohet të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të minimizuar dëmet.

**Neni 26 Nënkontrata**

26.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është në formën e një marrveshjeje të shkruar me anë të së cilës kontraktori i beson kryerjen e një pjese të detyrimeve të kontratës së tij një pale të tretë

26.2 Kontraktori nuk duhet të nënkontraktojë pa aprovimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktor dhe jo më shumë se 40% të vlerës së kontratës. Kontraktori duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktor për elementet e kontratës që nënkontraktohet dhe dokumentacionin që provon aftësine e nënkontraktorit. Autoriteti Kontraktor duhet të lajmërojë kontraktorin për vendimin e tij, brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke shprehur arsyet nëse e aprovon apo jo atë.

26.3 Cdo nenkontraktor duhet të kete te drejte te marre pjese ne prokurimin publik sipas Ligjit mbi Prokurimin Publik. Autoriteti mund të parashikojë pagesa direkte tek nënkontraktori për shërbimet që do të furnizojë.

26.4 Kur Kontraktuesi ka ndër mend të realizoje një pjesë të punimeve me nën-kontraktues, duhet të paraqesë në ofertë, sipas dokumentave të tenderit, gjithë dokumentacionin e kerkuar per nenkontraktuesin si dhe punimet konkrete qe do te jape me nensipermarrje.

26.5 Kontraktori mbetet plotësisht përgjegjës për zbatimin e kontratës pamvarësisht nga sjellja e nenkontraktorit.

**Neni 27 Transferimi i të Drejtave**

Kontraktuesi nuk duhet të transferojë, tërësisht ose pjesërisht, detyrimet e tij sipas kontratës me përjashtim kur jepet miratimi paraprak i Autoritetit Kontraktor.

**Neni 28 Sigurimi i Kontrates**

28.1 Përpara nënshkrimit të kontratës, kontraktuesi duhet t'i dorëzojë Autoritetit Kontraktor sigurimin e kontrates në shumën dhe formën e kërkuar.

28.2 Shuma e sigurimit të kontrates duhet t'i paguhet Autoritetit Kontraktor si kompensim për çdo humbje të rezultuar nga dështimi i Kontraktuesit në plotësimin e detyrimeve të tij sipas kontratës.

Infrakonsult konsulencë inxhinierike Tiranë - Albania

28.3 Sigurimi i kontrates do t'i kthehet Kontraktuesit jo më vonë se 30 ditë pas datës së kryerjes së Shërbimeve.

**Neni 29 Baza Ligjore**

29.1 Kontrata do të rregullohet nga dispozitat e legjislacionit shqiptar në fuqi.

**Neni 30 Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve**

30.1 Autoriteti Kontraktor dhe Kontraktuesi duhet të bëjnë çdo përpjekje të zgjidhin mosmarrëveshjet ose konfliktet e ndodhura midis tyre ose në lidhje me këtë marrëveshje me negociata direkte.

30.2 Nëse palët dështojnë në zgjidhjen e mosmarrëveshjes ose konfliktit, problemet do të konsiderohen me anë të zgjidhjes së marrëveshjeve sipas kontratës dhe procedurave juridike në fuqi sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë.

**Neni 31 Përfaqësimi i Palëve**

31.1 Çdo palë duhet të emërojë me shkrim një person ose post organizativ, që do të jetë përgjegjës, në emër të palës, për marrjen e komunikatave dhe për përfaqësimin e palës në çështjet e lidhura me egzekutimin e kontratës.

31.2 Secila palë duhet të lajmërojë palën tjetër menjëherë për ndonjë ndryshim në emërimin e përfaqsuesit të palës. Nëse njëra palë dështon të lajmërojë, duhet të marri përsipër çdo humbje të shkaktuar nga dështimi për të dhënë njoftim të mjaftueshëm.

31.3 Palët mund të emërojnë persona ose njësi organizative shtesë për të përfaqsuar palën në veprime ose veprimtari të veçanta njoftimi me shkrim në të cilin rast duhet dhënë dhe duhet të përcaktoje shtrirjen e autoritetit të përfaqsuesit.

**Neni 32 Lajmërimet**

32.1 Çdo lajmërim i dhënë nga njëra palë tjetrës sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim në adresën e specifikuar në kontratë.

32.2 Njoftimi do të ketë efekt sapo të dorëzohet.

**Neni 33 Llogaritja e Afateve**

33.1 Të gjitha referencat e ditëve do të jenë ditë kalendarike me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe.

Infrakonsult konsulence inxhinierike Tirane - Albania


Adresa:Koplik-Qender tel:021122650/2651 e-mail:bashkiamalesiemadhe@hotmail.com

## KUSHTET E VEÇANTA
**Shërbimet – Procedura e Hapur**

Kushtet e veçanta të Kontratës hartohen në përputhje me objektin konkret të kontratës. Në rast se ka mospërputhje midis KPK dhe KVK do të mbizotërojne Kushtet e veçanta të kontratës.

**Neni 1 Përkufizime**

1.1 Autoriteti Kontraktor është Bashkia Malësi e Madhe me Nipt: K48420701I, e përfaqësuar nga z. Tonin Marinaj (Kryetar), përfaqësues i vetëm që më poshtë do të quhet "Autoriteti Kontraktor".

1.2 Kontraktuesi është InfraKonsult SHPK, NIPT: L 21512022 F,perfaqesuar nga z. Redi Struga Administrator, adresa: Tirane Tirane TIRANE Njesia Bashkiake nr. 8, rruga "Qemal Stafa", pallati 25, hyrja 4, apartamenti 4, perballe Qendres Lincoln, qe me poshte do te quhen "Kontraktuesi".

**Neni 2 Sigurimi i kontratës**

2.1 Sigurimi i kontratës në shumën prej *(10% të vlerës së ofertës)* ________________ duhet të ofrohet nga Kontraktuesi për të siguruar ekzekutimin e detyrimeve të tij sipas kontratës.

(Kontraktuesi ka paraqitur sigurimin e kontrates me date 30.09.2017 ne vleren 113 592 (njeqindetrembedhjetemijeepeseqindenentedhjeteedy) leke, me nr.Serie: 017690 nga Kompani Sigurimesh INTERSIG ( VIENNA INSURANCE GROUP).

2.2 Sigurimi i Kontratës do t'i lëshohet ose kthehet, menjëherë Kontraktuesit sipas formularit të mëposhtëm:

________________

________________

________________

**Neni 3 Fillimi i Kontratës**

3.1 Zbatimi i kontratës duhet të filloje më 2.10.2017. Nëse nuk është specifikuar, zbatimi do të fillojë në datën që Kontraktuesi nënshkruan formularin e kontratës.

**Neni 4 Vendndodhja e Shërbimeve**

4.1 Shërbimet do të kryhen në: ________________

________________

________________

________________

InfraKonsult konsulence inxhinierike Tirane Albania

**Neni 5 Informacion që duhet dhënë nga Autoriteti Kontraktor**

5.1 Brenda 15 ditësh nga marrja e sigurimit të kontratës, Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi Kontraktuesit informacionin dhe dokumentat e mëposhtme: ______________________

______________________________________________________________

______________________________________________________________

______________________________________________________________

______________________________________________________________

**Neni 6 Kërkesat e Raportimit**

6.1 Gjatë zgjatjes së kontratës, Kontraktuesi duhet të sigurojë raporte për Autoritetin Kontraktor sipas formularit të mëposhtëm: ______________________________________________

______________________________________________________________

______________________________________________________________

**Neni 7 Siguracioni i Përgjegjësisë Profesionale**

7.1 Përpara fillimit të zbatimit të kontratës, Kontraktuesi duhet të sigurojë Autoritetin Kontraktor me prova për siguracionin e përgjegjësisë profesionale me shumë minimale si vijon:_________

______________________________________________________________

______________________________________________________________

**Neni 8 Kushtet e Pagesës**

8.1 Pagesa për Shërbimet duhet bërë sipas skedarit të mëposhtëm:____________________

______________________________________________________________

______________________________________________________________

______________________________________________________________

8.2 Çdo pagesë e skeduar duhet bërë brenda _________ ditëve nga data e arritjes së marrveshjes për pagesën ose nga data e marrjes së kërkesës me shkrim për pagesë cilado që të jetë më vonë. Nëse është lënë e paplotësuar, periudha kohore do të jetë 30 ditë.

8.3 Monedha e pagesës do të jetë ______. Nëse është lënë e paplotësuar, pagesa do bëhet me monedhën Shqiptare.

8.4 Pagesa do te behet ne llogarine bankare te INFRAKONSULT SHPK:

8.5 Nr. Llogarie: 428558992

**Neni 9 Pagesa Paraprake**

9.1 Përqindja e pagesës paraprake do të jetë _____. Nëse është lënë e paplotësuar, Kontraktuesi nuk do të marrë pagesë paraprake.

9.2 Nëse është premtuar një pagesë paraprake, avanca do të paguhet brenda ______ ditëve nga marrja e sigurimit te kontrates.

9.3 Nëse jepet pagesa paraprake, shuma do të hiqet nga pagesa që duhet t'i jepet Kontraktuesit sipas formulës së mëposhtme: ______________________________________________

______________________________________________________________



Infrakonsult konsulence Inxhinierike Tirane - Albania

**Neni 10 Zbritja e garancisë së kontratës**

10.1 Nëse parashikohet zbritje periodike të garancisë së kontratës ajo kryhet si më poshtë ________________________________________________________________________________
________________________________________________________________________

Nëse nuk plotësohet, garancia mbetet e pandryshuar.

**PALET KONTRAKTORE**

| | |
|---|---|
| **BASHKIA MALESI E MADHE** | **" INFRAKONSULT " SHPK** |
| **TONIN MARINAJ** | **REDI STRUGA** |
| **KRYETAR** | **ADMINISTRATOR** |

Konceptoi: E. Smakaj (Jurist)

REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA MALESI E MADHE

# KONTRATË

## SHËRBIME KONSULENCE

## *" SUPERVIZIM REHABILITIM I QENDRES SE QYTETIT KOPLIK "*

**2016**
**KOPLIK**
**MALËSI E MADHE**

*Adresa:Koplik-Qender* *tel:021122650/2651* *e-mail:bashkiamalesiemadhe@hotmail.com*

REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA MALESI E MADHE

**Nr. 2859 Prot.** **Date: 04/ 11 /2016**

# KONTRATË

## Sherbime Konsulence

## "Supervizim Rehabilitim i Qendres së Qytetit Koplik "

Në mbështetje të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, Ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 " Për Prokurimet Publike" i ndryshuar, VKM NR. 914 date 29.12.2014 " Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik",

Lidhur sot me datë 04. 11.2016, nën vullnetin e plotë dhe të lirë, midis palëve:

**Bashkia Malësi e Madhe**, e përfaqësuar nga **z. Tonin Marinaj** (Kryetar), përfaqësues i vetëm që më poshtë do të quhet: ***"Autoriteti Kontraktor"***, dhe

**Operatorit Ekonomik** : " HE & SK 11" sh.p.k , me Nr. NIPT-i L19008502B, perfaqesuar nga z. Festim Bregasi /Administrator, qe me poshte do te quhen **" *Kontraktori* "**.

REPUBLIKA E SHQIPERISE BASHKIA MALESI E MADHE

HE & SK 11 IMPORT - EXPORT KOPLIK

## KUSHTET E PËRGJITHSHME TE KONTRATES

### Neni 1

### Qëllimi

1.1 Këto kushte të përgjithshme të kontratës (KPK) do të zbatohen për Shërbimet e Konsulencës.

1.2 Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Shqipërise parashikon se dispozitat e Kodit Civil Shqiptar do të zbatohen për kontratat e prokurimit publik. Disa dispozita të Kodit Civil janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e kushteve të kontratës. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Kodit Civil të kësaj kontrate.

1.3 Në mënyrë të ngjashme, disa dispozita të Ligjit mbi Prokurimin Publik janë rishprehur në KPK me qëllim që të rrisin transparencën e ligjit që rregullon prokurimin publik. Megjithatë, citimi i disa dispozitave këtu nuk mohon në asnjë mënyrë zbatimin e dispozitave të tjera të Ligjit mbi Prokurimin Publik mbi të drejtat, detyrat dhe detyrimet e palëve.

1.4 KPK do të zbatohen deri në atë masë që të mos lënë mënjanë kushtet ose dispozitat e paraqitura në pjesë të tjera të kontratës.

Kushtet e kontratës, përfshijnë gjithashtu Kushtet e Veçanta të Kontratës (KVK). Në rast se ka një konflikt midis KPK dhe KVK, KVK do të mbizotërojnë mbi KPK.

### Neni 2

### Përkufizime

2.1 "Kontratë" do të thotë marrveshja e shkruar e lidhur midis Blerësit Publik dhe Kontraktuesit që përbëhet nga dokumentat e tenderit duke përfshirë KPK dhe KVK, të gjitha bashkangjitjet dhe formularët e plotësuar dhe të gjitha dokumentat e tjera që përfshihen në referimin e çdo dokumenti.

2.2 "Cmim kontrate" do të thotë çmimi që i paguhet Kontraktuesit sipas kontratës për zbatimin e plotë dhe të përpiktë të detyrimeve të tij kontaktore.

2.3 "Objekt i kontratës" do të thotë të gjitha Shërbimet që Kontraktuesi do të sigurojë sipas kushteve të kontratës.

2.4 "Palë (t)" do të thotë nënshkruesit e kontratës.

2.5 "Autoriteti Kontraktor" do të thotë Autoriteti Kontraktor që është pjesë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate blen sherbimin. Ky term kudo qe përdoret ka kuptim të njëjtë me ate te perkufizuar ne ligj.

2.6 "Kontraktues" do të thotë personi fizik ose juridik që është palë e kësaj kontrate dhe sipas dispozitave të kësaj kontrate shet Shërbimet.

2.7 "Shërbime" do të thotë të gjitha detyrat që do të kryhen nga Kontraktuesi sipas kontratës.

2.8 "Termat e References" shprehin objektin dhe qëllimin e kontratës, përcaktojnë detyrat, kërkesat, objektivat, shpërndarjen, vendin dhe dorëzimin e Shërbimeve që do të sigurohen.

**Neni 3**

**Hartimi i Kontratës**

3.1 Shpallja e fituesit do të sherbejë per hartimin e kontratës midis palëve, e cila duhet të firmoset brenda afatit të shprehur në dokumentat e tenderit.

3.2 Egzistenca e kontratës do të konfirmohet me nënshkrimin e dokumentit të kontratës duke materializuar të gjitha marrveshjet midis palëve.

**Neni 3/1**
**Objekti i Kontrates**

Objekti kësaj kontratë është " Supervizim Rehabilitim i Qendres së Qytetit Koplik ", sipas projektit,preventivit dhe sipas specifikimeve teknike në dokumentat e tenderit.

**Neni 3/2**
**Vlera e Kontrates**

Kontrata lidhet me një vlerë totale 2.359.999 (dymilionetreqindepesedhjeteenentemijeenenteqindenentedhjeteenente) lek me TVSH , sipas ofertes ekonomike bashkëngjitur kësaj kontrate. Financimi i objektit kryhet nga Buxheti i Bashkise ( Granti).

**Neni 3/3**

**Afati i Kontrates**

Afati maksimal i ekzekutimit te kontrates eshte deri ne perfundim te afateve te ekzekutimit te kontrates per objektin Rehabilitimi i Qendres se Qytetit Koplik.

## Neni 4

## Praktikat Korruptive, Konflikti i Interesit dhe Kontrolli i Procesverbaleve

4.1 Autortiteti Kontraktues mund t'i kërkojë Gjykatës të deklarojë të paligjshme kontratën në se zbulon se Kontraktuesi ka kryer veprime korruptive. Veprimet korruptive përfshijnë veprimet e përshkruara në Nenin 26 të Ligjit mbi Prokurimin Publik.

4.2 Kontraktuesi nuk duhet të ketë lidhje (të tashme ose të shkuara) me asnjë konsulent ose njësi që ka marrë pjesë në pregatitjen e dokumentave të tenderit për këtë prokurim.

4.3 Kontraktuesi është dakort që të përjashtojë veten e tij nga prokurimi i mallrave, shërbimeve ose ndertimeve që mund të pasojnë, si rezultat i, ose në lidhje me, këtë kontratë.

4.4 Kontraktuesi duhet të lejojë Autoritetin Kontraktues të inspektojë llogaritë dhe procesverbalet që kanë lidhje me zbatimin e kontratës ose t'i kontrollojë ato me anë të kontrollorëve të emëruar nga Autoriteti Kontraktues.

## Neni 5

## Informacioni Konfidencial

5.1 Kontraktuesi dhe Autoriteti Kontraktor duhet të mbajnë në kofidencë të gjitha dokumentat, të dhënat dhe informacionet e tjera të dhëna nga pala tjetër në lidhje me kontratën.

5.2 Kontraktuesi mund t'i japë nenkontraktuesit dokumenta të tilla, të dhëna ose informacione të tjera që merr nga Autoriteti Kontraktues deri në masën e kërkuar për nën-kontraktuesin në mënyrë që ai të kryejë punën e tij sipas kontatës. Në rast të tillë, Kontraktuesi duhet të përfshijë në kontratën e tij me nënkontraktuesin një dispozitë që premton ruajtjen e konfidencës siç thuhet në Paragrafin 5.1 më sipër.

## Neni 6

## Prona Intelektuale

6.1 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, të gjitha të drejtat e pronës intelektuale të siguruara nga Kontraktuesi gjatë Kontrates do t'i përkasin Autoritetit Kontraktues i cili mund t'i përdorë ato sipas gjykimit të tij.

6.2 Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në kontratë, Furnizuesi, pas përfundimit të kontratës, duhet t'i dorëzojë Autoriteti Kontraktues të gjitha raportet dhe të dhënat si hartat, diagramët, skicimet, specifikimet, planet, statistikat, llogaritjet dhe regjistrat mbështetës ose materialet e fituara, mbledhura ose pregatitura nga Kontraktuesi gjatë kontratës. Kontraktuesi mund të mbajë kopje të këtyre dokumentave dhe të dhënave, por nuk duhet t'i përdori për qëllime që s'kanë lidhje me kontratën pa leje paraprake me shkrim nga Autoriteti Kontraktues.

6.3 Kontraktuesi duhet të sigurojë Autoritetin Kontraktues nga mospërgjegjësia për shkelje të të drejtave të pronës intelektuale që mund të dalin nga prodhimi ose kryerja e Shërbimeve sipas kontratës.

6.4 Në rast se ngrihet ndonjë pretendim ose padi kundër Autoriteti Kontraktues në lidhje me ndonjë shkelje të pronës intelektuale të shkaktuar nga zbatimi i kontratës ose nga përdorimi i gjërave të furnizuara sipas kontratës, Kontraktuesi duhet t'i japë Autoriteti Kontraktues të gjitha provat dhe informacionin në posedim të Kontraktuesit që kanë të bëjnë me këtë padi apo pretendim.

## Neni 7

## Detyrimet e Përgjithshme të Kontraktuesit

7.1 Kontraktuesi duhet t'i kryejë Shërbimet dhe përmbushi detyrimet e tij me të gjitha përpjekjet, eficiente dhe ekonomike në pajtim me teknikat dhe praktikat profesionale te pranuara ne përgjithsi.

7.2 Kontraktuesi duhet të ndjekë praktika të shëndosha të biznesit dhe të përdorë teknologji të avancuar dhe të përshtatshme si dhe metoda të sigurta.

7.3 Në se kontrata kërkon kryerjen e shërbimeve këshillimore profesionale, Kontraktuesi duhet të veprojë gjithmonë si një këshillues besnik i Autoriteti Kontraktues, në pajtim me rregullat dhe kodin e sjelljes të profesionit të tij dhe duhet që të mbështesi dhe ruajë gjithmonë interesin publik.

7.4 Në se kontrata kërkon kryerjen e shërbimeve këshillimore profesionale, Kontraktuesi duhet të ushtrojë kujdes të plotë në mardhëniet me palët e treta duke përfshirë median dhe nuk duhet të marrë pjesë në veprime që janë jashte kompetences së tij në përfaqsimin e Autoritetit Kontraktues.

## Neni 8

## Detyrimet e Veçanta të Kontraktuesit

8.1 Kontraktuesi duhet të kryejë të gjitha Shërbimet siç specifikohet tek Termat e References.

8.2 Kontraktuesi duhet t'i paraqesë Autoritetit Kontraktues të gjitha sherbimet, në sasitë e përcaktuara, siç kërkohen nga kontrata duke përfshirë, por jo të kufizuara nga, të gjitha raportet, dokumentat, studimet, skicimet dhe planimetritë.

8.3 Kontraktuesi duhet të sigurojë raportet e lidhura me zbatimin e Shërbimeve siç kërkohet në kontratë.

## Neni 9

## Specifikime dhe Skicime

9.1 Në se kontrata kërkon shërbime skicimi, Kontraktuesi duhet të pregatisi të gjitha specifikimet dhe skicimet duke përdorur sisteme të pranuara dhe të njohura në përgjithsi të pranueshme për Autoritetet Kontraktues dhe të marri parasysh standartet më të fundit.

9.2 Nëse kontrata kërkon shërbime skicimi, Kontraktuesi duhet të sigurojë se të gjitha specifikimet, skicimet dhe kërkesat e tjera janë pregatitur në bazë asnjanëse përsa i përket nxitjes së konkurencës në prokurimin e objekteve të skicimit.

HE & SK 11
SH.P.K

## Neni 10

## Lejet dhe Liçensat

10.1 Kontraktuesi do të jetë përgjegjës për sigurimin e lejeve ose liçensave sipas kërkesave të Ligjeve të Republikës së Shqipërisë për kryerjen e Shërbimeve në këtë kontratë vec rastit kur palet bien dakord ndryshe.

## Neni 11

## Heqja dhe Zëvendësimi i Personelit Kryesor

11.1 Kontraktuesi duhet të sigurojë aprovim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues përpara heqjes ose zëvendësimit të personelit kryesor siç përshkruhet në oferten e Kontraktuesit.

11.2 Kontraktuesi do të zëvendësojë çdo punonjës në se Autoriteti Kontraktues zbulon se personi ka kryer veprime të jashtëligjshme ose Autoriteti Kontraktues është mjaft i pakënaqur nga puna e personit.

11.3 Nëse bëhet e nevojshme të zëvendësohet ndonjë nga personeli kryesor, Kontraktuesi duhet të sigurojë si zëvendësues një person me kualifikime ekuivalente ose më te mira.

11.4 Kontraktuesi do të paguajë kosto shtesë për zëvendësimin e personelit kryesor me përjashtim kur shkaku i zëvendësimit ka ardhur nga neglizhenca ose mungesa e kujdesit të Autoriteti Kontraktues.

## Neni 12

## Vendndodhja

12.1 Shërbimet duhet të kryhen në vendin ose vendet e specifikuara në kontratë.

12.2 Në se nuk është specifikuar vendi, Autoriteti Kontraktues rezervon të drejtën të aprovojë vendin ose vendet e kryerjes së Shërbimeve, megjithatë, aprovimi nuk duhet të vonohet ne mënyrë të paarsyeshme.

## Neni 13

## Siguracioni i Përgjegjësisë Profesionale

13.1 Kontraktuesi duhet të mbajë siguracion për përgjegjësi profesionale sipas rregullave dhe praktikave të njohura në përgjithsi për profesionin për ta zhdëmtuar Autoriteti Kontraktues për dëme të rezultuara nga neglizhenca, gabimet ose mangësitë, në kryerjen e Shërbimeve.

13.2 Nëse nuk është përcaktuar në kontratë shuma minimale e siguracionit, Kontraktuesi duhet të sigurojë siguracion në shumën e njohur në përgjithsi si të mjaftueshme nën rrethanat e Shërbimeve që po sigurohen.

## Neni 14

## Çmimi i Kontratës

14.1 Çmimi i kontratës duhet të jetë çmimi i ofruar në oferten e Kontraktuesit dhe i pranuar nga Autoriteti Kontraktues.

## Neni 15

## Afatet e Pagesës

15.1 Çmimi i kontratës, duke përfshirë çdo pagesë paraprake, duhet të paguhen në kohë siç specifikohet në kontratë.

15.2 Me përjashtim kur parashikohet nga një dispozitë tjetër në kontratë, pagesa duhet bërë në monedhë Shqiptare. Kursi i shkëmbimit i monedhave të ndryshme do të jetë kursi i Bankes se Shqiperise në ditën kur është dërguar njoftimi i kontratës për botim.

15.3 Me përjashtim kur parashikohet nga një dispozitë tjetër në kontratë, kërkesa e Kontraktuesit për pagesë duhet t'i bëhet Autoriteti Kontraktues me shkrim. Për çdo kërkesë, Kontraktuesi duhet të paraqesë origjinalin dhe kopjen së bashku me një listë të sendeve që përshkruan shërbimet e kryera për të cilat duhet paguar.

15.4 Me përjashtim kur parashikohet nga një dispozitë tjetër në kontratë, pagesa për shërbimet do të bëhet brenda 30 ditëve kalendarike nga dita qe janë kryer Shërbimet, dorëzimi është paraqitur ose arritur, ose nga dita e marrjes së kërkesës për pagesë cilado të jetë më e vonë.

15.5 Data e pagesës do të jëte dita që fondet debitohen nga llogaria e Autoritetit Kontraktues.

## Neni 16

## Vonesa në Bërjen e Pagesës

16.1 Dëmet e llogaritura, të shkaktuara si rezultat i vonesës në pagesë, konsistojnë në kamaten që fillon nga data e vonesës së debitorit (Autoritetit Kontraktues), në monedhën zyrtare të vendit ku do të bëhet pagesa. Përqindja e kamates parashikohet me ligj. Në fund të çdo viti, interesi i maturuar i shtohet shumës totale, mbi të cilën është llogaritur interesi i maturuar.

16.2 Kamata ligjore paguhet pa detyruar kreditorin (Kontraktuesin) te provoje ndonje dem. Në se kreditori (Kontraktuesi) provon se ka pesuar një dëm me te madh se kamata ligjore, debitori (Autoriteti Kontraktues) duhet të paguajë pjesën e mbetur të dëmit.

## Neni 17

## Ndryshimi i Ligjeve dhe Rregulloreve

17.1 Nëse pas datës së nënshkrimit të kontratës, ndonjë ligj, rregullore, urdhëresë, urdhër ose procedurë me efektin e ligjit në Republikën e Shqipërisë hyn në fuqi, nxirret ose ndryshon dhe ndikon kushtet, duke përfshirë datën e dorëzimit, ose çmimin e kontratës, kushtet ose çmimi i kontratës do të rregullohen në atë masë sa kontraktuesi është ndikuar në përmbushjen e detyrimeve të tij sipas kontratës.

**Neni 18**

**Forca Madhore**

18.1 Kontraktuesi nuk duhet të mbajë përgjegjësi për humbjen e depozitës së kontrates, dëmet e likuiduara ose ndërprerjen për mosplotësim nëse dhe deri në masën që vonesa në zbatim ose ndonjë dështim tjetër në zbatimin e detyrimeve të tij sipas kontratës vijnë si rezultat i ndodhjes së Forcës Madhore.

18.2 Për qëllimet e këtij neni "Forcë Madhore" do të thotë një ngjarje e paparashikueshme jashtë kontrollit të Kontraktuesit mbi fajin ose neglizhimin. Ngjarje të tilla mund të përfshijnë, por nuk janë të limituara nga, veprimet e Autoritetit Kontraktues qoftë në kapacitetin e tij sovran ose kontraktual, lufta ose revolucionet, zjarri, përmbytja, tërmeti, epidemitë, shtrëngime të karantinës dhe embargo tranziti.

18.3 Në se ndodh ndonjë situatë e Forcës Madhore, Kontraktuesi duhet të njoftojë menjehere Autoriteti Kontraktues. Me përjashtim kur Autoriteti Kontraktues jep direktiva të ndryshme, Kontraktuesi duhet të vazhdojë të zbatojë detyrimet e tij sipas kontratës në masën praktikisht të arsyeshme dhe duhet të kërkojë të gjitha mjetet e arsyeshme për zbatimin që nuk pengohet nga Forca Madhore.

**Neni 19**

**Vonesa në Zbatim dhe Zgjatja e Afatit**

19.1 Me përjashtim kur parashikohet ndryshe, Kontraktuesi duhet të fillojë zbatimin e kontratës menjëherë pas nënshkrimit të saj.

19.2 Me përjashtim të rastit kur Autoriteti Kontraktues është dakord për zgjatje të afatit të kontratës, Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të likuidojë dëmet për vonesën në zbatim nëse Kontraktuesi dështon në kryerjen e Shërbimeve brenda periudhës së Kontrates.

19.3 Autoriteti Kontraktues mund të zbresë shumën e dëmeve të likuiduara që duhet paguar nga shuma e pagesës ndaj Kontraktuesit. Në rast të tillë Autoriteti Kontraktues duhet t'i japi kontraktuesit njoftim me shkrim për shumën dhe arsyen e zbritjes.

19.4 Autoriteti Kontraktues do të jetë dakort për një zgjatje të afatit në rastin e Forcës Madhore.

19.5 Autoriteti Kontraktues mund të jetë dakort për zgjatje të afatit edhe në rrethana të tjera nëse është në interesin publik për ta bërë këtë. Ne rast se Kontraktuesi ndeshet me kushte që pengojnë zbatimin në kohë, Kontraktuesi duhet të njoftojë menjehere Autoritetin Kontraktor me shkrim për vonesën, shkakun dhe datën e propozuar të përfundimit të Shërbimeve. Autoriteti Kontraktor duhet të vlerësojë kërkesën. Nëse Autoriteti Kontraktor është dakort me vonesën, zgjatja do të hyjë në fuqi me një amendament me shkrim të kontratës të nënshkruar nga Autoriteti Kontraktor dhe Kontraktuesi.

## Neni 20

## Likuidimi i Dëmeve për Dorëzimin e Vonuar

20.1 Dëmet e likuidueshme për kryerjen e vonuar të Shërbimeve do të llogariten me tarifat e mëposhtme ditore:

a) Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 6 muaj, tarifa ditore do të jetë 4/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.

b) Për kontratat me periudhë zbatimi jo më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 2/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.

c) Për kontratat me periudhë zbatimi më shumë se 12 muaj, tarifa ditore do të jetë 1/1000 të vlerës koresponduese të mbetur pa u zbatuar nga cmimi total i kontratës por kjo vlerë do të llogaritet minimalisht mbi 25% të vlerës së kontratës.

## Neni 21

## Negociatat dhe Amendamentet

21.1 Palët nuk do të negociojnë ndryshime ose amendamente të asnjë elementi të kontratës që do të ndryshonte mjaftueshëm kushtet që përbëjnë bazën e përzgjedhjes së Kontraktuesit.

21.2 Asnjë amendament ose variacion tjetër i kontratës nuk do të jetë i vlefshëm pa qënë me shkrim, me datë, t'i referohet shprehimisht kontratës dhe nënshkruhet nga një përfaqsues i autorizuar i Kontraktuesit dhe Autoritetit Kontraktor.

21.3 Çdo heqje dore nga të drejtat, pushtetet ose ndreqjet që mund të bëhen nga palët sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim, të ketë datë dhe të firmoset nga një përfaqsues i autorizuar i palës që bën këtë dorëheqje dhe duhet të specifikojë të drejtën dhe masën në të cilën ajo lëshohet.

## Neni 22

## Ndryshimi i Porosisë

22.1 Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të porosisë Shërbime shtesë deri në një sasi që nuk i kalon 20% të çmimit total të kontratës. Çdo porosi shtesë duhet të bëhet në mënyrë konsistente me rregullat dhe procedurat e parashikuara në Ligjin mbi Prokurimin Publik.

## Neni 23

## Ndërprerja për Mosplotësim

23.1 Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në tërësi ose pjesërisht nëse:

a) Kontraktuesi dështon të kryejë Shërbimet brenda periudhës së specifikuar në kontratë ose brenda zgjatjes së dhënë; ose,

b) Kontraktuesi dështon të zbatojë ndonjë detyrim tjetër të kontratës.

23.2 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi Kontraktuesit njoftim me shkrim për ndërprerjen për mosplotësim dhe t'i japi Kontraktuesit 15 ditë të ndreqë mosplotësimin me përjashtim kur

ndërprerja është bërë për veprime korruptive ose të paligjshme, rast në të cilin ndërprerja do të jetë e menjëhershme.

## Neni 24

## Ndërprerja për Shkak të Falimentimit

24.1 Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse Kontraktuesi falimenton ose bëhet i paaftë të paguajë.

24.2 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi Kontraktuesit njoftim me shkrim për ndërprerjen.

## Neni 25

## Ndërprerja për Shkak të Interesit Publik

25.1 Autoriteti Kontraktor mund të ndërpresë kontratën në çdo kohë nëse gjykon se ky veprim duhet ndërmarrë për t'i shërbyer sa më mirë interesit publik.

25.2 Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi Kontraktuesit lajmërim me shkrim për ndërprerjen.

25.3 Autoriteti Kontraktor duhet të paguajë Kontraktuesin për të gjitha Shërbimet e kryera përpara ndërprerjes dhe duhet t'i paguajë Kontraktuesit dëmet e shkaktuara për kryerjen e pjesshme të Shërbimeve. Në llogaritjen e shumës së dëmeve, Kontraktuesi do të kërkohet të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për të minimizuar dëmet.

## Neni 26

## Nënkontrata

26.1 Një nënkontratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është në formën e një marrveshjeje të shkruar me anë të së cilës kontraktori i beson kryerjen e një pjese të detyrimeve të kontratës së tij një pale të tretë

26.2 Kontraktori nuk duhet të nënkontraktojë pa aprovimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktor dhe jo më shumë se 40% të vlerës së kontratës. Kontraktori duhet të njoftojë Autoritetin Kontraktor për elementet e kontratës që nënkontraktohet dhe dokumentacionin që provon aftësine e nënkontraktorit. Autoriteti Kontraktor duhet të lajmërojë kontraktorin për vendimin e tij, brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke shprehur arsyet nëse e aprovon apo jo atë.

26.3 Cdo nenkontraktor duhet të kete te drejte te marre pjese ne prokurimin publik sipas Ligjit mbi Prokurimin Publik. Autoriteti mund të parashikojë pagesa direkte tek nënkontraktori për shërbimet që do të furnizojë.

26.4 Kur Kontraktuesi ka ndër mend të realizoje një pjesë të punimeve me nën-kontraktues, duhet të paraqesë në ofertë, sipas dokumentave të tenderit, gjithë dokumentacionin e kerkuar per nenkontraktuesin si dhe punimet konkrete qe do te jape me nensipermarrje.

26.5 Kontraktori mbetet plotësisht përgjegjës për zbatimin e kontratës pamvarësisht nga sjellja e nenkontraktorit.

**Neni 27**

**Transferimi i të Drejtave**

31.1 Kontraktuesi nuk duhet të transferojë, tërësisht ose pjesërisht, detyrimet e tij sipas kontratës me përjashtim kur jepet miratimi paraprak i Autoritetit Kontraktor.

**Neni 28**

**Sigurimi i Kontrates**

28.1 Përpara nënshkrimit të kontratës, kontraktuesi duhet t'i dorëzojë Autoritetit Kontraktor sigurimin e kontrates në shumën dhe formën e kërkuar

28.2 Shuma e sigurimit të kontrates duhet t'i paguhet Autoritetit Kontraktor si kompensim për çdo humbje të rezultuar nga dështimi i Kontraktuesit në plotësimin e detyrimeve të tij sipas kontratës.

28.3 Sigurimi i kontrates do t'i kthehet Kontraktuesit jo më vonë se 30 ditë pas datës së kryerjes së Shërbimeve.

**Neni 29**

**Baza Ligjore**

29.1 Kontrata do të rregullohet nga dispozitat e legjislacionit shqiptar në fuqi.

**Neni 30**

**Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve**

30.1 Autoriteti Kontraktor dhe Kontraktuesi duhet të bëjnë çdo përpjekje të zgjidhin mosmarrëveshjet ose konfliktet e ndodhura midis tyre ose në lidhje me këtë marrëveshje me negociata direkte.

30.2 Nëse palët dështojnë në zgjidhjen e mosmarrëveshjes ose konfliktit, problemet do të konsiderohen me anë të zgjidhjes së marrëveshjeve sipas kontratës dhe procedurave juridike në fuqi sipas legjislacionit të Republikës së Shqipërisë.

**Neni 31**

**Përfaqësimi i Palëve**

31.1 Çdo palë duhet të emërojë me shkrim një person ose post organizativ, që do të jetë përgjegjës, në emër të palës, për marrjen e komunikatave dhe për përfaqësimin e palës në çështjet e lidhura me egzekutimin e kontratës.

31.2 Secila palë duhet të lajmërojë palën tjetër menjëherë për ndonjë ndryshim në emërimin e përfaqsuesit të palës. Nëse njëra palë dështon të lajmërojë, duhet të marri përsipër çdo humbje të shkaktuar nga dështimi për të dhënë njoftim të mjaftueshëm.

31.3 Palët mund të emërojnë persona ose njësi organizative shtesë për të përfaqsuar palën në veprime ose veprimtari të veçanta njoftimi me shkrim në të cilin rast duhet dhënë dhe duhet të përcaktoje shtrirjen e autoritetit të përfaqsuesit.

## Neni 32

## Lajmërimet

32.1 Çdo lajmërim i dhënë nga njëra palë tjetrës sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim në adresën e specifikuar në kontratë.

32.2 Njoftimi do të ketë efekt sapo të dorëzohet.

## Neni 33

## Llogaritja e Afateve

33.1 Të gjitha referencat e ditëve do të jenë ditë kalendarike me përjashtim kur parashikohet ndryshe.

## KUSHTET E VEÇANTA TE KONTRATES

Kushtet e veçanta të Kontratës hartohen në përputhje me objektin konkret të kontratës. Në rast se ka mospërputhje midis KPK dhe KVK do të mbizotërojne Kushtet e veçanta të kontratës

### Neni 1

### Përkufizime

1.1 Autoriteti Kontraktor është Bashkia Malesi e Madhe, me NIPT: K48420701I, perfaqesuar nga z. Tonin Marinaj (Kryetar).

1.2 Kontraktuesi është " HE & SK 11" sh.p.k , me Nr. NIPT-i L19008502B, perfaqesuar nga z. Festim Bregasi /Administrator, Adresa: Gjirokaster Tepelene, Lagja "Mustafa Matohiti", Rruga "Mustafa Matohiti ",banesa nr. 31, shkalla nr.1, kati perdhe.

### Neni 2

### Sigurimi i kontrates

2.1 Sigurimi i kontrates në shumën prej (10 % te vleres se kontrates) duhet të ofrohet nga Kontraktuesi për të siguruar egzekutimin e detyrimeve të tij sipas kontratës (Kontraktuesi ka paraqitur formularin e sigurimit te kontrates me Nr. Serie 1756669, date: 07.11.2016, I cili ka derdhur nje depozite prane " Albsig SHA ", ne vleren 235.099,99 (dyqindetridhjeteepesemijeenentedhjeteenente,nentedhjeteenente) Lek.)

2.2 Sigurimi i kontrates do t'i lëshohet ose kthehet, menjehere, Kontraktuesit sipas formularit të mëposhtëm:

____________________________________________

____________________________________________

____________________________________________

### Neni 3

### Fillimi i Kontrates

3.1 Zbatimi i kontratës duhet të filloje më 07.11.2016 . Nëse nuk është specifikuar, zbatimi do të fillojë në datën që Kontraktuesi nënshkruan formularin e kontratës.

### Neni 4

### Vendndodhja e Shërbimeve

4.1 Shërbimet do të kryhen në: Koplik- Qender, Malesi e Madhe.



94

## Neni 5

## Informacion që duhet dhënë nga Autoriteti Kontraktor

5.1 Brenda 15 ditësh nga marrja e sigurimit te kontrates, Autoriteti Kontraktor duhet t'i japi Kontraktuesit informacionin dhe dokumentat e mëposhtme: ______________________

## Neni 6

## Kërkesat e Raportimit

6.1 Gjatë zgjatjes së kontratës, Kontraktuesi duhet të sigurojë raporte për Autoritetin Kontraktor sipas formularit të mëposhtëm: ______________________

## Neni 7

## Siguracioni i Përgjegjësisë Profesionale

7.1 Përpara fillimit të zbatimit të kontratës, Kontraktuesi duhet të siguroje Autoritetin Kontraktor me prova për siguracionin e përgjegjsisë profesionale me shumë minimale si vijon: ______________________

## Neni 8

## Kushtet e Pagesës

8.1 Pagesa për Shërbimet duhet bërë sipas skedarit të mëposhtëm: ______________________

8.2 Çdo pagesë e skeduar duhet bërë brenda _________ ditëve nga data e arritjes së marrveshjes për pagesën ose nga data e marrjes së kërkesës me shkrim për pagesë cilado që të jetë më vonë. Nëse është lënë e paplotësuar, periudha kohore do të jetë 30 ditë.

8.3 Monedha e pagesës do të jetë ______. Nëse është lënë e paplotësuar, pagesa do bëhet me monedhën Shqiptare.

8.4 Pagesa do te behet ne llogarine bankare:

RAIFFEISEN BANK SH.A

Emri i llogarise: " HE & SK 11 " SHPK

Nr. i Llogarise: 0000761783

## Neni 9

## Pagesa Paraprake

9.1 Përqindja e pagesës paraprake do të jetë _____. Nëse është lënë e paplotësuar, Kontraktuesi nuk do të marrë pagesë paraprake.

9.2 Nëse është premtuar një pagesë paraprake, avanca do të paguhet brenda ______ ditëve nga marrja e sigurimit te kontrates.

9.3 Nëse jepet pagesa paraprake, shuma do të hiqet nga pagesa që duhet t'i jepet Kontraktuesit sipas formulës së mëposhtme:________________________________________________

______________________________________________________________

## Neni 10
## Zbritja e garancisë së kontratës

10.1 Nëse parashikohet zbritje periodike të garancisë së kontratës ajo kryhet si më poshtë

______________________________________________________________

______________________________________________________________

Nëse nuk plotësohet, garancia mbetet e pandryshuar.

## Neni 13
## Afati i Garancise se defekteve

Periudha e garancise se defekteve do te jete 1 (nje) vit nga data e firmosjes se aktit te kolaudimit.

-Kontrata nenshkruhet ne 5 kopje, nje i jepet kontraktuesit ndersa 4 i mban Autoriteti Kontraktor.

## PALET KONTRAKTORE

| BASHKIA MALESI E MADHE | " HE & SK 11 " SHPK |
| --- | --- |
| TONIN MARINAJ | FESTIM BREGASI |
| KRYETAR | ADMINISTRATOR |

SHOQERIA E SIGURIMIT ALBSIG SHA (K42108801C) - Rr. George W.Bush, Nr. 10 Tirane - Tel: 42254 770, Fax 42254 664 - info@albsig.al

Numri unik: {464B83F8-F714-43A4-90D9-F0B7FB411392}

0000017566698

K42108801C

Albsig SHOQERI SIGURIMESH

# FORMULARI I SIGURIMIT TË KONTRATËS

Numri serie & fature: 1756669

Datë: 07.11.2016

Për: (emri,adresa e autoritetit kontraktor) BASHKIA MALESIA E MADHE

Në emër të: (emri, adresa e ofertuesit të siguruar) HE & SK11 SH.P.K L19008502B

Procedura e prokurimit (lloji i procedurës) Sherbim konsulence

Përshkrim i shkurtër i kontratës (objekti)

"SUPERVIZIM REHABILITIM I QENDRËS SË QYTETIT KOPLIK"

Publikimi (nëse zbatohet) : Buletini i Njoftimeve Publike (Data,Numri) :

Njoftim ne rruge elektronike ne adresen zyrtare te APP-se,www.app.gov.al

Duke iu referuar procedurës së lartëpërmendur, dhe me kusht që (emri i ofertuesit të përcaktuar fitues)

HE & SK11 SH.P.K t'i jetë akorduar kontrata.

Ne vërtetojmë se HE & SK11 SH.P.K (emri i ofertuesit të përcaktuar fitues)

, ka derdhur një depozitë pranë ALBSIG SHA në një shumë prej (monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra):

235.099,99 DyQinde e Tridhjete e PeseMije e e Nentedhjete e Nente , Nenteedhjete e Nëntë Lekë

si kusht për sigurimin e egzekutimit të kontratës, që do të nënshkruhet me (emri i autoritetit kontraktor)

BASHKIA MALESIA E MADHE

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e (emri i autoritetit kontraktor) BASHKIA MALESIA E MADHE ,vlerën e siguruar, brenda 15(pesëmbedhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mos përmbushjen e kushteve të kontratës.

Ky Sigurim është i vlefshëm deri në zbatimin plotë të kontratës.

**Primi i Sigurimit** 2.400,00 LEK TVSH-ja XX

**Pagesa në total** (monedha, shifra dhe fjalë): 2.400,00 DyMijë e KatërQindë LEK

2.400,00 TVSH-ja XX

**Pagesa në total** (shifra,fjale dhe monedha): 2.400,00 Lek DyMijë e KatërQindë Lek

Pagesa e Njëhershme/ Mënyra dhe data (Urdhër Xhirimi/Cash): Urdhërxhirim

Nenshkrimi, miratimi ose pagesa e primit te sigurimit nga i Siguruari, Kontraktori ose Perfituesi i kesaj police nenkupton qe ato kane disponuar kuptuar dhe pranuar te gjitha termat e kushtet e veçanta e te pergjithshme te kontrates se sigurimit si bashkelidhur kesaj police, qe perben parakusht per marrjen e pergjegjesive nga Siguruesi.

ALBSIG SHA

DREJTORI

I SIGURUARI

3

*Shënim: Përdorimi i kësaj police, si faturë tatimore, është lejuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve me autorizimin Nr. 18, datë 10.09.2004.*

0134913

# KUSHTET E PËRGJITHSHME TË SIGURIMIT TË KONTRATËS

**1. Përcaktime të Përgjithshme.**
Kompania e sigurimit "**ALBSIG**" **sh.a.** këtu e në vazhdim, do të quhet **Siguruesi.**
**I Siguruari ose Kontraktuesi**, këtu e në vazhdim do të quhet subjekti fizik ose juridik, pjesmarrës në një tender prokurimi, i cili është shpallur fitues nga Autoriteti Prokurues, publik ose jo.
**Përfituesi,** këtu e në vazhdim do të quhet, Autoritet Prokurues që organizon proçesin e tenderimit.

**2. Objekti i Sigurimit.**
Objekti i kësaj kontrate sigurimi është marrëdhënia e juridike në të cilën:

1. Siguruesi garanton Përfituesin për përmbushjen e detyrimeve të kontratës së prokurimit të nënshkruar ndërmjet palëve në përputhje me dokumentat e tenderit;
2. I Siguruari detyrohet t'i kthejë Siguruesit çdo vlerë monetare të paguar prej tij në rast të ekzkeutimit të garancisë siç përcaktohet në Pikën 1 të këtij neni.

**3. Vlefshmëria e Kontratës**
**3.1** Vlefshmëria e kësaj kontrate sigurimi fillon datën e nënshkrimit të kontratës së prokurimit nga palët në përputhje me dokumentat e tenderit dhe mbaron me zbatimin e plotë të saj ose në ditën e lëshimit të Çertifikatës së Mbarimit të Punimeve nga Përfituesi. Vlefshmëria e këtij sigurimi në lidhje me pikën 2 të Nenit 2 shtrihet deri në shlyerjen e plotë të detyrimeve të të Siguruarit ndaj Siguruesit.
**3.2** Formulari i sigurimit të Kontratës është i vlefshëm vetëm kur është i shoqëruar me këto Kushte të Përgjithshme të Sigurimit të Kontratës, mbi bazën e të cilës ajo është lëshuar, në të kundërt Formulari i Sigurimit të Kontratës është i pavlefshëm.

**4. Shuma e Sigurimit ose Garancisë.**
**4.1** Shuma e sigurimit shënohet në formularin e sigurimit të kontratës dhe përbën nivelin maksimal të detyrimit të Siguruesit ndaj Përfituesit dhe të të Siguruarit ndaj Siguruesit në rastin e parashikuar në Pikën 2 të Nenit 2 të kësaj Kontrate.
**4.2** Çdo rritje e mundshme e shumës së sigurimit të përcaktuar në Formularin e Sigurimit të Kontratës do të bëhet me miratimin e Siguruesit, kundrejt paraqitjes së një kerkese për këtë shtesë nga Përfituesi. Në rast se Siguruesi miraton rritjen e shumës fillestare të sigurimit, i Siguruari duhet të paguajë primin shtesë përkatës dhe të pajiset me një formular të ri të sigurimit të kontratës.

**5. Primi i Sigurimit.**
Pagesa e primit të sigurimit kryhet pranë Deges ose agjencise së Siguruesit ku lëshohet Polica e Sigurimit. Pagesa e primit konsiderohet e kryer në momentin e kalimit të vlerës së tij, në llogarinë e Siguruesit.

**6. Ekzekutimi i detyrimeve.**
**6.1** Siguruesi paguan shumen e garantuar brenda 15 ditëve nga mbërritja e kërkeses me shkrim nga Përfituesi, me kusht që në shkresë të jetë përcaktuar mosrealizimi i detyrimit kontraktor dhe vlera përkatëse e këtij mosrealizimi. Kundrejt kërkesës së Siguruesit palët duhet të paraqesin një kopje të kontrates së prokurimit të nënshkruar prej tyre. Përfituesi duhet të njoftojë Siguruesin brenda 30 ditëve nga ndodhja e ngjarjes së sigurimit (mos realizimit). Në rast mos respektimi të këtij afati Siguruesi ka të drejtë të vendosë për pagesën ose jo të shumes se garantuar.
**6.2** I Siguruari është i detyruari dhe përgjegjësi kryesor për realizimin e kontratës së prokurimit të lidhur me Përfituesin. I Siguruari me marrjen e dokumentit të pagesës kryer nga Siguruesi në favor të Përfituesit detyrohet të rimbursojë Siguruesin brenda 7 ditëve, për vleren e pagesës së kryer. Për vonesen tej këtij afati i Siguruari do të paguaj një penalitet prej 0,1 % në ditë të shumës së papaguar, si dhe të çdo shume ligjore tjetër të shpenzuar për arketimin e detyrimit kryesor.

**7. Zgjidhja e mosmarreveshjeve**
Në rast mosmarrëveshjesh, kur ato nuk zgjidhen me mirëkuptim ndërmjet palëve, kompetente është gjykata e vendit ku është lëshuar polica e sigurimit.

SIGURUESI

I SIGURUARI/KONTRAKTUESI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Albsig
SHOQËRI SIGURIMESH
DEPARTAMENTI I SHITJES
TIRANE

HE & SK 11
consulting company

| STRUKTURA E PROPOZIMIT EKONOMIK | | | | |
|---|---|---|---|---|
| "SUPERVIZIM REHABILITIM I QENDRËS SË QYTETIT KOPLIK" | | | | |
| | | | | |
| 1 | Tarifat sipas Kategorise se Punes | leke | | 1,232,000 |
| 2 | Kostot e Drejteperdrejta | leke | | 154,666 |
| 3 | Pagesa Ditore | leke | | 80,000 |
| 4 | Shpenzime te Rimbursueshme | leke | | 500,000 |
| TOTALI PA TVSH | | | | 1,966,666 |
| TVSH 20 % | | | | 393,333 |
| TOTALI ME TVSH | | | | 2,360,000 |

Tirane, më 26/09/2016
Shoqëria "HE & SK 11"
Përfaqësuar nga: ing. Festim Bregasi

HE & SK 11
consulting company

# DETAJIMI I OFERTES EKONOMIKE:

## "SUPERVIZIM REHABILITIM I QENDRËS SË QYTETIT KOPLIK"

| Nr. | Rubrikat | Staf - muaj | muaj | Cmimi per Njesi | Totali i Kostos (Leke) |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | TARIFAT SIPAS KATEGORISE SE PUNES | | | | |
| 1.1 | Drejtues Projekti ( 1 Inxhinier ndertimi dhe 1 arktiket ) | 2 | 8 | 22,000 | 352,000 |
| 1.2 | Inxhinier Hidroteknik | 1 | 8 | 22,000 | 176,000 |
| 1.3 | Inxhinier Topograf | 1 | 8 | 22,000 | 176,000 |
| 1.4 | Inxhinier Mjedisi | 1 | 8 | 22,000 | 176,000 |
| 1.5 | Inxhinier Mekanik | 1 | 8 | 22,000 | 176,000 |
| 1.7 | Inxhinier Elektrik | 1 | 8 | 22,000 | 176,000 |
| | | | | | |
| | Nen Totali 1 | | | | 1,232,000 |
| | | | | | |
| 2 | KOSTOT E DREJTPERDREJTA | | | | |
| 2.1 | Makine Transporti | | 8 | 9,333 | 74,666 |
| 2.2 | Materiale,kancelerie,fotokopje , telefon etj | | 8 | 10,000 | 80,000 |
| | Nen Totali 2 | | | | 154,666 |
| | | | | | |
| 3 | PAGESA DITORE | | | | |
| 3.1 | Dieta,etj | | 8 | 10,000.00 | 80,000 |
| | Nen Totali 3 | | | | 80,000 |
| | | | | | |
| 4 | SHPENZIME TE RIMBURSUESHME | | | | |
| 4.1 | Shpenzime te Rimbursueshme | | | | 500,000 |
| | Nen Totali 4 | | | | 500,000 |

| | |
|---|---|
| *Shuma Totale 1+2+3+4* | 1,966,666 |

Tirane, më 26/09/2016

Shoqëria " HE & SK 11 "

Përfaqësuar nga: Ing. Festim Bregasi

NDERTIM - IMPORT - EXPORT HE & SK 11 ALBANIA